



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rr. Abdi Toptani, nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 069 40 57089  
E-mail: rmuca@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, më 30/12/2019

Miratohet

Bujar LESKAJ

KRYETAR



## Raport Auditimi Performance “MBIKËQYRJA E TREGUT TË TELEFONISË CELULARE”



Rinald Muça

Drejtor i Departamentit

**Publik:** Ky dokument u gjenerua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, specifikisht neni 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3 E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti lutemi të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.



Divizioni i Performancës, IT, Novacionit e Sistemeve në KLSH  
@Performanca



# RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS “MBIKËQYRJA E TREGUT TË TELEFONISË CELULARE”

---

**DHJETOR 2019**

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. prot. 425/7 dhe 425/8 datë 18.10.2019.

*Faza studimore* e auditimit nisi më datë 07.06.2019 me shkresën njoftim-fillim auditimi, drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me nr. prot. 425.

*Faza e terrenit* të auditimit nisi në datë 20.10.2019 me programin e auditimit të cituar më lart dhe përfundoi më datë 28.11.2019.

*Projekt-raporti i auditimit* mori formë përfundimtare më datë 10.12.2019 dhe iu përcoll subjekteve nën auditim, përkatësisht me nr. prot. 425/13:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Në rrugë elektronike projekt-raporti ju dërgua gjithashtu edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 10.12.2019.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjektet nën auditim. MIE nuk përcolli observacione, ndërkohë që AKEP përcolli komentet dhe observacionet me shkresat: nr. prot 425/15 datë 18.12.2019; nr. prot. 425/16 datë 24.12.2019 dhe nr. prot. 425/17 datë 26.12.2019. Observacionet mund të aksesohen online në linkun:

<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>;  
<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>;  
<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>;  
<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>;  
<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>;  
<https://drive.google.com/drive/folders/1DYSNOWB799MKPdYVrKy0EstcrZXAzrFf>.

Pas konsultimit të observacioneve, grupi i auditimit, aty ku e gjykoi të arsyeshme reflektoi përshtatjet dhe ndryshimet përkatëse.

Raporti përfundimtar është hartuar nga:

1. Silvana Ramadani, audituese e parë, përgjegjëse grupi;
2. Miranda Misini, audituese e parë, anëtare;
3. Reinis Xhelili, auditues i dytë, anëtar.

Procesi auditues u mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme nga drejtori i departamentit, z. Rinald Muça.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar nr. 188, dt. 31.12.2019.

## PËRMBAJTJA

<b>1. RËNDËSIA E AUDITIMIT .....</b>	<b>6</b>
1.1 Konteksti i problemit social dhe performancës .....	6
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës.....	9
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë .....	9
1.4 Subjektet nën auditim .....	10
1.4.1 Hyrje në subjektet nën auditim .....	10
1.4.2 Politikat e institucioneve .....	12
1.4.3 Pesha në buxhet dhe GDP .....	14
1.4.4 Risqet e aktivitetit të institucioneve.....	17
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjekteve .....	20
1.4.6 Feedback-u i subjekteve përgjatë auditimit.....	22
<b>2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT .....</b>	<b>25</b>
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës .....	25
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës .....	25
2.1.2 Objektivi i auditimit .....	26
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia .....	26
2.3 Burimet e kritereve .....	28
2.3.1 <i>Burimet e kriterevetë politikës</i> .....	28
2.3.2 <i>Burimet e kritereve të monitorimit dhe raportimit</i> .....	28
2.3.3 <i>Burimet e kritereve teknike</i> .....	29
2.3.4 <i>Burimet e kritereve të tjera/Praktikat më të mira</i> .....	30
2.4 Piramida e pyetjeve audituese .....	30
2.5 Skema e auditimit.....	31
2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit.....	31
2.5.2 Metodatat/teknikat audituese .....	31
2.6 Rezultatet e parashikuara.....	31
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë .....	32
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit.....	32
2.6.3 Forma e publikimit .....	32
<b>3.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE .....</b>	<b>33</b>
NËNPYETJA 1 .....	34
3.1.1 A ka nxitur dhe siguruar AKEP konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare? .....	34
NËNPYETJA 2 .....	56
3.1.2 A ka garantuar AKEP mbrojtje dhe besueshmëri të konsumatorëve në tregun e telefonisë celulare?.....	56
<b>4. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE .....</b>	<b>78</b>
ANEKS: RRJETI I GJENERATËS SË PESTË (5G).....	79

## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1:</b> Pjesa e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë dhe indeksi HHI .....	8
<b>Tabela 2:</b> Të ardhurat dhe shpenzimet e AKEP për periudhën 2017 – 2018 .....	15
<b>Tabela 3:</b> Klasifikimi i risqeve në risk strategjik, financiar, juridik, taktik, operacional .....	20
<b>Tabela 4:</b> Mbikëqyrja e Konkurrencës në Tregun e Telefonisë Celulare .....	22
<b>Tabela 5:</b> Alokimi i brezit të frekuencave 800 hhz .....	42
<b>Tabela 6:</b> Inspektimet e kryera të sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike.....	58
<b>Tabela 7:</b> Zonat për mbulim me shërbim nëpërmjet investimeve të përbashkëta .....	62
<b>Tabela 8:</b> Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (MTR) në vendet e BE, BEREC dhe Shqipëri (në eurocent dhe lekë).....	71
<b>Tabela 9:</b> Krahasimi i MTR-ve mes Shqipërisë dhe në vendeve të rajonit (në eurocent dhe lekë) .....	73

## LISTA E FIGURAVE

<b>Figura 1:</b> Tarifat MTR sipas vendeve të BEREC (Janar 2019) .....	7
<b>Figura 2:</b> Analiza PESTLE.....	18
<b>Figura 3:</b> Analiza SWOT .....	19
<b>Figura 4:</b> Hartë konjitive e çështjes nën auditim .....	25
<b>Figura 5:</b> Marrëdhëniet dhe rrjedha e pagesës.....	69
<b>Figura 6:</b> Procesi i uljes së tarifave të terminimit.....	70

## LISTA E GRAFIKEVE

<b>Grafiku 1 :</b> Sufiçiti që AKEP derdh në buxhetin e shtetit.....	16
<b>Grafiku 2:</b> Pësia e tregut të telefonisë celulare në GDP .....	17
<b>Grafiku 3:</b> Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (MTR) në vendet e BE, BEREC dhe Shqipëri (lekë/minutë) .....	72
<b>Grafiku 4:</b> A e keni ndërruar ndonjëherë kompaninë telefonike? .....	74
<b>Grafiku 5:</b> A mendoni ta ndërroni kompaninë telefonike? .....	75
<b>Grafiku 6:</b> A mendoni se paketat e ofruara janë të përballueshme për ju? .....	75
<b>Grafiku 7:</b> Sa i kënaqur jeni me kompaninë aktuale në lidhje me: .....	76

## ✂ LISTA E SHKURTIMEVE

---

<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>KD</b>	Këshilli Drejtues
<b>FNT</b>	Fuqi e Ndjeshme në Treg
<b>TIK</b>	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>SKZHI</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
<b>AK</b>	Autoriteti i Konkurrencës
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>INTOSAI</b>	International Organization of Supreme Audit Institutions
<b>ISSAI</b>	International Standards of Supreme Audit Institutions
<b>BE</b>	Bashkim European
<b>KE</b>	Komisioni European
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

---

# 1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka konceptuar auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin e ri Strategjik 2018-2022, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit. Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Në linjë me rekomandimet e Progres-Raportit 2019 të BE-së dhe Strategjinë institucionale 2018-2022, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit.

Auditimi me temë “Mbikëqyrja e Tregut të Telefonisë Celulare” është një propozim që paraqitet në planifikimin operacional të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është miratuar në programin e veprimtarisë audituese të KLSH-së për vitin 2019 me vendimin nr. 259, datë 31.12.2018.

Duke vlerësuar rëndësinë dhe rolin që ka Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telekomunikacionit, me qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe ofrimin e shërbimeve cilësore kah qytetarit, ky auditim performance synon të orientojë AKEP kah menaxhimin me efektivitet të mbikëqyrjes së tregut të telefonisë celulare dhe përmirësimin të shërbimeve që ofron ndaj qytetarëve, si dhe të informojë qytetarët rreth transparencës së menaxhimit të këtij tregu.

## 1.1 Konteksti i problemit social dhe performancës

Në epokën e digjitalizimit, telefonat celularë janë një mjet i domosdoshëm komunikimi dhe janë bërë pjesë e pandashme e çdo individi. Në vitin 2018, numri i përdoruesve të shërbimeve celulare në mbarë botën ishte 5,1 miliardë, duke zënë 67% të popullsisë globale.<sup>1</sup> Në Shqipëri, numri i përdoruesve aktivë<sup>2</sup> të shërbimeve celulare në vitin 2018 ishte rreth 2,7 milionë (nga 2,85 milionë<sup>3</sup> banorë që ka Shqipëria), duke gjeneruar rreth 6 miliardë minuta në vit. Gjithashtu, një përdorues celular aktiv gjatë vitit 2018 ka kryer mesatarisht 158 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 31 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 2,6 GB në Internet broadband.<sup>4</sup>

Nga shifrat e mësipërme vihet re një përdorim i lartë i shërbimeve të telefonisë celulare, ku në vitin 2017 një përdorues celular ka paguar mesatarisht rreth 3,12 lekë/minutë<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> GSMA “The Mobile Economy 2019” London, 2019.

<sup>2</sup> Përdorues aktiv quhet ai që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit.


<sup>3</sup> INSTAT “Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2019” Janar, 2019.

<sup>4</sup> AKEP “Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2018” Tiranë, 2019.

<sup>5</sup> ARPM (Average revenue Per Minute/ e Ardhura Mesatare Për Minutë) është tregues i tarifave mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

dhe në bazë vjetore një përdorues aktiv ka paguar rreth 6.109 lekë,<sup>6</sup> ndërsa në vitin 2018 një përdorues celular ka paguar mesatarisht rreth 3,47 lekë/minutë dhe në bazë vjetore ka paguar rreth 7.778 lekë.<sup>7</sup>

**Figura 1:** Tarifat MTR sipas vendeve të BEREC (Janar 2019)



Burimi: BEREC, 2019

Nëse i referohemi tarifave mesatare të terminimit (MTR) në vendet e BEREC<sup>8</sup> siç paraqiten në figurën e mësipërme, ato variojnë nga 0,4 eurocent në Maltë në 2,7 eurocent në Zvicër. Tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC variojnë nga 0,77 eurocent/min, që është mesatarja e thjeshtë aritmetike në 28 vendet anëtare të BE (EU Avg (S)) deri në 0,88 eurocent/min që është mesatarja e thjeshtë aritmetike e 37 vendeve të BEREC (Average S).<sup>9</sup> Tarifa e terminimit në Shqipëri është 0,98 eurocent/min, më e lartë se mesatarja e thjeshtë në vendet e BE dhe se tre mesataret e tjera të përlogarituar nga BEREC. Shqipëria është vendi i 9-të me tarifën më të lartë nga 37 vendet e BEREC. Kjo tarifë ka filluar të aplikohet pas datës 01.12.2018, ku me Vendimet e Këshillit Drejtues<sup>10</sup> për reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020, u vendos tarifa në nivelin e 1,22 lekë/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1,11 lekë/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP. Deri në këtë periudhë, MTR në Shqipëri ishte 1,48 lekë/min.

<sup>6</sup> ARPU (Average Revenue Per User/ E ardhura Mesatare Për Përdorues) është tregues i shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

<sup>7</sup> AKEP “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare” Miratuar me VKD nr. 10, datë 17.04.2019.

<sup>8</sup> Vendet e BEREC janë 28 shtetet anëtare të BE-së plus 4 shtetet e EFTA-s (Zvicra, Islanda, Norvegjia dhe Lihtenshtajni) dhe 5 shtetet kandidatë Shqipëria, Mali i Zi, MK, Serbia dhe Turqia.

<sup>9</sup> BEREC “Termination rates at the European level” January 2019.

<sup>10</sup> Vendimet Nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018 të Këshilli Drejtues.

Përveç tarifave në dukje të larta, një problematikë tjetër është edhe niveli i ulët i konkurrueshmërisë së tregut të telefonisë celulare. Dalja nga tregu e operatorit Plus Communication e ka ndryshuar strukturën e tregut nga 4 në 3 operatorë, duke vijuar trendin rritës të indeksit të përqendrimit.<sup>11</sup> Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2017-2018, së bashku me indeksin HHI 12 të përqendrimit, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1:** Pjesa e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë dhe indeksi HHI

		Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
<b>Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë)</b>	2017	32%	49%	14%	5%	3.676
	2018	34%	50%	15%	-	3.954
<b>Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare</b>	2017	34%	48%	13%	6%	3.620
	2018	37%	47%	16%	-	3.842
<b>Përdorues aktivë broadband (3G/4G)</b>	2017	30%	51%	14%	5%	3.708
	2018	37%	47%	16%	-	3.842
<b>Thirrje dalëse</b>	2017	34%	48%	11%	7%	3.646
	2018	35%	52%	13%	-	4.093
<b>SMS dalëse</b>	2017	25%	60%	10%	5%	4.325
	2018	27%	61%	12%	-	4.602
<b>Trafiku të dhëna (Gbyte)</b>	2017	24%	55%	18%	5%	3.970
	2018	26%	55%	19%	-	4.086
<b>Të ardhura totale nga komunikimet</b>	2017	30%	49%	12%	2%	3.549
	2018	32%	54%	14%	-	4.136
<b>Të ardhura retail</b>	2017	31%	50%	13%	5%	3.746
	2018	32%	54%	14%	-	4.136

Burimi: AKEP, 2019

Indeksi i HHI është në nivele mbi 2.500 për të gjithë treguesit e marrë në analizë, gjë e cila sipas përcaktimeve të këtij treguesi, tregon se tregu është me një përqendrim shumë të lartë dhe kjo për shkak të rritjes gjithnjë e më shumë të pjesës së tregut të sipërmarrësit me pjesën më të madhe të tregut.

Ndryshe nga tregu shqiptar i telefonisë celulare, ku pjesa e tregut e operatorit lider në treg ka tendencë në rritje, dinamika e tregjeve në vendet e BE ka lëvizur në kah të kundërt, pasi pjesa e tregut e operatorit kryesor celular në vendet e BE mesatarisht ka qenë në reduktim.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> AKEP “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” Miratuar me VKD nr.11, datë 17.04.2019.

<sup>12</sup> HHI (Herfindahl-Hirschman Index), i matur si shuma e katroreve të pjesëve të tregut të gjithë lojtareve të tregut. Tregjet me tregues përqendrimi nën vlerën 1,500 konsiderohen si tregje konkurruese, tregjet me tregues përqendrimi HHI midis 1,500 – 2,500 konsiderohen si tregje me përqendrim të moderuar, ndërsa tregjet me tregues 2,500 ose më shumë vlerësohen si tregje me përqendrim të lartë (konkurrueshmëri e ulët).

<sup>13</sup> AKEP “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” Miratuar me VKD nr. 11, datë 17.04.2019.



## **1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtruara në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISSAI) dhe praktikave më të mira evropiane, synon të kërkojë vlerën e parasë së shpenzuar të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të tyre me efektivitet, efizienzë dhe ekonomikitet, për një shërbim sa më të mirë dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarit dhe taksapaguesit shqiptarë.<sup>14</sup>

Ky auditim performance u krye duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100 & 3200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës dhe Indikatorët e Performancës sipas eksperiencës britanike, të cilët shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh, që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, synon t'iu përgjigjet sfidave dhe kërkesave të kohës, duke u aftësuar t'u qëndrojë dhe përshtatet ndryshimeve në mjedisin rrethues, me të cilat ballafaqohet sektori publik. Ky auditim e ndihmon Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të identifikojë mangësitë në politikat e hartuara në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telefonisë celulare, si dhe të synojë përdorimin e metodave dhe mjeteve sa më me efektivitet për arritjen e rezultateve me të njëjtën kosto.

Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 300, 3000, 3100 & 3200) nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve dhe nëpërmjet këtij auditimi performance synohet në çdo rast vlerësimi i cilësisë së shërbimit që marrin qytetarët nga kompanitë e telekomunikacionit, të cilat mbikëqyren nga AKEP.

## **1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë**

Në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në vitin 2017 KLSH ka kryer një auditim tematik mbi prokurimin me objekt *“Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”* miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 20, dt. 19/03/2017. Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Kontraktor ka zgjatur procedurat e prokurimit në mënyrë jo të argumentuar, duke mos analizuar shkaqet e argumentimeve kontradiktore të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në rastin e s'kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik TCl International. Zgjatja për më shumë se një vit e një procedure, ka sjellë jo vetëm mungesë të një shërbimi të rëndësishëm për zhvillimin e sistemit kombëtar të monitorimit të frekuencave, por shoqërohet edhe me mospërdorimin e fondet publike të vëna në dispozicion, duke ulur ekonomikitetin, efektivitetin dhe efizienzën e burimeve në dispozicion.

Në këtë institucion nuk është kryer asnjë auditim performance, prandaj ky auditim ka një rëndësi të vecantë si për qytetarët të cilët do të kuptojnë se sa efektivisht

---

<sup>14</sup>Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022.

mbikëqyren kompanitë celulare për shërbimet që ofrojnë, ashtu edhe për AKEP, i cili nëpërmjet këtij auditimi mundet të evidentojë më mirë problematikat, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale nëpërmjet zbatimit të rekomandimeve.

## **1.4 Subjektet nën auditim**

Tregu i telefonisë celulare luan një rol tepër të rëndësishëm jo vetëm në jetën e individëve, por edhe në aspektin ekonomik të një vendi. Duke vlerësuar rëndësinë dhe rolin që ka në mbikëqyrjen dhe rregullimin e këtij tregu në Republikën e Shqipërisë, subjekti që grupi auditues ka përfshirë në këtë auditim është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). AKEP është person juridik, publik, jobuxhetor, i cili drejtohet nga Këshilli Drejtues, që është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave. AKEP luan një rol të posaçëm në përmirësimin e efektivitetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe ofrimin e shërbimeve cilësi-çmim kah qytetarëve. Në linjë edhe me temën e këtij auditimi, vlerësimi i masave të marra nga ky institucion, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të sistemit të tregut të telekomunikacionit në drejtim të ruajtjes së konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorëve janë objektivi që kanë shoqëruar këtë auditim.

Ky auditim u adresua gjithashtu edhe pranë Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni përgjegjës i cili siguron konkurrencë të lirë dhe efektive në tregun e telekomunikacionit, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës”<sup>15</sup>. Në bashkëpunim me AKEP, AK vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës. Pavarësisht rëndësisë institucionale të AK-së në rregullimin e tregut të telekomunikacionit, Grupit të Auditimit i është refuzuar ushtrimi i kompetencave audituese pranë këtij institucioni përmes vendim-marrjes së Komisionit të AK-së, me pretendimin se ky auditim çënon pavarësinë institucionale të Autoritetit të Konkurrencës.

Bazuar në Ligjin “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”<sup>16</sup>, MIE është institucion rregullator në fushën e telekomunikacionit, i cili harton dhe paraqet në Këshillin e Ministrave propozimet për politikën e sektorit të komunikimeve elektronike dhe projektaktet ligjore e nënligjore, për zhvillimin e këtij sektori.

Nga sa më sipër, me qëllim përmbushjen e kompetencave ligjore MIE duhet të bashkëpunojë me AKEP për një rregullim efektiv të tregut të telekomunikacionit, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e objektivave të paracaktuara mbi këtë treg.

Grupi i Auditimit ka vlerësuar të përfshijë si subjekt nën auditim edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim kryqëzimin e të dhënave për vlerësimin e bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet MIE-së dhe AKEP-it, për rregullimin e tregut të telekomunikacionit.

### **1.4.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

*“Konsumatorët më të pakënaqur janë burimi më i mirë drejt përmirësimit”*

-Bill Gates-

---

<sup>15</sup> Ligji Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”

<sup>16</sup> Ligj nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) për komunikimet elektronike në republikën e shqipërisë

Zhvillimet e shërbimeve të Post-Telekomunikacioneve janë diktuar nga nevoja për komunikim në distancë, si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik, kulturor, shoqëror e shpirtëror të vendeve. Me gjithë përpjekjet për të krijuar një strukturë, e cila do të lehtësonte komunikimet brenda dhe jashtë vendit, gjatë Luftës së Parë Botërore ndërlidhja pësoi shkatërrime. Transformimet rifilluan menjëherë pas krijimit të shtetit të ri shqiptar në vitin 1920.

Në vitin 1922, pranë Ministrisë së Punëve Botore u krijua Administrata e Shtetit Shqiptar për ndërlidhjen, e cila aderoi si anëtare në Bashkimin Ndërkombëtar Postar dhe u bë anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit.

Në vitin 1960 kapaciteti i telefonisë fikse u rrit 4 herë. Ndërkohë, nisur edhe nga nevoja gjithmonë në rritje për komunikim, në vitin 1965, u hapën zyra të Postë-Telekomunikacionit në të gjitha lokalitetet e vendit. Kjo u realizua përmes ndërlidhjes telefonike të drejtpërdrejtë të të gjitha qendrave të rretheve me Tiranën.

Në fillim të viteve '70, sektori i Postë-Telekomunikacionit njohu një tjetër hap të rëndësishëm: mundësimin e lidhjeve me fshatrat. Pikërisht në këtë vit ndodhi lidhja e drejtpërdrejtë e Tiranës me të gjitha qytetet. Vitet '80 e në vazhdim shënojnë edhe rritjen e fluksit të investimeve, në kuadër të zgjerimit të kapaciteteve të centraleve nëpër qytete, për fuqizimin dhe zhvillimin e bazës teknike, si dhe për montimin e aparaturave të sistemit të numërimit, duke lehtësuar ndjeshëm rrugën e komunikimit telefonik.

Para vitit 1990, Shqipëria ishte një nga vendet më të izoluara dhe më të kontrolluara në botë, ku instalimi dhe mirëmbajtja e një sistemi telekomunikacioni ndërkombëtar dhe vendas ishte e ndaluar. Telefonuesit duhet të flisnin në fillim me operatorin që të lidheshin më pas me personin në anën tjetër të telefonit.

Ndërkohë, vitet '90 sollën një valë të re ndryshimesh pozitive në vendin tonë, që përkuan me instalimin e një sistemi të ri, i cili u shoqërua edhe me ndryshime galopante në fushën e telekomunikacionit.

Në vitin 1992 Qeveria Shqiptare miraton Master Planin për zhvillimin e telekomunikacioneve në Shqipëri, me financues Telekomi Shqiptar, Qeveria Shqiptare, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe qeveria e Italisë, Zvicrës dhe Norvegjisë dhe me drejtim të firmës konsultuese finlandeze TELECON LTD, me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Postë-Telekomunikacionit, Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit dhe Telekomit Shqiptar. Plani fokusohet në zhvillimin e një rrjeti hierarkik digjital, i cili do t'i shërbente qendrave të populluara më të rëndësishme dhe zonave tregtare të Shqipërisë dhe bazohej në përdorimin e centraleve digjitale në zonat ku potenciali i kërkesave për shërbim kalonte numrin e 10 mijë abonentëve.

Telekomi Shqiptar nënshkruan kontrata me firmën Alcatel për instalimin e 66 mijë numrave telefonikë dhe me firmën Sirti për ndërtimin e rrjetit ndërurban të transmetimit, bazuar në teknologjinë SDH me fibra optike dhe radiorele.

Në Nëntor të vitit 1995, Kuvendi i Shqipërisë miraton ligjin "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me asistencë të programit PHARE. Në bazë dhe me qëllim vënien në zbatim të këtij ligji, krijohet Departamenti i Postë Telekomunikacioneve në varësi të Këshillit të Ministrave.

AKEP (Ish-Enti Rregullator i Telekomunikacioneve) ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 1998, si autoritet rregullator i tregut të telekomunikacioneve, një organizëm shtetëror jobuxhetor.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Qëllimi i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përfshin:

1. Mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telekomunikacionit;
2. Nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;
3. Mbrojtjen e konsumatorëve, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësi-çmim kah qytetarëve.

Misioni i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është:

“AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mire për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri”.<sup>17</sup>

#### **1.4.2 Politikat e institucioneve**

Bazuar në misionin institucional, AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve, duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët, zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

Në kuadër të objektivave rregullatore, AKEP planifikon programin e tij të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore strategjike të veprimtarisë së tij institucionale.

Bazuar në ecurinë e sektorëve të komunikimeve elektronike, problematikës së evidentuar në këtë sektor, si dhe me qëllim rritjen e efikasitetit të punës, AKEP përpiloi në vitin 2018 për herë të parë një dokument mbi objektivat strategjike institucionale, fokusuar në disa çështje kryesore:

1. Kushte të favorshme për investitorët;
2. Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve;
3. Përfitimet për konsumatorët;
4. Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe partneriteti me institucionet në vend.<sup>18</sup>

Me qëllim vënien në zbatim të objektivave, për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar në mënyrë më përshkruese prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që do të ndërmerren.

<sup>17</sup> <https://akep.al/2019/02/02/misioni/>

<sup>18</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

### 1. Kushte të favorshme për investitorët<sup>19</sup>

- Rregulla të qarta dhe të qëndrueshme për zhvillimin e infrastrukturës së *broadband*;
- Promovimi i investimeve në infrastrukturën e fibrave optike.
- Përsheptimi i procedurës për caktimin e spektrit të disponueshëm, që është i përshtatshëm për shërbime *broadband*.
- Mbështetje e iniciativave për zhvillimin e *broadband* në zonat komercialisht jo-tërheqëse.

### 2. Nxitja e konkurrencës së drejtë dhe të ndershme midis operatorëve<sup>20</sup>

- Përsheptimi i procesit për përmbylljen e raundit të radhës për Analizat e Tregut, dhe vendosja e masave proporcionale ndaj sipërmarrësve me FNT.
- Identifikimi në kohë i sjelljeve strategjike anti-konkurruese të operatorëve me FNT me vëmendje të veçantë ndaj çmimeve anomalisht të ulëta, si element i kësaj sjelljeje.
- Bashkëpunim i ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës.
- Analizë e situatës me kompensimet ndërmjet operatorëve dhe rishikim i masave regullatore në këtë drejtim.
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët në AKEP për analizat e tregut dhe proceset e vendim-marrjes. Nisja e mbledhjes së të dhënave nga burime alternative dhe krahasimin me praktikat më të mira të industrisë.

### 3. Përfitimet e konsumatorit<sup>21</sup>

- Mundësimi i një procesi efektiv të bartjes së numrit brenda 24 orëve.
- Mbështetje e veprimtarisë së qeverisë për tarifën zero të *roaming* me vendet fqinje dhe reduktim të ndjeshëm të tarifave *roaming* me vendet e Bashkimit Europian.
- Përsheptimi i procedurave për nisjen e operimit të skemës së Shërbimit Universal.
- Mbrojtje e kusjdesshme për përdoruesit me të ardhura të ulëta.
- Përqendrimi i përpjekjeve për arritjen e objektivave të *broadband* (30 Mbps për 100% të popullsisë dhe 100 Mbps për 50% të popullsisë).
- Integriteti i të dhënave të pajtimtarëve, rishikim i situatës ekzistuese dhe mundësim i saktësisë së plotë të të dhënave të pajtimtarëve.
- Mbulimi me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritja e cilësisë së shërbimit.

### 4. Eficienca e brendshme e AKEP dhe partneriteti me institucionet<sup>22</sup>

- Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP-it, si edhe vlerësimin e nevojës për ndryshime të mundshme në legjislacion.
- Rritje e mëtejshme e kapaciteteve strategjike, menaxheriale dhe teknike të stafit të AKEP-it.

---

<sup>19</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

<sup>20</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

<sup>21</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

<sup>22</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

- Veprimtari e hapur dhe transparente në përputhje me praktikën më të mirë rregullatore të BEREC/ERGP dhe vendeve të BE. Krijimi i grupeve specifike të punës, për të mbajtur marrëdhënie pune aktive me BEREC. Rishikim i mënyrës se si i delegohen përgjegjësitë autoriteteve të tjera në rast se AKEP nuk është autoriteti përgjegjës.
- Bashkëpunimi i ngushtë me AK dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit.
- Dhënie kontributi në rishikimin e strategjisë *broadband* për përfshirjen e aksesit *broadband* në objektin e shërbimit universal.
- Bashkëpunim me Bankën Botërore dhe palët e interesuara në projektin e BB: *Balkans Digital Highway*.

### 1.4.3 Pesha në buxhet dhe GDP

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është person juridik, publik, jobuxhetor. AKEP nëpërmjet burimeve ligjore të financimit siguron të ardhurat e nevojshme për mbulimin e fondit të shpenzimeve administrative për vitin korrent, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave. Burimet e financimit janë pagesat që kryhen në AKEP për:

- mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike (deri në 0,5% të së ardhurës vjetore të realizuar vitin e mëparshëm);<sup>23</sup>
- caktimin dhe përdorimin e frekuencave;<sup>24</sup>
- caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike;<sup>25</sup>
- mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar deri në 0,5% të së ardhurës vjetore të realizuar vitin e mëparshëm;<sup>26</sup>
- administrimin e *domain* ç.TLD.al dhe *nëndomain*-et e tij;<sup>27</sup>
- administrimin e CRDB (Bazës së të dhënave referencë të centralizuara) për portabilitetin e numrit.<sup>28</sup>

Jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të çdo viti financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare cakton një fond të shpenzimeve administrative, të parashikuara, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave. Jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit financiar, AKEP përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Projektbuxheti i tij propozohet për shqyrtim dhe miratim nga

<sup>23</sup> Sipas përcaktimeve në nenin 24 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores Nr. 20, datë 28.12.2015 “Për Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.

<sup>24</sup> Sipas përcaktimeve në nenin 78 të ligjit nr. 9918 dhe VKM nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktim dhe përdorim të frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, i ndryshuar”.

<sup>25</sup> Sipas përcaktimeve në nenin 86 të ligjit nr. 9918 dhe VKM nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktim dhe përdorim të frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, i ndryshuar.

<sup>26</sup> Sipas nenit 27 të ligjit nr. 46/2015 dhe Rregullores Nr. 20, datë 28.12.2015 “Për Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.

<sup>27</sup> Sipas përcaktimeve në Rregulloren Nr. 02 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”

<sup>28</sup> Sipas përcaktimeve në neniN 21 te Rregullores nr.43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”.

Këshilli i Ministrave si bashkëpropozim i ministrit me Ministrin e Financave. Të gjitha të ardhurat e tepërta të AKEP kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Për vitin 2017, buxheti i AKEP u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 62 datë 03.02.2017 në vlerën 363,02 milionë lekë. Të ardhurat totale gjatë këtij viti u realizuan në shumën 357,57 milionë lekë, ose rreth 99% e programit. Niveli i pagesës së mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2017 ishte 0,37% ndërsa niveli i pagesës së mbikëqyrjes së tregut të ofruesve të shërbimeve postare ishte 0,41% e të ardhurave të vitit të mëparshëm të këtyre tregjeve. Shpenzimet e AKEP rezultuan 295,96 lekë ose rreth 82% e programit. Kjo diferencë midis faktit dhe programit vjen si rrjedhojë e uljes së çmimeve të prokurimit sipas objekteve, si dhe nga mosrealizimi i disa objekteve të shpenzimeve për investime dhe të shpenzimeve administrative. Sufiçiti, së bashku me debitë e mbledhura, pas veprimeve rregulluese në fund të 2017, u derdhën në buxhetin e shtetit në vlerën 82,05 milionë lekë.

Për vitin 2018, buxheti i AKEP u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.86 datë 14.02.2018 në vlerën 388,70 milionë lekë. Të ardhurat e AKEP gjatë këtij viti u realizuan në vlerën 360,71 milionë lekë, pra 27,9 milionë më pak sesa planifikimi. Impaktin më të madh në këtë mosrealizim e kishte ulja e të ardhurave të operatorëve të tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2017 dhe shtyrja e afatit të alokimit të brezit 800 MHz për shërbimet celulare dhe procedurave të tenderimit të këtyre brezave. Niveli i pagesës së mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2018 ishte 0,5% dhe niveli i pagesës së mbikëqyrjes së tregut të ofruesve të shërbimeve postare ishte 0,38% e xhiros së vitit të mëparshëm. Totali i shpenzimeve të AKEP për vitin 2018 është 328,00 milionë lekë, e shprehur në përqindje rreth 84,4 % e programit të planifikuar. Sufiçiti, së bashku me debitë e mbledhura, pas veprimeve rregulluese në fund të 2018, u derdhën në buxhetin e shtetit në vlerën 34,55 milionë lekë.

**Tabela 2:** Të ardhurat dhe shpenzimet e AKEP për periudhën 2017 – 2018


*në milionë lekë*

		Viti 2017	Viti 2018
<b>I</b>	<b>TË ARDHURAT (PAGESAT E KRYERA NË AKEP)</b>		
1	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	161,38	180,25
2	Pagesa për caktim dhe përdorimin të frekuencave	131,45	123,79
3	Pagesa për Numeracion	27,85	25,96
4	Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,00	14,20
5	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	8,50	8,50
6	Pagesa për Domain	7,59	7,59
7	Pagesa dhe të ardhura të tjera	0,80	0,41
	<b>TOTAL TË ARDHURA</b>	<b>357,57</b>	<b>360,70</b>
<b>II</b>	<b>SHPENZIMET</b>		
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	79,59	80,38
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,59	11,24
3	Shpenzime për materiale	5,58	6,99
4	Shpenzime për shërbime	86,17	101,84

<b>5</b>	Shpenzime për investime	114,03	127,56
	<b>TOTAL SHPENZIME</b>	<b>295,96</b>	<b>328,00</b>
<b>III</b>	<i>Tarifa e shërbimit të radio-komunikacionit</i>		
<b>1</b>	<i>Arkëtuar në llogarinë e AKEP për buxhetin e Shtetit</i>	518,35	462,34
<b>2</b>	<i>Të ardhurat si agjent tatimor</i>	25,92	23,12
	<i>Nga kjo:</i>		
<b>a</b>	<i>Për shpërblime nga të ardhurat si agjent tatimor</i>	20,97	13,31
<b>b</b>	<i>Për blerje pajisje dhe investime</i>	4,92	9,37
<b>IV</b>	<b>DERDHUR NË BUXHETIN E SHTETIT</b>	<b>82,05</b>	<b>34,55</b>

Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga grupi i auditimit

**Grafiku 1 : Sufiçiti që AKEP derdh në buxhetin e shtetit**



Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga grupi i auditimit

Përveç të ardhurave të përmendura më lart, AKEP përfiton të ardhura edhe si agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.<sup>29</sup> Sipas udhëzimit nr. 27, datë 16/12/2014, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, AKEP mban në burim 5% të këtyre të ardhurave. Për vitin 2017 janë arkëtuar për Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit 518,35 milionë lekë, nga të cilat janë mbajtur në burim nga AKEP 25,92 milionë lekë. Këto të ardhura të përfituara si agjent tatimor, janë përdorur për shpërblimin e punonjësve në shumën 20,97 milionë lekë dhe për blerje pajisjesh monitorimi në shumën 4,9 milionë lekë. Për vitin 2018 janë arkëtuar për Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit 462,35 milionë lekë, nga të cilat janë mbajtur në burim nga AKEP 23,12 milionë lekë. Këto të ardhura të përfituara nga komisionet si agjent tatimor janë përdorur për shpërblimin e punonjësve në vlerën 13,31 milionë lekë dhe për blerje pajisjesh monitorimi në vlerën 9,37 milionë lekë, sipas përcaktimeve të nenit 8, të ligjit 9975/2008.<sup>30</sup>


<sup>29</sup> Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 06.10.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit" i ndryshuar

<sup>30</sup> Komisionet e përfituara përdoren: a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për



Duke qenë se AKEP është institucion jobuxhetor, nuk financohet nga buxheti i shtetit, por kontribuon në buxhetin e shtetit me tepricat e buxhetit të tij. Në vitin 2017 AKEP ka derdhur në buxhetin e shtetit 82,05 milionë lekë ose 0,018% të totalit të këtij buxheti ndërsa në vitin 2018 ka derdhur 34,55 milionë lekë ose 0,007% të total buxhetit të shtetit.

Për të parë rëndësinë e tregut të telefonisë celulare, në grafikun e mëposhtëm është paraqitur totali i të ardhurave të këtij tregu dhe pesha që zënë në Produktin e Brendshëm Bruto.



Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në vitin 2017, totali i të ardhurave të tregut të telefonisë celulare ishte 29,74 miliardë lekë dhe zinte 1,91% të GDP-së ndërsa në vitin 2018 të ardhurat ishin 26,85 miliardë lekë, duke përbërë 1,63% të GDP-së.

#### **1.4.4 Risqet e aktivitetit të institucioneve**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, çdo institucion përballet me një sërë problemesh dhe kërcënimesh të cilat mund t'i vijnë nga mjedisi i brendshëm ose nga mjedisi i jashtëm. Një mjet analitik i cili mundëson identifikimin e faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe ndikimin që mund të kenë këta faktorë në veprimtarinë e AKEP në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telefonisë celulare, është analiza PESTLE. Më poshtë janë analizuar 6 lloje faktorësh që ndikojnë pozitivisht ose negativisht, në mënyrë direkte ose indirekte në performancën e AKEP gjatë mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregu të telefonisë celulare: faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ligjorë dhe mjedisorë. Nëpërmjet PESTLE<sup>31</sup> do të analizohet mjedisi i jashtëm në nivel makro dhe


---

përballimin e vjeljes së taksave; c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

<sup>31</sup> **P** - Politik: shpjegojnë ndikimin që mund të ketë qeveria në ekonomi dhe në veprimtarinë e institucioneve nëpërmjet politikës së taksave, rregulloreve të tregtisë me jashtë, rregulloreve mjedisore, ligjeve për punonjësit dhe për mbrojtjen e konsumatorëve.

do të paraqiten kërcënimet apo mundësitë që i vijnë AKEP nga faktorët jashtë kontrollit të tij.

**Figura 2: Analiza PESTLE**



Burimi: Grupi i auditimit

Pas analizës PESTLE, e cila paraqet risqet që i vijnë institucionit nga mjedisi i jashtëm, është me rëndësi që të analizohen edhe risqet që vijnë nga mjedisi i brendshëm. Analiza SWOT<sup>32</sup> paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë “brenda kontrollit menaxherial”, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë “jashtë kontrollit menaxherial” ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.

**E** – Ekonomik: paraqesin ndikimin që mund të ketë ndryshimi i faktorëve si norma e interesit, norma e inflacionit, kursi i këmbimit, rritja ekonomike, të ardhurat për frymë, norma e papunësisë, taksat, praktikat e punës dhe globalizimi.

**S** – Social: i referohen normave dhe qëndrimeve kulturore, besimeve dhe traditës, historisë, demografisë, stilit të jetesës dhe nivelit të edukimit.

**T** – Teknologjik: paraqesin trendet teknologjike, inovacionet, kërkim-zhvillimin.

**L** – Ligjor: përfshijnë legjislacionin që ndikon mbi institucionin në fusha si punësimi, konkurrenca, shëndeti dhe siguria.

**E** – Mjedisor: analizojnë ndryshimet në mot dhe klimë, ligjet mbi ndotjet, riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe përdorimin e produkteve dhe praktikave ekologjike.


<sup>32</sup>**S** – Strengths (Fuqitë): attribute dhe burime të brendshme që sigurojnë rezultate të suksesshme;

**W** – Weaknesses (Dobësitë): attribute dhe burime të brendshme që pengojnë arritjen e rezultateve të suksesshme;

**O** – Opportunities (Shanset): faktorë të jashtëm të cilët institucioni mund t’i përdorë në avantazh të tij;

**T** – Threats (Kërcënimet): faktorë të jashtëm që rrezikojnë suksesin e institucionit.

**Figura 3: Analiza SWOT**



Burimi: Grupi i auditimit

Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet. Disa nga risqet e brendshme të këtij institucioni lidhen me mungesën e një plani strategjik deri në vitin 2018, me nivelin e ulët të inspektimeve në tregun e telefonisë celulare, me mungesën e analizës për tregun e pakicës, me mungesën e marrjes së masave për garantimin e ofrimit të Shërbimit Universal dhe mbulimit me valë të gjithë territorin e RSH-së, si dhe në mungesën e efektivitetit në ruajtjen e një tregu konkurrues.

**Tabela 3:** Klasifikimi i risqeve në risk strategjik, financiar, juridik, taktik, operacional

	<b>I ulët</b>	<b>I mesëm</b>	<b>I lartë</b>
<b>Strategjik</b>		Mungesa e një strategjie kombëtare të telekomunikacionit;	Mungesa e një plani strategjik deri në vitin 2018;
<b>Taktik</b>			Mungesa e bashkëpunimit me MIE dhe me AMA për lirimin e brezit 700 MHz; Mungesa e efektivitetit për ruajtjen e konkurrencës së lirë në treg
<b>Operacional</b>			Mungesa e analizës së tregut të pakicës Numri i ulët i inspektimeve në kompanitë e telefonisë celulare; Mungesa e marrjes së masave nga AKEP për garantimin e ofrimit të Shërbimit Universal; Mos marrja e masave për garantimin e mbulimit me valë në të gjithë territorin e RSH-së;
<b>Financiar</b>			
<b>Juridik</b>			

Burimi: Grupi i auditimit

#### **1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjekteve**

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si mbikëqyrës dhe rregullues i tregut të telefonisë celulare dhe garantues në krijimin e një mjedisi të favorshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore kah qytetarëve, AKEP-i ka këto kompetenca:

AKEP përmbush përgjegjësinë e tij për mbrojtje të interesave të konsumatorëve nëpërmjet:<sup>33</sup>

- Mbikëqyrjes, kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike;
- Zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike;
- Nxitjes së konkurrencës efiçente për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, për të krijuar mundësi që çdo kategori përdoruesish, përfshirë dhe përdoruesit me aftësi të kufizuar, të kenë përfitime maksimale në kuptimin e çmimit dhe cilësisë;
- Ndërhyrjes për rregullimin e tarifave për:
  - shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal;
  - shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës të komunikimeve elektronike;
  - vlerësimin e kontratës tip të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike;
  - organizimit të këshillimeve publikimit për dokumenta rregullatorë për tregun e komunikimeve elektronike dhe postare për të tërhequr edhe mendimin e përdoruesit;
  - garantimit të aksesit të barabartë dhe mundësisë së zgjedhjes për përdoruesit me aftësi të kufizuar;
  - garantimit të publikimit të informacionit transparent, të krahasueshëm dhe të përditësuar mbi tarifatat, politikave të kompensimit/rimbursimit;
  - bashkëpunimin me shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve dhe njësive të ngritura pranë institucioneve shtetërore.

Kompetencat kryesore dhe produktet që gjeneron AKEP si institucion përgjegjës në rregullimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike, janë:<sup>34</sup>

- Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike, nëpërmjet parimit të anjanësisë teknologjike;
- Promovimi i konkurrencës dhe infrastrukturës efiçente në komunikimet elektronike me qëllim garantimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Ndërmerr dhe përcakton masa mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurruese;
- AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet nënshkrimit bilateral të MOU mbi parimet e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët, në funksion të konkurrencës efektive në treg dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

---

<sup>33</sup> Ligj nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

<sup>34</sup> Ligj nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

**Tabela 4:** Mbikëqyrja e Konkurrencës në Tregun e Telefonisë Celulare

Rregullimi sipas AKEP	Ndërhyrjet e Autoritetit të Konkurrencës
1. Analizë e Tregjeve: - Tregjet përkatëse - Shpallja FNT - Masa rregullatore ex-ante	1.Promovimi i konkurrencës së lirë dhe efektive
2. Mbrojtja e Konsumatorit	2.Marrja e masave rregullatore për abuzimin me pozitën dominuese ose marrëveshjet kartel
3. Nxitja e investimeve	3.Kontrolli i Përqendrimeve – Moslejimi i forcimit apo krijimit të pozitës dominuese
4. Ofrimi i shërbimit universal	4.Vendosja e masave <i>ex-post</i> : - Masa të përkohshme - Masa të sjelljes në rastet e abuzimit me pozitën dominuese ose marrëveshjet kartel - Masa administrative - Masa strukturore
5. Net neutrality	
6. Vendosja e masave rregullatore <i>ex-ante</i>	

Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga grupi i auditimit

#### **1.4.6 Feedback-u i subjekteve përgjatë auditimit**

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit bashkëpunoi me subjektin nën auditim, me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Në këtë fazë është vënë re një koordinim jo eficient nga ana e subjektit në përcaktimin e një ambienti pune, duke reflektuar në mos krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e punës audituese nga grupi i auditimit. Megjithatë, pavarësisht nga sa më sipër, AKEP përgjithësisht i është përgjigjur në kohë takimeve prezantuese, takimeve konsultuese dhe intervistave paraprake, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji 154/ 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, me qëllim adresimin e problematikave reale të performancës së subjektit dhe përmirësimit të tyre pas rekomandimeve që do të japë KLSH.

Pas shkresës informuese me nr. prot 425/1, datë 07.06.2019 të dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës për njoftim fillimi të Auditimit të Performancës “Mbikëqyrja e Tregut të Telefonisë Celulare”, AK ka dërguar pranë KLSH-së shkresën me nr. prot 362/2, datë 17.06.2019, me anë të së cilës AK përpigjej të argumentonte përmes vendim-marrjes nga Komisioni i Konkurrencës se ky auditim cënonte pavarësinë e institucionale të AK-së.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga AK dhe me qëllim saktësimin e pozicionit kushtetues të KLSH-së në ushtrimin e veprimtarisë institucionale, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me anë të shkresës nr. prot 425/4 datë 20.06.2019 ka shprehur qëndrim zyrtar kundër pretendimeve të ngritura nga AK, duke saktësuar se një vendim-marrje e tillë e Komisionit për refuzim të zhvillimit të auditimit, bazuar ligjin 9121/2003, i ndryshuar, që shërben si bazë në ushtrimin e veprimtarive institucionale të Komisionit të Konkurrencës është jashtë objektit që përkufizon ky ligj.

Lidhur me pretendimin kryesor të AK-së se KLSH po i cënon veprimtarinë institucionale, KLSH ka theksuar në shkresën e dërguar pranë AK-së se fokusi i mandatuar ligjërisht i punës sonë është pikërisht transparenca dhe këshillimi se si një organ publik, Autoriteti i Konkurrencës për rastin në fjalë, menaxhon fondet publike në përputhje me menaxhimin e shëndetshëm kah 3E-ve.

Për sa më sipër, KLSH bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet saj dhe AK-së, ka bindjen se kjo vendim-marrje e Komisionit shkon ndesh me frymën e bashkëpunimit dhe ka ftuar sërish AK-në të bashkëpunojë me Grupin e Auditimit për të bërë transparente performancën e veprimtarisë institucionale të AK-së, në kuadër të fokusit të auditimit.

Kjo shkresë e përcjellë pranë AK-së, me qëllim bashkëpunimin e frytshëm në përmbushjen e kompetencave institucionale të KLSH-së dhe AK-së, i është dërguar për dijëni edhe Z. Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Z. Erion Braçe, Zv. Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.

Pavarësisht nga sa më sipër, AK nuk është treguar bashkëpunuese duke refuzuar auditimin në proces të nisur nga Departamenti i Auditimit të Performancës, pa asnjë argument ligjor konkret.

Gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit dërgoi pranë MIE dhe AKEP intervistat për konfirmimin e të dhënave zyrtare, në përputhje me nenin 15, pika (dh) dhe (e) si dhe me nenin 26 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Intervista iu dërgua subjekteve nën auditim në mënyrë elektronike dhe shkresore, me datë 19.11.2019 dhe afati zyrtar për gjenerimin e përgjigjeve duhet të ishte data 26.11.2019.

Me datë 22.11.2019, grupit të auditimit nëpërmjet Drejtorit të Kabinetit, znj. E. M, iu dërgua një email nëpërmjet të cilit AKEP kërkonte shtyrjen e afatit për kthimin e përgjigjeve të intervistës deri më datë 05.12.2019. Me qëllim bashkëpunimin dy palësh, grupi i auditimit mirëkuptoi kërkesën e drejtuar nga AKEP, por duke marrë në konsideratë që tejzgjatja e afateve për gjenerimin e përgjigjeve të intervistues cedonte respektimin e afateve të planit vjetor auditues, nëpërmjet e-mailit të dërguar me datë 02.12.2019 i ka sugjeruar subjektit nën auditim që meqënëse do të na i kthenin përgjigjet me vonesë (datë 05.12.2019), observacionet të gjeneroheshin brenda dy javëve nga momenti i marrjes së projekt-raportit dhe jo brenda një muaji kalendarik, sikurse e parasheh ligji ynë.

Nga sa më sipër, AKEP nuk ktheu asnjë përgjigje mbi e-mailin e dërguar, duke treguar indiferencë.

Pavarësisht këtij fakti, më datë 04.12.2019 grupi i auditimit ka kontaktuar me personin e kontaktit z. B. D, duke i kërkuar të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të gjeneruar përgjigjet brenda datës 05.12.2019, afat i kërkuar nga vetë subjekti.

Grupi i auditimit priti kthimin e përgjigjeve deri në përfundimin e orarit zyrtar të punës (16:30) të datës 05.12.2019, por nga AKEP nuk erdhi asnjë përgjigje dhe dokument i kërkuar.

Deri më datë 10.12.2019, në përfundim të fazës së shkrimit të projekt-raportit, grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion përgjigjet për pyetjet e drejtuara dhe as evidencat e kërkuara.

Si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telekomunikacionit, AKEP ishte institucioni kryesor në të cilin u shtri ky auditim. Pavarësisht rëndësisë që ky institucion posedon në tregun e telefonisë celulare, AKEP ka treguar mungesë vullneti dhe bashkëpunimi me grupin e auditimit, në plotësimin e detyrimit ligjor lidhur me gjenerimin e përgjigjeve të intervistës për konfirmimin e të dhënave zyrtare, si edhe për evidentimin e problematikave të këtij tregu, me qëllim përmirësimin e tij.

Mungesë efience u konstatua edhe nga MIE, e cilat pavarësisht përgjigjeve të gjeneruara në kohë, përgjigjet ishin të shkurtra dhe në disa raste të pabazuara në evidenca.

### **Rekomandim:**

Për shkak se mungesa e vënies në dispozicion të evidencave vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe pengon rëndë punën audituese, i rekomandojmë titullarit të subjektit nën auditim z. Tomi Frashëri të nisë procedurë disiplinore për znj. E. M - Drejtor Kabineti dhe z. B. D - Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritit, si personi i kontaktit, duke konkluduar me masë disiplinore proporcionale në përputhje me shkeljen e kryer.

Pas dërgimit të projekt-raportit me nr. prot. 425/13, datë 10.12.2019, grupi i auditimit konstaton, nëpërmjet observacioneve të dërguara nga z. B. D dhe znj. E. M, të cilët në pretendimet e tyre kanë paraqitur kartelin shoqërues që i është bashkëlidhur “Intervistës për konfirmimin e të dhënave zyrtare”, se titullari i institucionit ka përcaktuar personat e ngarkuar për shqyrtimin e intervistës dhe gjenerimin e përgjigjeve. Bazuar në praktikën shoqëruese nr. prot 1577/4, datë 20.11.2019, Kryetari i AKEP z. Ilir Zela ka përcaktuar si persona përgjegjës për shqyrtimin dhe koordinimin e punës:

- Z. P. M - Drejtor i Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore;
- Z. B. D - Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritit;
- Z. A. Rr - Drejtor i Drejtorisë së të Drejtave të Përdoruesve.

### **Rekomandim:**

Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë se mungesa e vënies në dispozicion të evidencave vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe pengon rëndë punën audituese, i rekomandojmë titullarit të subjektit nën auditim z. Tomi Frashëri të nisë procedurë disiplinore edhe për z. P. M - Drejtor i Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, si person kryesor për shqyrtimin dhe koordinimin e kthimit të përgjigjeve të intervistës zyrtare brenda afateve të përcaktuara.



## 2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT


### 2.1 Objektivi dhe problemi i performancës

#### 2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës

Ky auditim u fokusua në efektivitetin e veprimtarisë institucionale të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në proceset e rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregut të telefonisë celulare dhe në masat e ndërmarra nga ky institucion, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor kah qytetarëve. Periudha që u auditua ishin vitet 2017-2018.

Nxitja për ndërmarrjen e këtij auditimi performace erdhi si pasojë e problematikave të evidentuara nga paraqitja në dukje e tarifave të larta për shërbimet e komunikimeve celulare dhe nga niveli i ulët i konkurrueshmërisë së tregut të telefonisë celulare.

**Figura 4:** Hartë konjitive e çështjes nën auditim



Burimi: grupi i auditimit

Është kompetencë e AKEP, si institucioni përgjegjës në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të telekomunikacionit të trajtojë këto çështje, për të siguruar shërbime cilësore ndaj konsumatorëve. Me qëllim realizimin e objektivave institucionale dhe përmirësimin e këtyre parametrave, për herë të parë në vitin 2018, AKEP hartoi një Strategji të veprimtarisë institucionale, e cila kishte në fokus mbrojtjen e konsumatorëve dhe nxitjen e konkurrueshmërisë së lirë dhe të ndershme në treg.

Nga sa më sipër, rrjedhimisht, paradigma e këtij auditimi merr formën: *“Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare menaxhohet me efektivitet nga AKEP, me qëllim nxitjen e konkurrencës eficiente dhe sigurimin cilësorë të shërbimeve të ofruara kah qytetarëve”*.

### **2.1.2 Objektivi i auditimit**

Ky auditim kishte si objektiv vlerësimin e performancës së veprimtarisë institucionale të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me fokus në rolin dhe kontributin e tij në mbikëqyrjen e tregut të telekomunikacionit dhe sigurimit të shërbimeve cilësore ndaj qytetarit, si institucioni përgjegjës rregullator.

Grupi auditues ka vlerësuar, kështu:

1. Efektivitetin e AKEP kah rregullimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të sigurimeve shoqërore për periudhën 2017-2018;
2. Nxitjen e një mjedisi të favorshëm për investitorët dhe ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;
3. Efektivitetin e shërbimeve të ofruara kah qytetarëve, me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore dhe rritjen e transparencës;
4. Koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse në kuadër të përmbushjes së misionit institucional dhe raportin me aktorët e tjerë, të përfshirë në sistem (MIE, AK etj.).

## **2.2 Përkufizimet dhe terminologjia**

Termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **“Akses”** është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Aksesin, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe fasilitetet shoqërore, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në fasilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e softëare-ve përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në përkthimin e numrit (number translation) apo në sistemet, që ofrojnë funksionalitet të njëvlefshëm; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për roamingun; aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale.
- **“Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare”** (më poshtë AKEP) është organi rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
- **“Facilitet”**, si pjesë e infrastrukturës shoqërore të komunikimeve elektronike, përfshin ndërtesën, pjesë të një ndërtese, apo mjediset e pavarura brenda një ndërtese ku janë instaluar pajisje të komunikimeve elektronike, si edhe elemente ndërtimore, të tilla si tubacione kabllorë, shtylla, antena etj.
- **“Integritet i rrjetit”** është funksionimi dhe aftësia për të hyrë në veprim e rrjeteve të komunikimeve elektronike të interkonektuara mes tyre dhe mbrojtja e këtyre rrjeteve ndaj defekteve të shkaktuara nga shqetësimet elektromagnetike dhe/ose ngarkesat e punës.

- **“Komunikim”** është shkëmbimi ose transmetimi i informacionit ndërmjet një numri të kufizuar përdoruesish, por që nuk përfshin transmetimin e informacionit që është pjesë e transmetimeve radio-televizive nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, përveç rasteve kur informacioni mund të ketë të bëjë me një pajtimtar ose përdorues të mirënjohur, i cili merr këtë informacion.
- **“Ministri”** është ministri që mbulon sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet drejtorisë përkatëse.
- **“Operator”** është një sipërmarrës, që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;
- **“Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike”** është ndërtimi, përdorimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë;
- **“Ofruesi i shërbimit universal”** është sipërmarrësi që ofron shërbimin universal.
- **“Pajisje e komunikimeve elektronike”** janë pajisjet teknike për emetimin, transmetimin, rrugëzimin, komutimin dhe/ose marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve elektromagnetike.
- **“Pajtimtar”** është cilido që ka lidhur një kontratë me një sipërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
- **“Përdorues”** është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.
- **“Plani kombëtar i frekuencave”** është dokumenti, që përcakton brezat e frekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave.
- **“Rrjet i komunikimeve elektronike”** janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kablllove elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kablllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.
- **“Sipërmarrës”** është çdo person fizik, juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.
- **“Spektri i frekuencave”** përfshin valët elektromagnetike në diapazonin e frekuencave 9 KHz deri 3000 GHz, të cilat përhapen në efir pa nevojën e linjave të veçanta.
- **“Shërbim i komunikimeve elektronike”** është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorur për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke

përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

- **“Shërbimi universal”** është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme.
- **“Tarifë e orientuar drejt kostos”** është tarifa që reflekton kostot e shfrytëzimit eficient dhe të frytshëm, duke mundësuar një normë fitimi të arsyeshme për sipërmarrësin.
- **“Organi i Rregullatorëve Europeanë për Komunikimet Elektronike (BEREC)”** është organi i krijuar nga Rregullorja (KE) nr. 1211/2009 e Parlamentit European dhe e Këshillit e 25 nëntorit 2009.
- **“Përcaktimi i një brezi frekuencash”** është destinimi i një brezi të dhënë frekuencash në Planin Kombëtar të Frekuencave, me qëllim përdorimi nga një ose më shumë shërbime radio-komunikimi, sipas kushteve specifike.
- **“Caktim i frekuencave”** është dhënia e autorizimit për përdorimin e një frekuence apo kanali frekuence, sipas kushteve specifike.
- **“Pëlqim i subjektit të të dhënave”** është çdo deklaratë me vullnet të plotë e të lirë, e dhënë shprehimisht dhe në dijeni të plotë për çfarë të dhënave do të përpunohen, me të cilën nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënave të tij.
- **“Cënim i të dhënave personale”** është çdo cënim i sigurisë që çon në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen e paautorizuar, aksidentale apo të paligjshme ose aksesit në të dhënave personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara, në lidhje me ofrimin e një shërbimi të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun”.

## **2.3 Burimet e kritereve**

### **2.3.1 Burimet e kriterevetë politikës**

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Këshilli i Ministrave;
- Strategjia Ndërsektoriale “Afhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2010” Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike, Kryeministria;
- Strategjia e Veprimtarisë Institucionale të AKEP 2018-2019.

### **2.3.2 Burimet e kritereve të monitorimit dhe raportimit**

- Raportet vjetore të AKEP për vitet 2017-2018;
- Rezolutat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitet 2017-2018;
- Raportet Statistike të ISSH-së për vitet 2014-2018;
- Strategjia e menaxhimit të riskut të AKEP për vitet 2017-2019;
- Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP lidhur me tregun e telekomunikacioneve për vitet 2017-2019;
- Raportet e Inspektimeve të kryera pranë operatorëve të telefonisë celulare gjatë viteve 2017-2018;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet AKEP-it dhe AK-së.

### **2.3.3 Burimet e kriterëve teknike**


- **Ligji nr.9918, datë 19.5.2008** “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- **Ligj nr. 146/2014** “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- **VKM Nr. 86, datë 14.2.2018** “Për miratimin e buxhetit për autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për vitin 2018”;
- **VKM Nr. 62, datë 3.2.2017** “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2017, për autoritetin e komunikimeve elektronike e postare”;
- **VKM Nr. 277, datë 29.03.2017** “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”;
- **VENDIM Nr.599, datë 23.7.2010** “Për miratimin e pagesave që kryhen në autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”;
- **VKM nr.322, datë 5.5.2010** “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- **Udhëzim Nr. 1, datë 11.04.2017** “Për zbatimin e planit kombëtar të frekuencave për lirimin efektiv të frekuencave të dividendit digjital nga trasmetimet audiovizive”;
- **Rregullore e Brendshme Nr. 7 datë 16.02.2017** “Për funksionimin e Këshillit Drejtues, AKEP”;
- **Rregullore Nr.06, datë 16.02.2017** “Për funksionimin e administratës së autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare”, ndryshuar me vendimin nr.51, datë 03.08.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP;
- **Rregullore Nr. 46, datë 27.10.2016** “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP;
- **Rregullore Nr. 44, datë 13.10.2016** “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, AKEP;
- **Rregullore nr.43** “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, AKEP;
- **Rregullore Nr.37, datë 29.10.2015** “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP;
- **Rregullore Nr. 32, datë 26.12.2013** “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”, AKEP;
- **Rregullore Nr. 2, datë 29.05.2013** “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”, AKEP;
- **Rregullore Nr. 27 datë 21.09.2012** “Mbi Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, e ndryshuar, AKEP;
- **Rregullore Nr. 18, datë 11.06.2010** “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, AKEP;
- **Rregullore Nr. 16, datë 16.04.2010** “Për treguesit e cilësive të shërbimit”, AKEP;
- **Rregullore nr. 19, datë 14.0.2010** Për “Aksesin dhe interkoneksionin”, AKEP;
- **Rregullore nr.20, datë 22.05.2019** “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”

- **Rregullore nr.12, datë 07.04.2010** “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të Sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP;
- **Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009** “Për analizën e tregut”, AKEP.

### 2.3.4 Burimet e kritereve të tjera/Praktikat më të mira

- Directive (EU) 2018/1972 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 - Establishing the European Electronic Communications Code;
- Regulation (EU) 2018/1971 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 establishing the Body of European Regulators for Electronic Communications (BEREC) and the Agency for Support for BEREC (BEREC Office), amending Regulation (EU) 2015/2120 and repealing Regulation (EC) No 1211/2009;

## 2.4 Piramida e pyetjeve audituese



Burimi: Grupi i auditimit KLSH

### Pyetja kryesore:

A ka qenë efektive veprimtaria e AKEP në mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare gjatë periudhës 2017-2018?

### Nënpyetjet e nivelit të parë:

1.1. A ka nxitur dhe siguruar AKEP konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare?

1.2. A ka garantuar AKEP mbrojtje dhe besueshmëri të konsumatorëve në tregun e telefonisë celulare?

**Nënpyetjet e nivelit të dytë:**

1.1.1 A ka përmbushur AKEP të gjitha objektivat strategjikë me qëllim ruajtjen e konkurrencës?

1.1.2 A ka bashkëpunuar AKEP me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare?

1.2.1 A ka marrë AKEP masat e nevojshme ndaj subjekteve që kanë cënuar interesat e konsumatorëve?

1.2.2 A janë shërbimet e ofruara nga kompanitë e telefonisë celulare në përputhje me pritshmëritë e konsumatorëve?

## **2.5 Skema e auditimit**

### **2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit**

Të dhënat e marra nga grupi i auditimit janë si të natyrës sasiore, ashtu edhe cilësore. Për rrjedhojë, në këtë auditim u përdor *qasja pragmatike* për të bërë një analizë të duhur dhe korrekte të evidencave, duke çuar në gjetje kokëforta dhe konkluzione e rekomandime të bazuara në to.

Gjithashtu, grupi i auditimit gjykoi të arsyeshme përdorimin e qasjes së orientuar si *kah procesi*, ashtu dhe *kah rezultati* për të matur efektivitetin e institucionit. Kështu, u vlerësua kryesisht performanca e AKEP në ushtrimin e kompetencave të tij Institucionale dhe në bashkëveprimin me aktorët e tjerë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara kah qytetarëve.

### **2.5.2 Metodot/teknikat audituese**

Metodat dhe teknikat audituese që u përdorën janë si vijon:

- hartë konjitive e çështjes nën auditim;
- mbledhje, shqyrtim dhe analizim cilësor e sasior i evidencave shkresore gjatë fazës studimore të auditimit;
- analizë risku (SËOT) dhe analizë PESTLE e faktorëve që ndikojnë në mjedisin e jashtëm në të cilin gjendet subjekti;
- intervista të strukturuar dhe gjysëm të strukturuar me titullarëte institucioneve dhe drejtorë departamentesh;
- pyetësorë me pyetje të mbyllura;
- kryqëzim i të dhënave për të gjeneruar evidenca të mjaftueshme, të besueshme dhe relevante;
- ekspertizë e jashtme; konsultime me ekspertë të sektorit të sigurimeve shoqërore;
- *benchmarking* me standardet dhe praktikat më të mira.

## **2.6 Rezultatet e parashikuara**

Auditimi me temë “Mbikëqyrja e Telefonisë Celulare” kishte si qëllim kryesor dhënien e një vlerësimi realist mbi performancën e AKEP dhe impaktin në instancat shtetërore përgjegjëse për të rritur efektivitetin në mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare, veprimtarinë institucionale dhe për të përmirësuar shërbimet e ofruara ndaj qytetarëve.

### **2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë**

Kuvendi dhe Qeveria, si palë kryesore të cilave u adresohet raporti i auditimit, do të shqyrtojnë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi për të nxitur përmirësimin e performancës së AKEP, me fokus rritjen e cilësisë mbikëqyrjes së tregut të telekomunikacionit dhe garantimit të shërbimeve cilësore të ofruara ndaj konsumatorëve. Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin do të ketë synim, rritjen e ndikimit të tij në përmirësimin e vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat mundësojnë realizimin e misionit të AKEP, duke mundësuar rritjen e efektivitetit të këtyre shërbimeve.

### **2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit**

Në lidhje me palët e tjera që preken nga ky auditim, publikun dhe ato të interesit, ndërgjegjësimi për mënyrën se si po vepron autoriteti përgjegjës me administrimin e financave të tyre, luan një rol jetik në mbrojtjen e interesave të qytetarëve. KLSH duhet t'i ketë partnerë të besueshëm median, shoqërinë civile, akademinë, gazetarët dhe ekspertët e fushës për të kontribuar në transparencën ndaj publikut dhe adresimin e problematikave të tregut të sigurimeve shoqërore. Ndryshimi fillon nga çdo qytetar, profesionist dhe konsumator.

### **2.6.3 Forma e publikimit**

Në përfundim të auditimit u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili ju dërgua subjektit të përfshirë në këtë auditim, i cili është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vijim të marrjes së opinioneve e komenteve zyrtare dhe vlerësimit të tyre, do të përgatitet Raporti Final i Auditimit. Ky raport, mbi të cilin Kryetari do të marrë Vendim, do t'i përcillet përsëri subjektit nën auditim dhe do të publikohet në faqen Web të KLSH-së, në faqen Facebook dhe LinkedIn të Departamentit të Performancës në KLSH, shtypin e përditshëm apo dhe *workshop*-e të ndryshme dhe analiza vjetore të institucionit.



### **3.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE**

#### **3.1 A ka qenë efektive veprimtaria e AKEP në mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare gjatë periudhës 2017-2018?**

Pas ngritjes së pyetjes kryesore të auditimit “A ka qenë efektive veprimtaria e AKEP në mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare gjatë periudhës 2017-2018? dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi i auditimit, ndonëse në kushtet e mungesës së bashkëpunimit dhe transparencës nga ana e AKEP, arriti në këtë përfundim:

**“Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për periudhën nën auditim 2017-2018 nuk ka përmbushur me efektivitet mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare kah ruajtjes së konkurrencës së lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare.**

**Pavarësisht rëndësisë, bashkëpunimi ndërinstucional ndërmjet AKEP dhe AK, nuk ka qenë frytdhënës. Gjithashtu, edhe nga bashkëpunimi ndërmjet AKEP dhe MIE nuk janë arritur rezultatet e pritshme, pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim implementimin dhe realizimin e ofrimit të shërbimit universal. AKEP dhe Qeveria në tërësi nuk kanë kryer një analizë paraprake lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë. Përfitimet ekonomiko-sociale duhet të ecin krahas krahas me ato të Sigurisë Kombëtare. Implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri mbart me vete një risk të lartë të thyerjes së sigurisë së informacionit dhe kërkon domosdoshmërisht të kryhet duke u bazuar në një plan-veprimi kombëtar, të detajuar qartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim mbrojtjen e padiskutueshme nga aksesimi i paautorizuar, tjetërsimi, keqpërdorimi apo mos-disponueshmëria, e një asemi të çmuar për konsumatorin shqiptar, siç është informacioni. Për më tepër, si një vend anëtar i NATO-s dhe me aspirata për integrim në BE, Qeveria shqiptare duhet të tregohet tejet e përgjegjshme në vlerësimin e risqeve që bart për Shqipërinë dhe partnerët strategjikë implementimi i teknologjisë 5G me burim kompanitë kineze.**

**Përsa i përket mbrojtjes së konsumatorëve, AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t’iu mundësuar përdoruesve me aftësi të kufizuara dhe me të ardhura shumë të ulëta çmime të përballueshme siç përcakton Ligji nr. 9918/2008 i AKEP dhe Direktiva 2018/1972 e BE-së, nuk ka kryer asnjë inspektim pranë kompanive të telefonisë celulare për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të tyre ndaj pajtimtarëve, si dhe nuk ka përmbushur objektivat e vendosura për mbrojtjen dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve.**

**Në lidhje me rregullimin e tarifave, AKEP nuk përdor metoda të orientuara në kosto, duke ndikuar kështu që Shqipëria të ketë tarifatat e terminimit të thirrjeve celulare MTR më të larta sesa mesatarja e vendeve të rajonit, BE-së dhe BEREC, të cilat ndikojnë në mënyrë indirekte në çmimet që paguajnë konsumatorët.**

## NËNPYETJA 1

### 3.1.1 A ka nxitur dhe siguruar AKEP konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare?

#### 3.1.1.1 A ka përmbushur AKEP të gjitha objektivat strategjik me qëllim ruajtjen e konkurrencës?

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (Ish-Enti Rregullator i Telekomunikacioneve) ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 1998. Ky institucion është organi rregullator përgjegjës në fushën e komunikimeve elektronike, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Në bazë dhe për zbatim të rendit ligjor të përcaktuar për komunikimet elektronike, AKEP ndërmerr të gjitha masat e nevojshme me qëllim implementimin e përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për rregullimin e këtij tregu.

AKEP është person juridik, publik, jobuxhetor, i cili drejtohet nga Këshilli Drejtues që është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë.<sup>35</sup> Në përfundim të çdo viti ai paraqet në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë institucionale për vitin pararendës.

Qëllimi i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.<sup>36</sup>

AKEP, si autoriteti rregullator për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë, është i angazhuar në promovimin e konkurrencës dhe investimeve në infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, me qëllim maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve të të gjitha kategorive nga këto shërbime.<sup>37</sup>

Konkretisht, ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar, parashikon në nenin 7 objektivat rregullatorë, ku në pikën (3) përcaktohet se AKEP-i nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera. Për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike, për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i sipas nenit 8 ka kompetencë<sup>38</sup>:

- a) mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji;
- b) rregullon aksesin dhe interkoneksionin midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme;
- c) miraton ofertën e referencës për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertën e referencës për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të

---

<sup>35</sup> Rregullore e brendshme për funksionimin e Keshillit Drejtues. Miratuar me Vendim nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

<sup>36</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar.

<sup>37</sup> <https://akep.al/2019/02/02/misioni/>

<sup>38</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar.

- ndjeshme në treg, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me aktet nënligjore, si dhe tarifa të orientuara në kosto;
- d) përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg;
  - e) ndërmerri dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurruese;
  - f) kryen regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit;
  - g) ndërmerri dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurruese. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.
  - h) merr masat administrative, në përputhje me këtë ligj, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
  - i) mbikëqyr respektimin e kërkesave të ligjit për tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji;
  - j) krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit;
  - k) mbledh të dhëna dhe informacion nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  - l) nxjerr rregulloret në zbatim të këtij ligji, të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar;

Në kuadër të objektivave rregullatore dhe kompetencave institucionale të parashikuara në ligj, AKEP duhet të planifikojë programin e tij të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore strategjike.

Nga sa më lart, për herë të parë, në vitin 2018 AKEP hartoi "Strategjinë dhe Planin e Veprimet Institucional", duke prioritarizuar veprimtarinë e tij dhe ushtrimin e kompetencave. Qëllimi i këtij dokumenti ishte që AKEP të përcaktojë fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018 si dhe veprimet që do ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2018 për të përmbushur objektivat rregullatore të përcaktuara në legjislacionin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë.

AKEP ka evidentuar katër fusha kyçe ku duhej të fokusonte punën e tij gjatë vitit 2018 përse i përket mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të telefonisë celulare<sup>39</sup>:

### *1. Kushte të favorshme për Investitorët;*

---

<sup>39</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

2. *Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve;*
3. *Përfitimet për konsumatorët;*
4. *Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe partneriteti me institucionet në vend.*

Për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që duhej të ndërmerreshin gjatë vitit 2018 për të bërë progres në secilën prej fushave kryesore.

Në bazë dhe për zbatim të këtij akti institucional, duke u bazuar në fushën e 2-të “*Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve*”, AKEP përcaktoi prioritetet dhe planet e veprimit me qëllim garantimin dhe vënien në zbatim të këtij objekti.

Konkretisht, për vitin 2018 Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me qëllim nxitjen e konkurrencës së ndershme në treg, parashikoi:

*- Përshpejtimin e procesit për përmbylljen e raundit të radhës për Analizat e Tregut, dhe vendosjen e masave proporcionale ndaj sipërmarrësve me FNT.<sup>40</sup>*

AKEP analizon tregjet e komunikimeve elektronike në mënyrë periodike sipas procedurës së analizës së tregut e cila konsiston në identifikimin e tregjeve përkatës dhe vlerësimin nëse në tregun përktës të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante ka ose jo sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT). Bazuar në ligjin për Komunikimet Elektronike në RSH: “*Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.*”<sup>41</sup>

Detyrimet tregtare rregullatore (siç është kontrolli i çmimeve), aplikohen vetëm për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) dhe këto detyrime do të hiqen vetëm nëse konkurrenca është e mjaftueshme për të mbrojtur konsumatorin. Instrumenti kryesor për të vlerësuar efikasitetin e konkurrencës është analiza e tregut. Rregullimi i tarifave për operatorët me FNT synon që të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut dhe dominanca për konkurrencën në treg, të cilat mund të jenë aplikimi i tarifave shumë të larta ose i tarifave shumë të ulëta në dëm të konkurrencës dhe përdoruesve fundorë.

Vendosja/rishikimi/heqja e detyrimeve të FNT janë pjesë e dokumentit të analizës së tregut dhe sanksionohen me vendime të Këshillit Drejtues të AKEP në vendimet përkatëse për statusin me FNT dhe masat rregulluese.

Procedura kryhet në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Rregulloren e Analizës së tregut si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet dhe Udhëzimet e Komisionit Europian dhe BEREC për analizën e tregjeve dhe masat rregulluese.

Në strategjinë institucionale të vitit 2018, AKEP ka përcaktuar se gjatë pranverës së vitit 2018 duhet të përfundonte analizën e tregut të terminimit të thirrjeve celulare, duke reflektuar ndryshimet e fundit në strukturën e tregut pas daljes së operatorit të katërt të rrjetit të telefonisë së lëvizshme.

<sup>40</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

<sup>41</sup> Neni 31 pika 4, Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar.

Në përputhje me përcaktimet ligjore dhe Rregulloren “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2018 vëmendja u fokusua në përfundimin e procesit të analizës së tregut të shërbimeve celulare:

- a) në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare,
- b) dhe në kryerjen e procesit për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”.

AKEP me vendimin nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin nr. 79, datë 1.10.2018, ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në:

- (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit,
- (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe
- (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore.

Me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 01.10.2018, përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom Sh.a dhe sipërmarrësin Telekom Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në:

- (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, si dhe masat përkatëse rregullatore.

AKEP me vendim nr. 89, datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr. 79, nr. 80, nr. 81 dhe nr. 82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP.

Bazuar në vendimin nr. 89, datë 15.11.2018, AKEP argumenton se si bazë ligjore për ndërmarrjen e një veprimi të tillë shërben neni 113, pika 1: “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”, i Kodit të Procedurave Administrative (Ligji 44/2015), i cili parashikon shprehimisht se: “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj”.

Nga sa më lart, çdo akt nënligjor i hartuar dhe nxjerrë në bazë dhe për zbatim të aktit i cili ka humbur fuqinë juridike, bie dhe është i pazbatueshëm gjithashtu.

Shfuqizimi i Vendimit të AKEP nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar” ka sjellë si pasojë edhe shfuqizimin e masave të ndërmarra për sipërmarrjet me FNT, në kuadër të analizës së kryer për tregjet përkatëse. Bazuar në këte fakt, AKEP nuk ka ushtruar me efektivitet rolin e tij si mbikëqyrës dhe nxitës i konkurrencës së lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare.

Në teorinë e së drejtës ekziston një rregull i përgjithshëm, sipas të cilit i njëjti autoritet që përpilon dhe vë në zbatim për herë të parë aktin, mund edhe ta anulojë atë. Kjo njihet ndryshe si e drejta e organit administrative për të rishqyrtuar aktin e tij nëpërmjet ndryshimit ose shfuqizimit. Revokimi i akteve administrative nga vetë autoriteti publik është një e drejtë e tyre, por jo e pakufizuar.

Revokimi nuk mund të zbatohet nga çdo organ administrativ për çdo akt dhe në çfarëdolloj rrethane. Në rradhë të parë duhet që ligji t'i njoh të drejtën organit për revokimin e aktit të tij.

Revokimi realizohet kur baza ligjore ose faktike për një akt administrative kanë ndryshuar në atë shkallë, sa që në kushtet e reja ai nuk mund të ketë vlerë.

Ndryshimi i shpeshtë dhe i paargumentuar i akteve të nxjerra do të cënonte sigurinë juridike dhe do të lejonte që individët të ndiheshin të kërcënuar nga rregullimet që mund t'i bëjë marrëdhënieve juridike autoriteti administrativ.

*Njëkohësisht, në vendimin nr. 89, datë 15.11.2018, AKEP citon si bazë ligjore për ndërmarrjen e një veprimi të tillë edhe Neni 37 të Ligjit për Komunikimet Elektronike. Kjo dispozitë në pikën 1 të saj, përcakton se: "Kur AKEP-i gjykon se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse."*

Neni 37 nuk i njeh AKEP në mënyrë eksplicite tagrin e shfuqizimit të vendimeve të nxjerra. Rishikimi nuk nënkupton shfuqizimin e aktit, por mund të nënkuptojë edhe ndryshimin/amendimin e tij.

Rregullorja për Analizat e Tregut, përpara paraqitjes për shqyrtim përfundimtar dhe miratim pranë Këshillit Drejtues, ka kaluar të gjitha procedurat e këshillimit publik në periudhën kohore 26.02.2018 – 28.04.2018.

Këshillimi publik është një marrëdhënie dypalëshe në të cilën qytetarët dhe kompanitë paraqesin vlerësimet e tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga rregullatori.

Ligji për Komunikimet Elektronike thekson se AKEP-i do të publikojë dokumentet e propozuara rregullatore dhe do të kërkojë duke lejuar jo më pak se 30 ditë për palët me interes që t'i paraqesin komentet me shkrim.

Ligji për Komunikimet Elektronike dhe Postare kërkon nga AKEP-i të sigurojë dhe të marrë parasysh mendimet e palëve të interesuara, para marrjes së vendimeve të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në treg. Pas përfundimit të procedurës së këshillimit publik (datë 28.04.2018), AKEP e ka miratuar dokumentin "Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar" pas 6 muajsh (datë 01.10.2018) nga përfundimi i kësaj procedure. Lidhur me këtë klauzolë, AKEP ka pasur kohë mjaftueshëm për të reflektuar lidhur me komentet dhe qendrimit e operatorëve, përpara se t'i jepte aktit formën e tij përfundimtare dhe fuqi juridike.

Në vendimin për shfuqizim të Analizës së Tregut Celular, AKEP gjithashtu nuk ka argumentuar dhe parashtruar se cilat kanë qënë arsyet që e kanë çuar atë në revokimin e një akti të miratuar më herët, i cili kishte kaluar në të gjitha hallkat paraprake dhe procedurale të tij. Revokimi i një akti duhet të shoqërohet gjithmonë me argumentat ligjorë përkatës, me qëllim respektimin e parimit të sigurisë juridike, paanshmërisë dhe objektivitetit të veprimtarisë vendimmarrëse institucionale.

Në përgjigjet për konfirmimin e të dhënave zyrtare AKEP shprehet se: tregu i pakicës nuk rregullohet nga AKEP, pasi nuk është në listën e tregjeve për rregullim dhe as në rregulloren e miratuar nga AKEP "Për analizën e tregjeve". Neni 56 i Lgjit nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për komunikimet elektronike në republikën e shqipërisë", i cili nga hierarkia jo vetëm prevalon mbi rregulloren e nxjerrë nga AKEP, por çdo akt nën

ligjor duhet të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, e përcakton qartë detyrimin që AKEP ka për kryerjen e analizave të tregut me shumicë dhe tregut të pakicës.<sup>42</sup>

AKEP kryen analizën *ex-ante* në rastin kur plotësohen në mënyrë kumulative tre kritere:

- Prezenca e barrierave të larta dhe jo kalimtare të hyrjes;
- Një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtim të një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës; dhe
- Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim.

Nga sa më sipër, edhe Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet Vendimit nr. 635, datë 04.07.2019, i ka rekomanduar AKEP të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu.<sup>43</sup>

*- Identifikimi në kohë të sjelljeve strategjike anti konkurrese të operatorëve me FNT me vëmendje të veçantë ndaj çmimeve anomalisht të ulëta, si element i kësaj sjelljeje.*<sup>44</sup> AKEP kishte parashikuar për 2018 në strategjinë institucionale të tij, se do të punonte për identifikimin e qartë dhe në kohë të sjelljeve strategjike të operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe veçanërisht për çmimet pajustificueshmërisht të ulëta nën-kosto, për t'u trajtuar si pjesë e analizës së tregut të vitit 2018 apo masave të tjera.

Ndërmarrjet që gëzojnë pozitë dominuese në treg, kanë "përgjegjësi të veçanta" për shkak të kësaj pozite. Ato nuk mund të kryejnë një sërë veprimesh, të cilat në kushtet e konkurrencës normale do të ishin të lejueshme. Gjykata Europiane e Drejtësisë shprehet në vendimin nr. 85/ 76 të datës 13.02.1979, gjatë shqyrtimit të çështjes Hoffmann-La Roche & Co. AG v Commission se: *"koncepti i abuzimit me pozitën dominuese është një koncept objektiv që lidhet me sjelljen e ndërmarrjes në pozitë dominuese, e cila është e tillë*

---

<sup>42</sup> Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, është arritur në përfundimin se për tregun përkatës të aksesit dhe interkoneksionit (tregu i shumicës) nuk ka konkurrencë efektive, që nënkupton se në treg, nga sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg, janë zbatuar tarifa të larta të paarsyeshme, ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë dhe nëse masat e parashikuara në nenin 39 deri 43 të këtij ligji nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë detyrimin për rregullimin e tarifave në këtë treg përkatës, sipas nenit 57 të këtij ligji duke nxjerrë vendimin për rregullimin e tarifave.

Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, për tregun përkatës për përdoruesit fundorë (tregu i pakicës) është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe nëse masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike:

a) detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi:

i) të mos zbatojë tarifa tepër të larta;

ii) të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj;

iii) të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme;

iv) të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë;

v) të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh;

b) detyrimin për nxjerrjen e vendimit përkatës për rregullimin e tarifave, sipas nenit 57 të këtij ligji.

<sup>43</sup> Autoriteti i Konkurrencës Vendimit nr. 635, datë 04.07.2019

<sup>44</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

*sa influencon në strukturën e tregut dhe si rezultat dobëson shkallën e konkurrencës nga përdorimi i metodave të ndryshme nga ato që përdoren në rastin e një konkurrence normale, duke pasur efekt pengimin e shkalles së konkurrencës që ekziston në treg ose pengon rritjen e mëtejshme të saj.”<sup>45</sup>*

Me sjellje abuzive apo anti konkurruese, do të kuptojmë ato sjellje të cilat kanë si qëllim zvogëlimin ose pengimin e konkurrencës duke përjashtuar nga tregu konkurentë aktualë ose potencial. Përcaktimi i çmimeve anormalisht të ulëta konsiderohet si një nga mënyrat e abuzimit me pozitën dominuese dhe konkretisht si “situatë grabitqare”. Këto situata lidhen me kryerjen e një sjelljeje grabitqare, dhe me paramendim shkaktimin e humbjes dhe jo fitime si më parë, në një periudhë afat shkurtër, me qëllim përjashtimin e një ose disa konkurrentëve potencialë me synimin për të forcuar ose për të mbajtur fuqinë e tregut duke i shkaktuar dëm konsumatorit.

Edhe në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet AKEP dhe AK, në Nenin 2 pika 4, është përcaktuar një klauzolë, ku palët kanë sanksionuar se: “Kur AKEP-i me nismën e vet, ose nëpërmjet njoftimit nga sipërmarrës të tjerë apo palë të tjera të interesura, gjykon se operatori me fuqi të ndjeshme në treg po abuzon me pozitën e tij, e parashtron rastin para Autoritetit të Konkurrencës, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.

Për sa më sipër, *de facto* nuk njihet asnjë rast praktik në të cilin AKEP ka konstatuar një rast të abuzimit me pozitën dominuese të operatorëve në treg dhe t’ia ketë parashtruar Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim fillimin e procedurave përkatëse ligjore.

*- Analizë e situatës me kompensimet ndërmjet operatorëve dhe rishikim i masave rregullatore në këtë drejtim.*<sup>46</sup>

Gjatë vitit 2018 AKEP do të kryente një analizë të situatës së marrdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencë në tregjet përkatës me pakicë si dhe adresim të tyre në proceset e analizave të tregut për vitin 2018 ose në procese të veçanta.

Nga sa më sipër, pavarësisht faktit se një objektiv i tillë është përcaktuar në strategjinë institucionale të vetë AKEP, në përgjigjet e gjeneruara për konfirmimin e të dhënave zyrtare AKEP shprehet se nuk zhvillon analiza të tilla të ngushta. Rrjedhimisht, bazuar në qendrimin institucional dhe zyrtar të vetë AKEP, dalim në konkluzionin se në analizë e tillë nuk është kryer dhe ky objektiv strategjik mbetet i parealizuar.

*- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët në AKEP për analizat e tregut dhe proceset e vendimmarrjes. Nisja e mbledhjes së të dhënave nga burime alternative (duke përfshirë edhe nga ana e kërkesës) dhe krahasimin me praktikën më të mira të industrisë.*<sup>47</sup>

Kjo nënkupton kryerjen e një analize më të hollësishme të tregut gjeografik, bazuar në atlasin e infrastrukturës të zhvilluar nga AKEP. Gjatë përpilimit të kësaj analize, si metodologji për kryerjen e saj mund të konsiderohen dhe metoda të tjera, të tilla si anketat me përdoruesit fundorë.

---

<sup>45</sup> Case 85/ 76 Judgement of the Court of 13.02.1979, Hoffmann-La Roche & Co. AG v Commission.

<sup>46</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.

<sup>47</sup> Strategjia Institucionale e AKEP 2018.



Gjatë viti 2018, AKEP kishte parashikuar se do të verifikonte dhe saktësonte të dhënat e depozituara nga operatorët, duke përdorur burime të ndryshme verifikimi dhe do të rriste detajimin e publikimit të të dhënave. Njëkohësisht AKEP do të rriste edhe bashkëpunimin me INSTAT bazuar në MOU të nënshkruar në Dhjetor 2017, si dhe do të përdorte sondazhe për të grumbulluar të dhënat për tregun në anën e kërkesës (*demand side data/surveys*).

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018, ka vlerësuar punën e bërë për përmirësim të plotë (*full upgrade*) të sistemit ATLAS, popullimin e sistemit me informacion mbi infrastrukturën pasive të operatorëve të telekomunikacioneve, si dhe dy ndërfaqet për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike për publikun e gjerë.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, gjatë vitit 2018 të gjithë treguesit e marrë në analizë kanë shënuar vlera më të madha të HHI, e thënë ndryshe rritje e përqendrimit të tregut të komunikimeve elektronike celulare. Dalja nga tregu e operatorit Plus Communication e ndryshoi strukturën e tregut që nga data 1 janar 2018 nga 4 (katër) në 3 (tre) operatorë duke vijuar trendin rritës të indeksit të përqendrimit të tregut dhe për më tepër dy sipërmarrësit me pjesën më të madhe në treg kanë rritur ndjeshëm kapacitetet konkurruese nëpërmjet marrjes 50 me 50 % të të drejtave të përdorimit të frekuencave që zotëronte në përdorim Plus Communication, duke thelluar avantazhin krahasues të hyrësve të parë në treg. Ky fakt tregon gjithashtu edhe për ulje të konkurrueshmërisë midis sipërmarrësve në këtë treg.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017, për vitin 2018 ka rekomanduar që AKEP duhet të bëjë një analizë të plotë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori, nëse këto shkaqe lidhen me problematikën e vendim-marrjeve të rregullatorit apo dështimit në menaxhim të operatorit të fundit në treg dhe të reflektojë konkluzionet e kësaj analize.

Të njëjtin rekomandim, Kuvendi i Shqipërisë e ka lënë edhe për vitin 2019 në vlerësimin institucional të AKEP për vitin 2018.

Nga sa më sipër, grupi auditimit kostaton se gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale për vitin 2018, AKEP nuk e ka përmbushur rekomandimin e lënë nga Kuvendi për kryerjen e një analize të tillë.

Për të vlerësuar nëse një ndërmarrje ka pozitive dominuese duhet që:

- Të përcaktohet tregu përkatës i produkteve dhe tregu përkatës gjeografik në të cilin do të vlerësohet fuqia ekonomike e ndërmarrjeve në fjalë;
- Të përcaktohet pjesa e tregut që zotëron ndërmarrja në fjalë;
- Të analizohen kufizimet e konkurrencës.

Një nga elementët që merret në konsideratë kur përcaktohet tregu gjeografik është edhe ekzistenca e pengesave të hyrjes në treg.

Përveç barrierave financiare, teknike dhe juridiko-proceduriale për hyrjen në treg, dalja nga tregu e hyrësit të fundit në treg, Plus Communication, është barrierë e konsiderueshme për çdo hyrës të ri në treg.

Ofrimi i shërbimeve të telefonisë celulare si operator rrjeti ndeshet me pengesa të larta dhe të qëndrueshme të cilat lidhen me shkallën e lartë të investimeve të kërkuara për të ndërtuar një rrjet celular dhe numrin e kufizuar të operatorëve të rrjeteve celulare.

Ndërmarrjet Vodafone AL dhe Telekom AL kanë krijuar avantazhe në tregun e telefonisë celulare, nëpërmjet krijimit të rrjeteve të veta, klientëve përkatës (abonentët), eksperiencës në menaxhimin e tregut, emër nëpërmjet marketingut, si dhe fuqi të konsiderueshme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte, operatorëve të rinj, do t'u duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme, për t'u bërë pjesë efektive e këtij tregu.

Tregu i ofrimit të shërbimeve celulare është një treg i cili kërkon investime fillestare mjaft të larta, si edhe nevojën për përmirësim dhe përvetësim të vazhdueshëm të teknologjive të reja të cilat janë mjaft dinamike në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit. Duke qenë një treg mjaft dinamik, fuqia ekonomike dhe përvoja në këtë treg u jep avantazh operatorëve me pjesën më të madhe të tregut, në krahasim me konkurrentët e tjerë.

Ekonomitë e shkallës mund t'i japin ndërmarrjes/ve me Fuqi të Ndjeshme në tregun përkatës avantazh mbi konkurrentët.

Tregues i fuqisë ekonomike ishte edhe tenderi i zhvilluar me datë 7 Shkurt 2019, për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)", ref.1x10 mhz i çiftuar -800-2018", ku vetëm sipërmarrësi Vodafone Albania paraqiti ofertë për një nga brezat për të cilën u shpall fitues.

Hapësirat e kufizuara ekonomike (në krahasim me operatorët e mëdhenj) për të kryer investime në teknologjitë e avancuara i vendos në disavantazh operatorët më të vegjël në treg, pasi operatorët më të vegjël, për të qenë konkurrues duhet të përdorin çmime më të favorshme në krahasim me operatorët e mëdhenj, por, tërheqja e pajtimtarëve kryesisht klientët ekzistues të operatorëve të tjerë, pa iu ofruar shërbime të cilat përdorin teknologjitë e fundit paraqet një pengesë për rritjen e tyre në treg.

Gjatë kryerjes së Analizës së Tregut, AKEP konkludon se tregu i telefonisë celulare nuk është në konkurrencë efektive. Është shumë e vështirë të mendohet, që në tregun me pakicë celulare, në kushtet e mos-ndërhijes rregullatore, të mund të ndodhin hyrje të reja. Plus Communication ishte hyrja e fundit në treg dhe tashmë pas transferimit të frekuencave të dy sipërmarrësit Vodafone dhe Telekom Albania, hyrësi i fundit ka dalë nga tregu dhe struktura e tregut ka ndryshuar drejt rritjes së përqendrimit dhe dominimit të liderit të tregut/dy sipërmarrësve me pjesë më të madhe tregu.

AKEP si institucion rregullator dhe institucioni teknik kompetent për nxitjen e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare, duke bashkëpunuar me MIE-në dhe institucione të tjera përgjegjëse duhet të sigurojë ndërhijes rregullatore të nevojshme, me qëllim lehtësimin e barrierave hyrëse në treg dhe rritjen e konkurrencës.

Bazuar në rekomandimet e CEPT-ECC/DEC/(11)04, brezi 800 mhz është organizuar me tre pjesë, pra tre të drejta përdorimi (autorizime individuale). Një e drejtë përdorimi në këtë brez (790-826 mhz) është e paalokuar.

Nga sa më sipër, nga pikëpamja e frekuencave, ka akoma mundësi për operator të ri në treg në momentin e tenderimit të Bllokut A1 të brezit 800 mhz, megjithatë, deri më tani AKEP ende nuk ka rihapur një tender për të drejtë përdorimi për këtë spektër frekuencash, me qëllim nxitjen e operatorëve të rinj.

**Tabela 5:** Alokimi i brezit të frekuencave 800 hhz

<b>Autorizimi Individual</b>	<b>Frekuanca për Autorizim Individual</b>	<b>Madhësia e Bllokut</b>	<b>Statusi/Gjendja</b>
Blloku A1	791-801 mhz (10mhz)	1x 10 mhx	i paalokuar

	i cciftuar me 832-842 mhz (10mhz)	i cciftuar	
Bloku A2	701-811 mhz (10mhz) i cciftuar me 842-852 mhz (10mhz)	1x 10 mhx i cciftuar	Vodafone Albania 04.03.2019-04.03.2034
Bloku A1	811-821 mhz (10mhz) i cciftuar me 852-862 mhz (10mhz)	1x 10 mhx i cciftuar	Telecom Albania 27.09.2019-27.09.2034

Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga Grupi i Auditimit

### GJETJE:

- Tregu i telefonisë celulare ka përqëndrim të lartë, duke reflektuar një strukturë oligopoli dhe kjo për shkak të rritjes gjithnjë e më shumë në treg të sipërmarrësit me pjesën më të madhe të tregut.
- Deri në vitin 2018, AKEP nuk ka pasur një strategji institucionale dhe plane veprimi, me qëllim nxitjen e konkurrencës në tregjet që mbikëqyr dhe rregullon, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve.
- Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 89 datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues “Analizë e Tregut Celular” dhe për këtë vendim nuk ka argumentuar dhe parashtruar se cilat kanë qënë arsyet që e kanë çuar atë në revokimin e një akti të miratuar një muaj më herët, i cili kishte kaluar në të gjitha hallkat paraprake dhe procedurale të tij.
- Nuk njihet asnjë rast praktik në të cilin AKEP ka konstatuar një sjellje strategjike anti konkurruese të operatorëve me FNT dhe t’ia ketë parashtruar Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim fillimin e procedurave përkatëse ligjore.
- AKEP nuk ka kryer një analizë të situatës së marrdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencë në tregjet përkatëse me pakicë, si dhe adresim të tyre në proceset e analizave të tregut për vitin 2018 ose në procese të veçanta.
- AKEP nuk ka kryer një analizë të plotë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori, sikurse parashikohet në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP.

### KONKLUZIONE:

- ✓ Përqëndrimi shumë i lartë i tregut të telefonisë celulare ka ndikuar në mungesën e konkurrencës efektive të këtij tregu.
- ✓ Mungesa e Strategjisë Institucionale dhe mungesa e hartimit të planeve të veprimit deri në vitin 2018, duke mos përcaktuar dhe evidentuar objektivat e institucionit me qëllim realizimin e tyre, tregon mungesë efektiviteti të AKEP.
- ✓ Shfuqizimi i vendimeve të ndërmarra nga Këshilli Drejtues i AKEP pa argumentuar dhe parashtruar se cilat kanë qënë arsyet që e kanë çuar atë në revokimin e një akti të miratuar një muaj më herët, i cili kishte kaluar në të gjitha hallkat paraprake dhe procedurale të tij, sjell mungesë efektiviteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale dhe ndikon në cënimin e parimit të sigurisë juridike.
- ✓ Mos kryerja e analizave përkatëse nga ana e AKEP, passjell pamjaftueshmërinë e masave *ex-ante* të ndërmarra prej tij, me qëllim rregullimin e tregut të telefonisë celulare.

## **REKOMANDIME:**

- AKEP duhet të kryejë me kujdes, në shkallë të lartë përgjegjshmërie dhe në intervale të rregullta, por jo më pak se një herë në dy vjet, analizën e tregjeve përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore.

*Në vijimësi*

- AKEP duhet të realizojë analizën e tregut të pakicës në tregun e telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore në këtë treg.

*Në vijimësi*

- Mbështetur në analizat e tregut, AKEP duhet të vendosë masa të mjaftueshme për ndërmarrjet me FNT, me qëllim që të sigurojë konkurrencë efektive në tregun e telefonisë celulare.

*Në vijimësi*

- Këshilli Drejtues i AKEP duhet që të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që kur ai e çmon të arsyeshme, komentet objektive të subjekteve të legjituara, të përfituara nga gjatë fazës së këshillimit publik, të reflektohen në Dokumentin përfundimtar të analizës së tregut, përpara miratimit të këtij akti.

*Në vijimësi*

- Në rastet kur Këshilli Drejtues i AKEP çmon shfuqizimin e një akti të mëparshëm, duhet që këtë vendim ta mbështesë në argumenta ligjorë dhe objektive, duke parashtruar që faktet e marra në konsideratë nuk pasqyrojnë situatën aktuale.

*Në vijimësi*

- Pavarësisht faktit se AKEP bën rregullimi *ex-ante* të tregut të telefonisë celulare, kur ai konstaton një sjelljeve strategjike anti konkurruese të operatorëve me FNT duhet t'ja parashtrorë Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim fillimin e procedurave përkatëse ligjore.

*Menjëherë*

- AKEP duhet të kryerjë një analizë të situatës së marrdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencë në tregjet përkatëse me pakicë si dhe adresim të tyre në proceset e analizave të tregut për vitin 2018 ose në procese të veçanta.

*Në vijimësi*

### **3.1.1.2 A ka bashkëpunuar AKEP me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare?**

#### **Marrëdhënia AKEP- MIE**

Kreu II i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" përcakton organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike dhe kompetencat e tyre. Në bazë dhe për zbatim të ligjit për komunikimet elektronike, MIE është institucioni më i lartë ekzekutiv i cili harton dhe ndjek zbatimin

e politikave në tregun e komunikimeve elektronike. Në nenin 5 të ligjit<sup>48</sup>, përcaktohen edhe kompetencat e MIE-së.

Konkretisht, me qëllim rregullimin e tregut elektronik, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka këto kompetenca<sup>49</sup>:

1. Harton dhe paraqet në Këshillin e Ministrave propozimet për politikën e sektorit të komunikimeve elektronike.
2. Ndjek zbatimin e politikës së Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në sektorin e komunikimeve elektronike.
3. Harton dhe paraqet në Këshillin e Ministrave projektaktet ligjore e nënligjore, për zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike.
4. Mund të nxjerrë urdhra dhe udhëzime me karakter normativ për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
5. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë në fushën e komunikimeve elektronike. Harton dhe nënshkruan, në emër të Republikës së Shqipërisë, marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike.
6. Ndjek zbatimin e detyrimeve për fushën e komunikimeve elektronike, që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare, ku aderon Republika e Shqipërisë.
7. Kërkon dhe përpunon të dhënat statistikore nga sipërmarrësit, që kryejnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike.
8. Bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimin Informativ të Shtetit për çështje të fushës së komunikimeve elektronike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare.
9. Harton Planin Kombëtar të Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të frekuencave.
10. Bazuar në propozimet e AKEP-it, miraton kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave, procedurat përkatëse të konkurrimit publik, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe vlerën minimale për dhënien e tyre.
11. Miraton ofruesin e shërbimit universal, edhe procedurat përkatëse për zgjedhjen e ofruesit/ofruesve të shërbimit universal, bazuar në propozimet e AKEP-it.

Me qëllim përmbushjen e misionit institucional, si edhe në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregut të telefonisë celulare AKEP duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nevoja e bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet këtyre dy institucioneve, shprehet qartësisht edhe në dispozitat e ligjit për komunikimet elektronike.

AKEP dhe MIE duhet të bashkëpunojnë për:

- hartimin e një Strategjie Kombëtare dhe objektivave makro, në fushën e telekomunikacionit;
- mbështetjen e veprimtarisë së Qeverisë;
- krijimin/amendimin e bazës ligjore dhe të akteve nënligjore në fushën e komunikimit elektronik;
- ofrimin e shërbimit universal siç përcaktohet në Ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar;

---

<sup>48</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në RSH", i ndryshuar.

<sup>49</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në RSH", i ndryshuar.

- zbatimin e rekomandimit të BE-së për lirimin e brezin 700MHz për rrjetet celulare deri në vitin 2020.

Objektivat makro për fushën e telekomunikacionit janë pjesë e dokumentave strategjike ndërsektoriale dhe sektoriale, si më poshtë:

- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit, e miratuar në vitin 2016;
- Strategjia Ndërsektoriale për Axhendën Digjitale, e miratuar me VKM nr. 284, datë 01.04.2015;
- Plani Kombëtar i Broadband, i miratuar me VKM nr. 468 datë 30.05.2013, i ndryshuar me VKM nr.300 date 08.04.2015;
- Plani Kombëtar i Frekuencave i miratuar me VKM nr. 277, datë 29.03.2017.

Plani Kombëtar i Frekuencave, i miratuar me VKM nr. 277, datë 29.03.2017, është akt i përpiluar ndërinstytucionalisht, nga të gjitha institucionet përgjegjëse për hartimin e këtij plani dhe administrimin e brezave përkatës të frekuencave.

Kur frekuencat do të përdoren për qëllime "CIVILE", në këtë rast institucionet përgjegjëse për administrimin e brezit përkatës do të jenë "AKEP", "AMA" ose "AKEP/AMA".

Në rastet kur AKEP/AMA janë administrues të të njëjtit brez të frekuencave, atëherë këto institucione duhet të koordinohen ndërmjet tyre për menaxhimin e brezit përkatës të frekuencave. Brezat e frekuencave me përdorim të përbashkët civile-qeveritare rregullohen me marrëveshje midis institucioneve që administrojnë brezin përkatës të frekuencave.

Brezi 800 MHz (790-862 MHz) ose ndryshe i quajtur DD1 (Digital Divident 1) me gjithë përcaktimin e vendosur në Planin Kombëtar të Frekuencave për përdorimin e tij nga operatorët celularë si dhe afatin e parashikuar (30.06.2017) për kalimin e administrimit të tij nga AMA tek AKEP edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi të ishte nën administrimin e AMA.<sup>50</sup>

Me qëllim lirimin e këtij brezi, kompensimi financiar i Televizioneve nga AMA ka qënë në vlerën 5 milionë euro.<sup>51</sup>

E njëjta problematikë evidentohet edhe për lirimin e brezit 700MHz, bazuar në kontratat afat-gjata që AMA ka lidhur me operatorët televizivë. Nga ana e AMA janë paraqitur vështirësitë për procesin dhe impakti negativ që lirimi i këtij brezi ka për tregun mediatik.

Duke marrë në konsideratë problematikën e konstatuar, grupi auditimit vlerëson se koordinimi ndërinstytucional ndërmjet AKEP dhe AMA nuk ka qënë efektiv, sikurse parashikohet në Planin Kombëtar të Frekuencave.

Për sa më sipër, AKEP i ka kërkuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të bëjë ndryshime në Planin Kombëtar të Frekuencave, me qëllim që data 30 qershor 2020, të vendoset si datë limit për lirimin e brezit 700 MHz.

Pas lirimit të brezit 700 MHz, AKEP, duke marrë në konsideratë Direktivën e BE-së, do të zhvillojë procedurat ligjore në fuqi për dhënien në përdorim të frekuencave të këtij brezi operatorëve celularë, duke startuar kështu edhe shërbimet 5G në Shqipëri.

Gjatë vitit 2019, është ndërmarrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë procesi i hartimit të strategjisë për 5G. Për këtë dokument, nga Ministria e Infrastrukturës dhe

<sup>50</sup> Plani Kombëtar i Frekuencave i miratuar me VKM nr. 277, datë 29.03.2017.

<sup>51</sup> Ligji nr. 34/2017, datë 30.03.2017, "Për Lirimin e Frekuencave të Digjital Dividentit", i ndryshuar.

Energjisë janë zhvilluar takime konsultuese me grupet e interesit si me institucionet e lidhura AKEP, AMA, AKSHI, AKCESK, operatorët e telekomunikacioneve, institucionet ndërkombëtare mbështetëse për sektorin. Drafti për strategjinë 5G është prezantuar në takimin e datës 24.10.2019 të zhvilluar me institucionet dhe operatorët celularë.

Ky dokument politikash për zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve për periudhën 2020-2025, është parashikuar të miratohet në fillim të vitit 2020.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me Vendimin nr. 34, datë 14.10.2019, të Këshillit Drejtues, ka pajisur me Autorizim Individual një prej operatorëve telefonikë që operojnë në vendin tonë, për përdorimin e frekuencave të brezit 3600-3700 MHz, sasi spektri 100 MHz i paçiftuar, për kërkim, matje dhe provë. Këto frekuenca bëjnë pjesë në brezin 3400-3600/3600-3800 MHz, që përdoren për ndërtim dhe operim të rrjeteve celulare të gjeneratës së pestë (5G).

Sipas AKEP, ky autorizim lëshohet për këtë operator për:

- Testim të teknologjisë 5G New Radio.
- Testim të konceptit Massive MIMO.
- Testim të Shpejtësive Maksimale me Carrier Aggregation LTE + 5G New Radio.
- Testim të latency (performancës së rrjetit në transferimin e të dhënave).

Synimi i operatorëve të telefonisë është i tillë që në vitin 2020, kjo teknologji të implementohet në vendin tonë.

Implementimi i kësaj teknologjie në vendin tonë mund të sjellë përfitime të mëdha në aspektin e fuqizimit ekonomik dhe ofrimit të faciliteteve për organizatat dhe bizneset. Ndërkohë po aq të mëdha sa mund të jenë përfitimet, mund të jenë edhe dëmet që mund të shkaktohen në rast të dështimit, që mund të vijë si pasojë e implementimit pa një studim të thelluar lidhur me mënyrën e implementimit, raportin përfitim/kosto dhe pa një strategji gjithëpërfshirëse me fokus kryesor mbrojtjen e konsumatorit shqiptar.

AKEP duhet që apriori të kryente një analizë lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë. Sjellim në vëmendje që implementimi i kësaj direktive është refuzuar edhe nga vende anëtare të BE-së si Gjermania apo Zvicra, të cilat kanë kërkuar më tepër kohë, me qëllim kryerjen e analizave mbi efektet e mundshme që do të sjellë implementimi i këtij rrejeti.

Në Shtator të vitit 2016, Komisioni European ka publikuar një plan veprimi lidhur me implementimin e teknologjisë 5G në vendet e Bashkimit European. Ky plan veprimi është i vlefshëm për të gjithë vendet anëtare të Bashkimit European. Në këtë plan veprimi është parashikuar që vendet e BE, deri në fund të vitit 2020, të kenë implementuar teknologjinë 5G, të paktën në një prej qyteteve kryesore të vendit. Ndërkohë në zbatim të rekomandimeve të Komisionit European, të adoptuara në Mars të vitit 2019 për të mundësuar një nivel të lartë të sigurisë kibernetike, BE ka hartuar edhe një raport të koordinuar për vlerësimin e riskut të sigurisë kibernetike në rrjetet e gjeneratës së 5-të (5G).

Në këtë raport janë vlerësuar aspektet kryesore dhe më të rëndësishëm që lidhen me sigurinë kibernetike, siç mund të përmenden:

- Llojet kryesore të kërcënimeve kibernetike,
- Aktorët kryesorë të kërcënimeve kibernetike,
- Asetet kryesore dhe kushtet e tyre,
- Dobësitë kryesore,
- Skenarët e mundshëm sipas risqeve.

Pavarësisht se ky raport është hartuar dhe është i vlefshëm për vendet anëtare të Bashkimit Europian, duke qenë se në ditët e sotme teknologjia e informacionit dhe komunikimit i ka thyer kufinj të fizikë ndërmjet vendeve dhe grupimeve të ndryshme, informacioni që ai paraqet është i vlefshëm dhe kuptimplotë edhe për vendin tonë.

Mund të themi madje, se ky raport merr vlerë edhe më të madhe në rastet e vendeve si Shqipëria, që nuk janë ende pjesë e BE, duke pasur parasysh se plani i veprimit për implementimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë, në të gjitha çështjet dhe veprimet që parashikon, e ka të përcaktuar qartë se do të kryhen në bashkëpunim me Komisionin Europian.

Nisur nga sa më sipër, risku që siguria e informacionit të çenohet në vendin tonë është tepër i lartë, ashtu sikurse është edhe dëmi që një skenar i tillë mund të shkaktojë për vendin tonë, si në aspektin ekonomik, në aspektin social, por edhe në dëmtimin e imazhit të vendit.

Çdo sistem teknologjik mbart me vete riskun e dobësive lidhur me pajisjet fizike të infrastrukturës teknologjike (hardware), software-t, proceset apo politikat që ndiqen. Risqet kibernetike që lidhen me rrjetet 5G, në thelb të konceptit të tyre janë të njëjta me ato të rrjeteve 3G apo 4G, ku mund të përmenden risku për thyerjen e konfidencialitetit, disponueshmërisë dhe integritetit (saktësisë apo vërtetësisë) së të dhënave.

Duke qenë se rrjetet e gjeneratës së 5-të operojnë në një infrastrukturë komplekse teknologjike, janë rrjedhimisht më të ekspozuara ndaj një risku më të lartë kibernetik, krahasuar me rrjetet 3G dhe 4G.

Ashtu siç edhe në raportin e BE theksohet, një ndryshim i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje është fakti se impakti potencial dhe intensiteti në rrjetet 5G do të jetë më i lartë, përpjesëtimisht i drejtë me funksionet ekonomiko-sociale të rrjeteve 5G.

Risqet kibernetike të implementimit të rrjeteve të gjeneratës së 5-të në Shqipëri paraqiten edhe më të lartë duke marrë parasysh mundësinë për mangësi apo dobësi siç parashtrihen edhe në raportin e publikuar nga BE, ndër të cilat mund të theksohen :

- Mangësi në burimet njerëzore që kanë detyrë sigurinë, monitorimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve 5G.
- Mangësi në kontrollet e brendshme, praktikën monitoruese dhe praktikën e menaxhimit të riskut.
- Mangësi në procedurat e sigurisë apo mirëmbajtjes siç mund të jenë përditësime të software-ve.
- Mos-përputhshmëri apo implementim i gabuar i standardeve.

Duke qenë një teknologji komplekse që do të bazohet në software, të gjithë risqet e sipërpërmendur marrin vlerë edhe më të madhe.

Spektri i gjerë që teknologjia e gjeneratës së 5-të mund të mbulojë, dedukton në përfundimin se impakti i thyerjeve të mundshme të sigurisë së informacionit në këto rrjete mund të jetë tepër i lartë, me kosto financiare, kohore dhe sociale për konsumatorin shqiptar.

Ashtu sikurse cilësohet dhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare "Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në Internet dhe informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Rritja e komunikimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por, në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë. Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në



institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike”.

***Përfitimet ekonomiko-sociale, nuk mund të prevalojnë kurrësesi mbi ato të Sigurisë Kombëtare.***

Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri mbart me vete një risk të lartë të thyerjes së sigurisë së informacionit dhe kërkon domosdoshmërisht të kryhet duke u bazuar në një plan-veprimi kombëtar, të detajuar qartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim mbrojtjen e padiskutueshme nga aksesimi i paautorizuar, tjetërsimi, keqpërdorimi apo mos-disponueshmëria, e një asemi të çmuar për konsumatorin shqiptar, siç është informacioni.

Nuk duhen nënvlerësuar asnjëherë risqet që pozon teknologjia kibernetike sa i përket sigurisë. Kjo siguri nuk ka të bëjë vetëm me firewall-et, fjalëkalimet dhe mbrojtjen e rrjetit, por ajo fillon me një legjislacion të shëndetshëm qeveritar, pasuar në vijim nga politikat e duhura, trajnimi i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës, vlerësimi dhe korrigjimi i sistemeve ekzistuese, vizioni i qartë dhe konteksti i parashikueshëm nga qeveria dhe lidhësi industrial, bashkëpunimi mes sektorëve dhe mbi të gjitha një personel i përkushtuar në rritjen e ndërgjegjësimit kibernetik dhe mbrojtjes nga çdokush.

Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe me aspirata perëndimore, duhet të ngriejë mekanizmat legjislativë për të mbrojtur sigurinë kombëtare. Hapat e ndërmarra nga ShBA për të modernizuar Komitetin e Investimeve të Huaja në vitin 2018 mund të shërbejnë si model për t'u ndjekur, qoftë në përmirësimin e Komiteteve ekzistuese, ashtu edhe në ngritjen e Komiteteve të reja me fokus apo me lidhje në sigurinë kombëtare. Kur bëhet fjalë për investime të huaja në sektorë strategjikë, ngritja e një mekanizmi qeveritar gjithëpërfshirës, me input nga të gjitha strukturat ekonomike, inteligjente, të mbrojtjes dhe sigurisë, është kritike në mbrojtjen e infrastrukturës, teknologjisë, të dhënave personale, transaksioneve financiare, etj.

Shqipëria, sikurse shumë vende të tjera, të zhvilluar dhe në zhvillim, ndodhet përpara një udhëkryqi: të implementojë teknologjinë 5G apo të implementojë sigurinë 5G. Drejtimi i parë është një shteg me bazë ekonomike, “asfaltuar” nga Kina dhe me risqe jo vetëm për Shqipërinë, por për krejt aleancat ku bëjmë pjesë dhe synojmë të shkojmë. Ligji mbi Sigurinë Kombëtare Kineze e shpreh qartë detyrimin e çdo kompanie celulare kineze për të raportuar tek strukturat e këtij shërbimi, sikurse edhe për të ndërmarrë veprime të tjera sekrete. Drejtimi i dytë është një rrugë me bazë vlerash, parimesh dhe objektivash afatgjata, shtruar nga SHBA dhe BE. Është një rrugë që duhet ta ndjekim pa asnjë kusht dhe kompromis, për mos të rënë në gabimet e së shkuarës dhe instaluar “diktatura digjitale” kombëtare apo edhe ndërkombëtare, për të ruajtur ndërveprimin me partnerët strategjikë dhe për të kontribuar drejt vlerave bazë të njeriut dhe demokracisë, sikurse dhe prosperitetit ekonomik.

Përsa i përket përmbushjes së objektivit ligjor për ofrimin e shërbimit universal, në intervistën për konfirmimin e të dhënave zyrtare, MIE shprehet se: *“Në vitin 2012, ministria përgjegjëse ka hartuar propozimin për ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të cilat kanë sjellë plotësim të rëndësishme në kapitullin për shërbimin universal, si parashikimi i masave mbrojtëse për konsumatorin (shmangia e “bill shock”), qartësim të shërbimeve universale, etj.*

*Ka pasur një asistencë teknike të Bankës Botërore për AKEP dhe ish ministrinë përgjegjëse për shërbimin universal. Në kuadër të procesit të planifikuar për transpozimin e direktivës së re të BE-së, do shihet në veçanti dhe përcaktimi i shërbimit universal, mënyrat e financimit të shërbimit universal.*

*Projekti i inicuar nga MIE për zhvillimin e broadbandit rajonal, synon të sigurojë aksesin në shërbime broadband, në veçanti në zonat rurale, të largëta dhe ato pa interes investimi nga sektori privat, gjë që është në funksion të realizimit të shërbimit universal.”*

Nga përgjigjet e gjeneruara nga MIE, konstatojmë se procedura për ofrimin e këtij shërbimi ende nuk është konkretizuar dhe hapat e ndërmarrë nga MIE dhe AKEP, me qëllim realizimin e këtij objekti, mbeten të zbehtë.

Pavarësisht se *de jure* ky shërbim gjendet i sanksionuar në ligjin për komunikimet elektronike qysh prej vitit 2008, vit në të cilin ka hyrë në fuqi ky ligj, *de facto* as AKEP dhe as MIE nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për implementimin dhe ofrimin e këtij shërbimi. Megjithëse MIE shprehet se ka pasur asistencë teknike të Bankës Botërore për ofrimin e këtij shërbimi, shfrytëzimi i këtij burimi nuk ka qenë eficient, pasi nuk është arritur asnjë produkt. VKM-ja që do të përcaktonte rregullat për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal nuk ka hyrë në fuqi.

Në intervistën për konfirmimin e të dhënave zyrtare, MIE ka pohuar gjithashtu se është i nevojshëm zhvillimi i takimeve periodike të përbashkëta me AKEP. Këto takime do të ishin dobiprurëse në kuadër të përmbushjes së objektivave ligjor të përcaktuar.

### **Marrëdhënia AKEP- AK**

Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 12 të ligjit për komunikimet elektronike<sup>52</sup>, AKEP duhet të bashkëpunojë gjithashtu edhe me Autoritetin e Konkurrencës për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e sektorit të komunikimeve elektronike. Për herë të parë, këto dy institucione duke u bazuar në kompetencat dhe veprimtarinë e tyre institucionale, hartuan një Memorandum Mirëkuptimi në datë 29.08.07. Nëse i referohemi klauzolave të përcaktuara në këtë Memorandum, mund të themi se ato ishin të përgjithshme dhe nuk siguronin një bashkëpunim efektiv ndër-institucional mes AKEP dhe AK-së.

Pavarësisht rëndësisë që paraqet bashkëpunimi i këtyre dy institucioneve për ruajtjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e telefonisë celulare, vetëm pas 11 vitesh, në vitin 2018 AKEP dhe AK konstatuan mungesën e efektivitetit të Memorandumit të lidhur më herët dhe nevojën për përpilimin e një Memorandumi të ri ndër-institucional ndërmjet tyre. Memorandumi i nënshkruar në vitin 2018, kishte si qëllim përcaktimin e detyrimeve të ndërsjellta institucionale dhe për të evidentuar dhe forcuar akoma edhe më shumë frymën e ligjit. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mes dy institucioneve, në funksion të konkurrencës efektive në treg.

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit AKEP dhe AK bashkëpunojnë në këto drejtime<sup>53</sup>:

- AKEP dhe AK shkëmbejnë informacion të nevojshëm në mënyrë të vazhdueshme, në kuadër të rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit, për çështjet me interes të përbashkët.

---

<sup>52</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH”.

<sup>53</sup> Memorandum Mirëkuptimi AKEP dhe AK nr. prot. 1285, datë 04.05.2018.

- AKEP dhe AK bashkëpunojnë në procesin e përcaktimit të tregjeve dhe analizës së tyre, duke kërkuar dhe marrë parasysh rekomandimet e AK-së.
- Në rastet kur AKEP konstaton sjellje të abuzimit me pozitën dominuese të operatorëve me FNT, ai duhet që tja parashtrijë këto raste AK-së duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.
- AKEP kërkon mendimin e AK-së për projekt-aktet e miratuara, për çështjet që kanë të bëjnë në mënyrë të veçantë me:
  - a) Kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
  - b) Vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara.
  - c) Imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes, sikurse përcaktohet në memorandumun e bashkëpunimit.
- AKEP dhe AK duhet të ngrejnjë grupe të përbashkëta pune të ekspertëve, për kryerjen e analizave të tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstytucional për çështje të karakterit të përbashkët.
- Titullarët e lartë të palëve respektive duhet të takohen rregullisht, me qëllim konsultimin përse i përket implementimit të Memorandumit të Bashkëpunimit Ndërinstytucional dhe përcaktimit të prioriteteve të bashkëpunimit.
- Në kuadër të implementimit me efektivitet të memorandumit të bashkëpunimit, AKEP dhe AK duhet të kryejnë analiza për efektivitetin e zbatimit të Memorandumit të nënshkruar ndërmjet tyre.

Nëse i referohemi veprimtarisë institucionale të ndërmarrë nga Autoriteti i Konkurrencës për vitet 2017-2018 nuk konstatojmë një qasje proaktive të këtij institucioni, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës në tregun e telekomunikacionit. AK ka marrë vetëm 4 vendime në vitin 2017, të cilat lidhen me tregun e telefonisë celulare, edhe pse ky treg përbën një nga tregjet me të rëndësishëm dhe dinamikë, struktura e të cilit paraqitet me përqendrim të lartë.

Në vitin 2017, AK me anë të vendimeve nr. 484 dhe 485, datë 23.11.2017, është shprehur lidhur me transferimin e frekuencave nga Plus Communication tek Vodafone dhe Telecome Albania në masën 50 me 50%. Gjatë argumentimit të vendimit, AK shprehet se ky transferim do të këtë ndikim të vogël në treg për shkak të pjesës së vogël të tregut që zotëron Plus Communication dhe ky veprim nuk do ndikojë në përqendrimin e tregut dhe nuk krijon deformime të konkurrencës në tregun e telefonisë celulare. Në të njëjtën linjë me vendimin e ndërmarrë nga AK, ka qene dhe AKEP përse i përket transferimit të frekuencave tek dy operatorët e tjerë.

Pavarësisht këtij përfundimi nga AKEP dhe AK, të dyja këto institucione shprehen se *de facto* ky veprim i ndërmarrë lidhur me transferimin e frekuencave, ka ndikuar në vijimin e trendit rritës të indeksit të përqendrimit të tregut, pasi si Vodafone ashtu edhe Telekom Albania kanë rritur ndjeshëm kapacitetet konkurruese nëpërmjet marrjes 50 me 50% të të drejtave të përdorimit të frekuencave nga Plus Communication, duke thelluar pozitën dominuese të tyre në treg.

Pavarësisht se në Raportin Vjetor të vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka përcaktuar në prioritetet e veprimtarisë institucionale për vitin 2018 mbikëqyrjen dhe hetimin në tregjet sensitive të ekonomisë shqiptare dhe me impakt të drejtpërdrejtë në interesat e konsumatorit, sikurse është edhe tregu i telekomunikacionit, gjatë vitit 2018 marrë vetëm 2 vendime që lidhen me këtë sektor: vendimin nr. 495, datë 08.02.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA

për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin nr. 475, datë 21.09.2017”, në masën 0.02% të xhiros së secilës ndërmarrjeje për vitin paraardhës financiar; dhe vendimin nr. 568, datë 15.11.2018 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”.

Nga sa më sipër, numri i ulët i vendimeve të marra nga AK për vitin 2017 dhe 2018 në sektorin e telefonisë celulare, tregon mungesë efektiviteti në ushtrimin e veprimtarisë institucionale nga ana e AK-së në mbrojtjen e konkurrencës në këtë treg.

Nëse i referohemi vendimeve të AK-së për vitet 2017 dhe 2018, vërejmë se këto vendime lidhen kryesisht me AKEP dhe vendosin rekomandime për këtë institucion. Autoriteti i Konkurrencës është institucioni përgjegjës për zbatimin dhe implementimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Ai mund të kryejë hetime me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, ose grupeve të interesit në një sektor të caktuar. Pavarësisht problematikave, AK nuk ka kryer asnjë hetim të inicijuar kryesisht nga vetë ai në tregun e telefonisë celulare.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit dhe mbrojtjes së konkurrencës, AKEP dhe AK nuk kanë ngritur grupe pune të përbashkëta të ekspertëve, sikurse kanë parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të hartuar nga vetë palët, për kryerjen e analizave të tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstytucional për çështje të karakterit të përbashkët.

Pavarësisht takimeve të zhvilluara ndërmjet titullarëve të lartë të AKEP dhe AK, këto institucione nuk posedojnë asnjë dokument zyrtar, i cili vërteton se AKEP dhe AK janë konsultuar përse i përket implementimit të Memorandumit të Bashkëpunimit Ndërinstytucional dhe kanë përcaktuar sëbashku prioritetet e këtij bashkëpunimit.

Bazuar në rëndësinë e bashkëpunimit dhe në përcaktimet e këtij Memorandumi, AKEP dhe AK nuk kanë kryer asnjë analizë për efektivitetin e zbatimit të Memorandumit të nënshkruar ndërmjet tyre qysh prej vitit 2007 e deri më sot dhe nuk kanë vlerësuar asnjëherë rëndësinë praktike të këtij akti, duke treguar kështu mungesë efektiviteti në përmbushjen e objektivit të tyre të përbashkët për ruajtjen e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare.

## **GJETJE:**

- MIE dhe AKEP, si institucione kontribuese në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për implementimin e përcaktimeve të parashikuara në këtë plan, lidhur me administrimin e brezave të frekuencave me efektivitet, brenda periudhës së përcaktuar nga ky akt.
- Koordinimi ndërinstytucional ndërmjet AKEP dhe AMA nuk ka qenë efektiv, përse i përket administrimit të përbashkët të brezave të frekuencave, sikurse parashikohet në Planin Kombëtar të Frekuencave.
- AKEP nuk ka kryer një analizë lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë.
- Implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri mbart me vete një risk të lartë të thyerjes së sigurisë së informacionit.
- MIE nuk ka trashëguar memorie institucionale dhe nuk mundet t’i vërë në dispozicion grupit të punës praktikantët e ndjekura për hartimin e legjislacionit, në kontekstin e bashkëpunimit ndërinstytucional me AKEP.

- Ofrimi i shërbimit universal, pavarësisht se gjendet i përcaktuar në ligj ende nuk është implementuar. AKEP dhe MIE nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim implementimin dhe realizimin e këtij objektiv.
- VKM që do të përcaktontë procedurën për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal nuk ka hyrë në fuqi.
- Takimet ndërinstucionale të zhvilluara ndërmjet AKEP dhe MIE janë të pamjaftueshme, në kontekstin e bashkëpunimit ndërinstucional.
- Autoriteti i Konkurrencës për vitet 2017-2018 nuk ka treguar një qasje proaktive, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës në tregun e telekomunikacionit.
- Për vitin 2017 AK ka marrë vetëm 4 vendime të cilat lidhen me tregun e telefonisë celulare dhe për vitin 2018 ka marrë 2 vendime edhe pse ky treg përbën një nga tregjet me të rëndësishëm dhe dinamikë, struktura e të cilit paraqitet me përqendrim të lartë.
- Në vitin 2017, nëpërmjet vendim-marrjes AK dhe AKEP kanë mbajtur qëndrimin se transferimi i frekuencave të Plus Communication tek Vodafone dhe Telecome Albania do të ketë ndikim të vogël në treg për shkak të pjesës së vogël të tregut që zotëron Plus Communication dhe ky veprim nuk do ndikojë në përqendrimin e tregut dhe nuk krijon deformime të konkurrencës në tregun e telefonisë celulare. Pavarësisht këtij përfundimi, të dyja këto institucione shprehen se *de facto* ky veprim i ndërmarrë lidhur me transferimin e frekuencave, ka ndikuar në vijimin e trendit rritës të indeksit të përqendrimit të tregut, duke thelluar pozitën dominuese në treg.
- Vendimeve të AK-së për vitet 2017 dhe 2018 lidhen kryesisht me AKEP dhe vendosin rekomandime për këtë institucion. Autoriteti i Konkurrencës nuk ka kryer asnjë hetim të inicjuar kryesisht nga vetë ai në tregun e telefonisë celulare, me qëllim vendosjen e masave për operatorët e telefonisë celulare.
- AKEP dhe AK nuk kanë ngritur grupe pune të përbashkëta të ekspertëve, sikurse kanë parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të hartuar nga vetë palët, për kryerjen e analizave të tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstucional për çështje të karakterit të përbashkët.
- AKEP dhe AK nuk posedojnë asnjë dokument zyrtar, i cili vërteton se AKEP dhe AK janë konsultuar përpara i përket implementimit të Memorandumit të Bashkëpunimit Ndërinstucional dhe kanë përcaktuar sëbashku prioritetet e këtij bashkëpunimi.
- AKEP dhe AK nuk kanë kryer asnjë analizë për efektivitetin e zbatimit të Memorandumit të nënshkruar ndërmjet tyre qysh prej vitit 2007 e deri më sot dhe nuk kanë vlerësuar asnjëherë rëndësinë praktike të këtij akti, duke treguar kështu mungesë efektiviteti në përmbushjen e objektivit të tyre të përbashkët për ruajtjen e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare.

#### **KONKLUZIONE:**

- ✓ MIE dhe AKEP, si institucione kontribuese në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për implementimin e përcaktimeve të parashikuara në këtë plan, lidhur me administrimin e brezave të frekuencave me efektivitet, brenda periudhës së përcaktuar nga ky akt. Mungesa e koordinimit ndërinstucional ndërmjet AKEP dhe AMA nuk ka qenë efektiv, përpara i

përket administrimit të përbashkët të brezave të frekuencave, sikurse parashikohet në Planin Kombëtar të Frekuencave.

- ✓ Moskryerja e një analize paraprake nga ana e AKEP lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë, mund të sjellë risk të lartë në cënimin e sigurisë kombëtare, nëpërmjet thyerjes së sigurisë së informacionit, si edhe dëme në shëndetin e qytetarëve. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë aderimin e Shqipërisë në strukturat euro-atlantike, implementimi i teknologjisë 5G me hardware dhe software përkatës, duhet të bëhet me pajisje të cilat nuk çenojnë detyrimet që vendi ynë ka marrë përsipër në arenën ndërkombëtare, lidhur me çështjet e sigurisë dhe mbrojtjen e rendit demokratik.
- ✓ Mungesa e memories institucionale për shkak të reformimit të qeverisjes qendrore në nivel ministror, ndikon negativisht në hartimin e planeve strategjike dhe të veprimit, duke ceduar përmbushjen e objektivave.
- ✓ Mungesa e ofrimit të shërbimit universal, tregon se AKEP dhe MIE nuk kanë qenë efektive në implementimin dhe realizimin e këtij objekti.
- ✓ Numri i vogël i vendimeve të marra nga AK në tregun e telefonisë celulare për vitin 2017 dhe 2018, tregon mungesë efektiviteti të këtij institucioni në ruajtjen e konkurrencës në këtë treg.
- ✓ Mungesa e grupeve të punës ndërmjet AK dhe AKEP për kryerjen e analizave të tregjeve, procedurave të inspektimit dhe përcaktimin e prioriteteve të këtij bashkëpunimi tregon mungesë bashkëpunimi dhe vullneti ndërmjet tyre, për t'i dhënë zgjidhje problematikave të konstatuara në tregun e telefonisë celulare.

#### **REKOMANDIME:**

- MIE dhe AKEP të marrin të gjitha masat e nevojshme për implementimin me efektivitet të përcaktimeve të parashikuara në Planin Kombëtar të Frekuencave.

***Në vijimësi***

- AKEP duhet të kryejë një analizë paraprake lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë. Implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri kërkon domosdoshmërisht të kryhet duke u bazuar në një plan-veprimi kombëtar, të detajuar qartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim mbrojtjen e padiskutueshme nga aksesimi i paautorizuar, tjetërsimi, keqpërdorimi apo mos-disponueshmëria, e një asemi të çmuar për konsumatorin shqiptar, siç është informacioni.

Implementimi i kësaj teknologjie duhet të ketë si detyrim kryesor respektimin e obligimeve tona në fushën e sigurisë si vend anëtar i NATO-s dhe partner strategjik i SHBA-ve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

- KLSH rekomandon ngritjen e një Komiteti Kombëtar për vlerësimin e investimeve strategjike në vendin tonë, sikurse është rasti i teknologjisë 5G. Në këtë komitet duhet të ketë përfaqësues jo vetëm të fushës ekonomike, por edhe të fushave të sigurisë, informatike, mbrojtjes, etj. Për këtë duhet miratuar një bazë e posaçme ligjore nga Kuvendi i Shqipërisë. Detyrat e këtij Komiteti duhet të përfshijnë ndër të tjera:

- vlerësimin nëse ofruesit e teknologjisë 5G janë subjekt i kontrollit nga një qeveri e huaj, pa një proces të pavarur gjyqësor;
- vlerësimin nëse furnitorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimit financohen në mënyrë transparente, duke përdorur praktikën më të mira në prokurim, investim dhe kontraktim;
- vlerësimin nëse ofruesit e shërbimit kanë pronësi, partneritet dhe struktura qeverisëse korporative transparente;
- vlerësimin nëse ofruesit janë shembull i inovacionit dhe respektit për zbatimin e ligjit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe; vlerësimin e riskut dhe sigurisë që ofruesit dhe teknologjitë e rrjetit krijojnë një mjedis të sigurtë, pavarësi nga ndikimi qeveritar dhe pajtueshmëri me standartet e industrisë.

Aksioma e punës së këtij Komiteti duhet të jetë respektimi i statusit tonë si vend anëtar i NATO-s, konsideruar si investimi më i madh strategjik në fushën e sigurisë kombëtare që Shqipëria ka arritur në ekzistencën e vet si shtet.

***Menjëherë***

- AKEP dhe MIE duhet të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për implementimin dhe ofrimin e shërbimit universal, në zbatim të përcaktimeve ligjore.

***Menjëherë***

- MIE dhe AKEP duhet të forcojnë bashkëpunimin ndër institucional ndërmjet tyre, nëpërmjet intensifikimit të takimeve.

***Në vijimësi***

- AK duhet të kontribuojë në mënyrë proaktive në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës në tregun e telefonisë celulare, duke rritur numrin e hetimeve të kryera në këtë treg.

***Menjëherë***

- Autoriteti i Konkurrencës duhet të kryejë hetime të inicijuara kryesisht nga vetë ai në tregun e telefonisë celulare, me qëllim vendosjen e masave për operatorët e telefonisë celulare.

***Në vijimësi***

- Me qëllim bashkëpunimin me efektivitet, AKEP dhe AK të marrin masat e nevojshme për ngritjen e grupeve të punës të përbashkëta për kryerjen e analizave të tregjeve dhe procedurave të inspektimit.

***Në vijimësi***

- AKEP dhe AK të përmbushin me rigorozitet çdo përcaktim, të cilin e kanë parashikuar dhe kanë rënë dakord në Memorandumin e Mirëkuptimit.

***Në vijimësi***

- AKEP dhe AK, mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një analize përsa i përket implementimit të këtij akti, duke përcaktuar prioritetet e këtij bashkëpunimi. Ky shqyrtim do të

kryhet në baza dy-vjetore, bazuar në përcaktimin e nenit 7 të këtij memorandumi, sikurse vetë palët kanë parashikuar.

*Në vijimësi*

## NËNPYETJA 2

### **3.1.2 A ka garantuar AKEP mbrojtje dhe besueshmëri të konsumatorëve në tregun e telefonisë celulare?**

#### **3.1.2.1 A ka marrë AKEP masat e nevojshme ndaj subjekteve që kanë cenuar interesat e konsumatorëve?**

Ligji “Për Komunikimet Elektronike” i njeh AKEP-it tagrat për të marrë masa ndaj subjekteve që nuk zbatojnë detyrimet ligjore, me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Një nga objektivat rregullatore të AKEP është nxitja e konkurrencës eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese dhe shërbimeve të tjera *për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike*, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve.<sup>54</sup> Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatore, AKEP mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtarinë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin “Për Komunikimet Elektronike” dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji.<sup>55</sup>

Me qëllim mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për vlerësimin e përputhshmërisë së saj me përcaktimet e parashikuara në ligj, AKEP ushtron veprimtarinë inspektuese.<sup>56</sup> Inspektimi kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit, si dhe nga zyrat e AKEP për kontrollin e veprimtarisë së monitoruar në distancë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet në fuqi të nxjerra nga AKEP.

Veprimtaria e inspektimit në AKEP kryhet mbi bazën e programimit sipas tre lloj planesh:

- Plani Strategjik, i cili përcakton drejtimit dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë disa vjeçarë (zakonisht deri 3 vjet);
- Plani vjetor, bazohet në Planin Strategjik dhe përcakton më në detaje veprimtarinë e inspektimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Plani mujor, i cili del në zbatim të Planit vjetor.

Planifikimi i inspektimit përgatitet mbi bazë risku që nënkupton se inspektimi fokusohet në ato subjekte (sipërmarrës) veprimtaria e të cilëve përmban aspekte me mundësi të ushtrimit në mospërputhje të plotë ose në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kuadrin rregullator. Analiza e riskut mbi të cilën bazohet kryesisht plani strategjik

---

<sup>54</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 7/3/b.

<sup>55</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8/a.

<sup>56</sup> Rregullore nr. 46, datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 2695, datë 27.10.2016.



dhe ai vjetor i inspektimit, merr në konsideratë faktorët më relevantë me ndikim në treg si:<sup>57</sup>

- Pesha në treg e subjektit (sipërmarrësit) nga pikëpamja e rrjetit dhe shërbimeve publike që ofron si dhe peshës në treg referuar numrit të përdoruesve;
- Lloji, larmia dhe teknologjia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit për publikun;
- Standardet teknike, infrastruktura dhe cilësia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit;
- Numri i ankesave të pajtimtarëve dhe performanca e sipërmarrësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtimtarët dhe midis sipërmarrësve;
- Performanca e plotësimit të detyrimeve lidhur me sigurinë kombëtare, sigurinë e rrjeteve, mbrojtjen e të dhënave personale, regjistrimin e të dhënave identifikuese të pajtimtarëve, masave për gjendjet e jashtëzakonshme etj;
- Rezultatet historike të inspektimit;
- Indeksi i reagimit dhe plotësimi i rekomandimeve nga sipërmarrësit për rregullimin e shkeljeve të konstatuara dhe vendosura nga inspektorët dhe/ose AKEP, në aktet e inspektimit;
- Performanca e zbatimit të kushteve të veçanta të përcaktuara në aktet e AKEP për përdorimin e burimeve të fundme.

Duke u bazuar në faktorët e mësipërm, në raportin e vlerësimit të riskut, AKEP ka kategorizuar sipërmarrësit në bazë të riskut, duke i klasifikuar:

- Me risk të lartë – sipërmarrësit e telefonisë celulare: Albtelecom, Telekom, Vodafone, Plus Communication;
- Me risk të mesëm – sipërmarrësit e rrjeteve të internetit: Abcom, Albanian Satellite;
- Me risk të ulët – sipërmarrësit e tjerë.

Edhe pse katër sipërmarrësit e telefonisë celulare janë klasifikuar me risk të lartë, në planin vjetor të inspektimit për vitin 2017<sup>58</sup> dhe 2018<sup>59</sup> është planifikuar vetëm një inspektim në vit për këto sipërmarrës.

Gjithashtu, edhe pse planifikimi me bazë risku duhet të fokusohet në sipërmarrësit me karakteristikat e përmendura më sipër, në planin vjetor të inspektimit për vitin 2017 dhe 2018, AKEP ka kryer inspektime duke u fokusuar vetëm në tematikat si më poshtë:

- 1) Zbatimi i Rregullores nr. 37, datë 29.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike".
- 2) Zbatimi i kushteve teknike të Rregullores nr. 22 "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike".
- 3) Zbatimi i Rregullores nr. 43 Datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit".
- 4) Zbatimi i Rregullores nr. 16, datë 16.04.2010 "Për treguesit e cilësisë së shërbimit", për mbulimin me shërbime broadband dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar".

---

<sup>57</sup> AKEP "Raporti i vlerësimit të riskut (rvr) viti 2017".

<sup>58</sup> AKEP. "Plani Vjetor i Inspektimit për vitin 2017" nr. 644, datë 09.02.2017.

<sup>59</sup> AKEP. "Plani Vjetor i Inspektimit për vitin 2018" nr. 34, datë 05.01.2018.

**Tabela 6:** Inspektimet e kryera te sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike

Viti	Inspektime në terren	Inspektime në distancë
2018	75	232
2017	69	0
2016	51	0
2015	48	0

Burimi: AKEP, Raporti vjetor 2018

Lidhur me veprimtarinë inspektuese, në vitin 2017 AKEP ka kryer gjithsej 69 inspektime në terren tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm<sup>60</sup>. Nga inspektimet e kryera u konstatua se 12 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë dhe 17 sipërmarrës u ç’regjistruan.<sup>61</sup> Në vitin 2018 AKEP ka kryer gjithsej 75 inspektime në terren tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, ku janë marrë 17 masa administrative, 3 prej të cilave “paralajmërim” dhe 14 masa administrative “gjobë”. Gjatë vitit 2018 janë kryer edhe 232 inspektime në distancë lidhur me plotësimin e detyrimeve rregullatore, nga të cilat janë vendosur 64 masa administrative gjobë, kryesisht për shkak të mosrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.<sup>62</sup> Nga sa më sipër, vihet re se për vitin 2017 numri i inspektimeve në terren ka qenë më i vogël se në vitin 2018, si dhe nuk është kryer asnjë inspektim në distancë, edhe pse ky lloj inspektimi përcaktohet në Rregulloren mbi Metodikën e Inspektimit të miratuar nga Këshilli i AKEP në vitin 2016.

Nga inspektimet e kryera në vitin 2017 dhe 2018, pranë operatorëve të telefonisë celulare është kryer vetëm një inspektim në vit, edhe pse tregu i telefonisë celulare është një treg dinamik me shumë risqe, është tregu më i rëndësishëm që AKEP mbikëqyr dhe rregullon, si dhe prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e 2,7 milionë pajtimtarëve.<sup>63</sup>

Nëpërmjet autorizimeve të inspektimeve nr. 401; 402; 403; 404 datë 26.01.2017, AKEP autorizoi kryerjen e një inspektimi tematik “Mbi zbatimin e rregullores nr. 43 për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” në katër operatorët e telefonisë celulare. Lidhur me këtë inspektim, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë vendim përfundimtar inspektimi për sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a. Në vendimin përfundimtar të inspektimit për sipërmarrësit Albtelecom sh.a dhe Plus Communication sh.a, nr. 13 dhe 14, datë 27.02.2017, AKEP është shprehur

<sup>60</sup> “Autorizim i përgjithshëm” është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

<sup>61</sup> AKEP. “Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2017” Tiranë, Prill 2018.

<sup>62</sup> AKEP. “Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2018 Prioritetet e Institucionit për vitin 2019” Tiranë 2019.

<sup>63</sup> AKEP “Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2018” Tiranë, 2019.

se këto sipërmarrës kanë zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rregullorja e portabilitetit dhe për këto sipërmarrës nuk është marrë asnjë masë, por janë lënë vetëm disa rekomandime. Ndërkohë, në raportin vjetor të veprimtarisë institucionale për vitin 2016, në faqen 115 të tij, AKEP shprehet se ndër problematikat kryesore të ankesave të pajtimtarëve është shërbimi i portabilitetit të numrit. Edhe pse AKEP e ka konstatuar një gjë të tillë nga ankesat e pajtimtarëve, në inspektimet e kryera për këtë qëllim në fillim të vitit 2017 nuk ka arritur të identifikojë këto problematika. Gjithashtu, po gjatë vitit 2017, KD i AKEP në mbledhjen e datës 21.12.2017, me Vendimin nr. 26 vendosi nxjerrjen në këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 43 për portabilitetin e numrave, ku shprehet se këtë vendim e mori bazuar në problematikat për portabilitetin e numrave në rrjetet celulare, të evidentuara nga ankesat e konsumatorëve, nga mediat si dhe nga sistemi i bazës së të dhënave. Edhe inspektimi i kryer në vitin 2018 pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare, kishte të njëjtin qëllim, zbatimin e rregullores së portabilitetit të numrit, nga i cili u konstatua se operatorët telefonikë nuk respektojnë procedurat e përcaktuara në rregullore dhe ndaj operatorëve u dha masa administrative “paralajmërim”.

Nga sa më sipër, edhe pse problematika me portabilitetin e numrit ka qenë e madhe dhe e vazhdueshme, AKEP në inspektimin e kryer në vitin 2017 nuk ka arritur ta konstatojë një gjë të tillë, duke treguar mungesë efektiviteti dhe efience të inspektimit të kryer. Përse i përket marrjes së vendimit lidhur me inspektimet e kryera, në nenin 135 të ligjit “Për Komunikimet Elektronike” përcaktohet se:

1. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara:

a) i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar;

b) vendosin gjobë, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët V deri në VIII të tij dhe kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur një afat për realizimin e saj.

2. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara, përveç sa është përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kanë të drejtë:

a) t’i propozojnë Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare heqjen e së drejtës së përdorimit të frekuencave/numeracionit;

b) t’i propozojnë Këshillit Drejtues heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

3. Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 dhe shkronjat “a” e “b” të pikës 2 të këtij neni, vendos:

a) të paralajmërojë sipërmarrësin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;

b) të miratojë propozimin e inspektorëve.

4. Para marrjes së vendimit, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare thërret në seancë dëgjimore sipërmarrësin, për t’i dhënë mundësi të japë shpjegime. AKEP-i merr vendim në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.

Përcaktimet e këtij neni, i japin të drejtën inspektorëve që në rastet e shkeljeve të konstatuara, ta vendosin vetë masën me gjobë ose t'ia propozojnë masën KD dhe më pas të vendosë Këshilli. Nga shqyrtimi i të gjitha vendimeve të KD për vitin 2017 dhe 2018, vihet re se vetëm në një rast i është propozuar KD masa për shkeljet e konstatuara nga inspektimi dhe ai ka marrë vendim, konkretisht për subjektin Unifi Holdings Inc<sup>64</sup>, ndërsa në të gjitha rastet e tjera ku janë vendosur 90 masa administrative “gjobë” dhe 3 masa administrative “paralajmërim”, kanë qenë vetë inspektorët të cilët kanë përcaktuar dhe vendosur masat administrative. AKEP si organ rregullator mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor, ku mbikëqyrjen e kryen nëpërmjet inspektimeve dhe monitorimeve ndërsa rregullimin e kryen nëpërmjet marrjes së masave. Kështu që veprimtaria inspektuese e këtij institucioni është veprimtaria më e rëndësishme, dhe vendimet e veprimtarisë inspektuese kurrësesi nuk duhet të merren pa u paraqitur në Këshillin Drejtues. Mos paraqitja e vendimeve të inspektimeve në Këshillin Drejtues, së pari tregon një mungesë të filtrit të cilësisë, së dyti KD nuk informohet lidhur me veprimtarinë më të rëndësishme të institucionit dhe së treti, tregohet mungesë transparence në këtë proces pasi këto vendime të marra nga vetë inspektorët nuk publikohen asgjëkundi në faqen zyrtare të AKEP. Nga sa më sipër, grupi i auditimit rekomandon AKEP që të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore ku të përcaktohet se çdo vendim inspektimi, pavarësisht llojit të masës së përcaktuar nga inspektorët, të miratohet nga Këshilli Drejtues. Në këtë mënyrë, të gjitha vendimet e inspektimeve bëhen publike duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucionit, pasi deri më tani, në faqen zyrtare të AKEP nuk ka asnjë informacion në lidhje me inspektimet e kryera apo masat e marra<sup>65</sup>, me përjashtim të planit strategjik të inspektimeve. Me qëllim pasqyrimin e veprimtarisë inspektuese, AKEP duhet të përgatisë raportet periodike dhe raportin vjetor të inspektimit, sikurse përcaktohet në pikën 4.3 të Rregullores për metodikën e inspektimit.<sup>66</sup> Raportet e inspektimit përgatiten nga sektori i planifikimit dhe koordinimit të monitorimit dhe inspektimit dhe pasi konfirmohen nga drejtori i DMFCI<sup>67</sup> përcillen në Kabinet për procedurë. Kabineti pasi merr miratimin e Kryetarit e përcjell informacionin në Këshillin Drejtues të AKEP. Raportet janë periodike dhe vjetore. Raportet periodike janë mujore dhe gjashtë mujore. Raportet mujore shërbejnë për të pasqyruar punën e bërë dhe pritshmëritë, ndërsa raportet 6-mujore dhe raportin vjetor pasqyrojnë në mënyrë analitike edhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve.

---

<sup>64</sup> Në vendimin nr. 54, datë 03.08.2018 për “Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, për penalizimin me masë administrative me gjobë ndaj subjektit të inspektuar “Unifi Holdings inc, dega në Shqipëri”, KD i AKEP i ka dhënë subjektit masën administrative “paralajmërim”, si dhe i ka dhënë mundësinë e kryerjes së një inspektimi tjetër.

Në vendimin nr. 91, datë 20.11.2018 për “Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, për penalizimin me masë administrative kryesore gjobë, si dhe dënime plotësuese ndaj subjektit të inspektuar “Unifi Holdings inc, dega në Shqipëri”, KD ka miratuar propozimin e grupit të inspektimit për masën me “gjobë”, pasi edhe në inspektimin e dytë ky subjekt ka rezultuar me shkelje.

<sup>65</sup> Në raportet e veprimtarisë vjetore të AKEP paraqitet vetëm numri i inspektimve të kryera dhe numri i masave të marra, por pa dhënë detaje dhe informacione të tjera.

<sup>66</sup> Rregullore nr. 46, datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 2695, datë 27.10.2016.

<sup>67</sup> Aktualisht DKMI.

Raporti vjetor duhet të jetë objektiv, i drejtë dhe të përfshijë të gjithë fushat e inspektimit në juridiksionin e AKEP. Format i tij duhet të përmbajë kryesisht:

- Titujt kryesorë dhe nëntitujt e duhur;
- Komentet për dokumentet e punës, si dhe raportet periodike;
- Shembujt për të mbështetur komentet e dhëna;
- Përmbledhjen, ku të jepet një përshkrim i shkurtër i aktivitetit inspektues të kryer;
- Rekomandime konstruktive dhe përmirësime të sugjeruara.
- Objektivat për vitin pasardhës.

Nga sa më sipër, DKMI nuk ka përgatitur asnjë raport inspektimi, periodik as vjetor, pasi: nuk i ka vënë në dispozicion asnjë të tillë grupit të auditmit; Këshilli Drejtues nuk ka miratuar asnjë dokument të tillë, pasi nëse do ta kishte miratuar do të ishte pjesë e vendimeve të KD të publikuara në faqen zyrtare të AKEP; do të ishte i publikuar në faqen zyrtare të AKEP në seksionin “publikime” në kuadër të Programit të Transparencës.<sup>68</sup> Një objektiv tjetër rregullator i AKEP është nxitja e konkurrencës eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese dhe shërbimeve të tjera për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, *përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.*<sup>69</sup> Në linjë me sa më sipër, në nenin 25/4 të ligjit “Për Komunikimet Elektronike” në lidhje me masat për përdoruesit me aftësi të kufizuar, përcaktohet se AKEP-i, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për përfshirjen sociale, bën vlerësimin për nevojat e përgjithshme dhe kërkesat specifike, duke përfshirë masën dhe formën konkrete të këtyre masave specifike për personat me aftësi të kufizuar. Në nenin 15/1/dh përcaktohet se në autorizimin e përgjithshëm, AKEP-i vendos kushte për mbrojtjen e konsumatorit duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, në nenin 102 të po këtij ligji, përcaktohet se sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre dhe për masat e marra për të garantuar akses të barabartë për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. Për sa më sipër, AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përdoruesit me aftësi të kufizuar, duke mos mbështetur këtë shtresë në nevojë dhe duke mos zbatuar përcaktimet ligjore. Por përveç mbështetjes së përdoruesve me aftësi të kufizuara, ligji parashikon edhe mbështetjen e përdoruesve me të ardhura të ulëta. Konkretisht në nenin 27 të ligjit “Për Komunikimet Elektronike”, përcaktohet se ofruesit e shërbimit universal mund të ofrojnë tarifa opsionale, *paketa tarifore të veçanta dhe mënyra pagese të veçanta për pajtimtarët me të ardhura të pakta dhe/ose për pajtimtarët me nevoja të veçanta, në mënyrë që këta pajtimtarë të mos jenë përjashtuar nga aksesit në rrjet dhe përdorimi i shërbimeve telefonike.* Por AKEP nuk ka garantuar ofrimin e shërbimit universal dhe si rrjedhojë nuk iu jep mundësi përdoruesve me të ardhura të ulëta dhe aftësi të veçanta që të përfitojnë shërbime me çmime të përballueshme.

---

<sup>68</sup> Programi i Transparencës përgatitet në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” .

<sup>69</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 7/3/a

Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve, në Kreun XI të ligjit “Për Komunikimet Elektronike” përcaktohen detyrimet për sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun në lidhje me: transparencën dhe publikimin e informacionit; kontratat e pajtimtarëve; regjistrimin e pajtimtarëve; mbrojtjen e të dhënave personale; cilësinë e shërbimeve; faturimin, etj., ndërsa në kreun XIV dhe XV, përfshihen përcaktime në lidhje me: zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator; dhe mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

Edhe pse përmbushja e detyrimeve të mësipërme nga ana e sipërmarrësve lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e interesave dhe respektimin e të drejtave të përdoruesve, për periudhën 2017-2018 AKEP nuk ka kryer asnjë inspektim pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare për të vlerësuar se sa zbatohen këto detyrime. Kjo tregon një qasje jo pozitive karshi mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve.

Në zbatim të vendimit nr. 300, datë 08.04.2015 të KM “Për planin kombëtar të zhvillimit të broadband-it”<sup>70</sup>, KD i AKEP nxori vendimet për tre sipërmarrësit e telefonisë celulare<sup>71</sup> që të zbatojnë detyrimet për mbulimin me shërbime broadband të zonave me dendësi të ulët dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në zona të caktuara. Nëpërmjet këtyre vendimeve u përcaktuan: zonat për mbulim me shërbim nëpërmjet investimeve të përbashkëta; zonat për mbulim dhe përmirësim me shërbim në bashkëpunim midis operatorëve; si dhe zonat për mbulim me shërbim nga secili operator.

**Tabela 7:** Zonat për mbulim me shërbim nëpërmjet investimeve të përbashkëta

Zona për mbulim me shërbim	Operatori përgjegjës	Planifikimi	Gjendja aktuale (Komente nga AKEP)
QENDER VERMOSH	Albtelekom	Planifikuar për vitin 2016	Ndertuar stacioni dhe ofruar shërbimi 2G / 3G në Nëntor 2018
GRYKE NOKE		Planifikuar për vitin 2016	Nuk kemi përgjigje për 2019
VALBONA QENDER	Telekom	Planifikuar për vitin 2016	Stacioni VALBONA është bërë aktiv në datë 8/12/2018
KEPI RODONIT		Planifikuar për vitin 2016	Pa përmirësuar, verifikimi 2019
GERMENJ	Vodafone	Planifikuar për vitin 2016	Do ndiqet procesi gjatë muajit Tetor-Nëntor 2019
SHKOPET		Planifikuar për vitin 2016	Pa përmirësuar, verifikimi Qershor 2019

Burimi: Të dhënat marrë nga AKEP, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Mbulimi me shërbim dhe përmirësimi i cilësisë, edhe pse u planifikua që të kryhej brenda vitit 2016, sot në fund të vitit 2019, janë mbuluar me shërbim vetëm dy nga gjashtë zonat e planifikuara për mbulim nëpërmjet investimeve të përbashkëta. Sipas AKEP, operatorët e telefonisë celulare pretendojnë se kanë pasur probleme me marrjen

<sup>70</sup> Vendimi nr. 300, datë 08.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 468, datë 30.05.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”,

<sup>71</sup> Vendimi nr. 2646, datë 03.12.2015 për sipërmarrësin Telekom Albania sh.a.

Vendimi nr. 2647, datë 03.12.2015 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a.

Vendimi nr. 2648, datë 03.12.2015 për sipërmarrësin Albtelecom sh.a.

e lejes për vendosjen e antenave, ndërkohë që AKEP nuk paraqet asnjë veprim apo masë të ndërmarrë prej tij për këtë situatë.

Gjatë veprimtarisë institucionale të vitit 2018, disa nga veprimet e kryera nga AKEP në drejtim të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorit, janë:<sup>72</sup>

- Përmirësimi në portabilitetin e numrit celulare për të mundësuar portim brenda 24 orësh dhe adresuar problemet me identifikimin e pajtimtarëve;
- Mbështetja e iniciativave të qeverisë për rregullimin e roamingut ndërkombëtar me Kosovën dhe vendet e rajonit;
- Rikthimi i vlefshmërisë 30 ditore të ofertave celulare;
- Trajtimi i ankesave të konsumatorëve;
- Përqëndrimi i fokusit për konsumatorin në faqen e internetit të AKEP.

Ndërkohë, në strategjinë institucionale dhe planin e veprimit për vitin 2018, në lidhje me përfitimet për konsumatorët, AKEP kishte planifikuar që të arrinte:<sup>73</sup>

- Portim brenda 24 orësh;
- Mbështetje të veprimtarive të qeverisë për Roving zero me vendet fqinje dhe ulje të ndjeshme të tarifave roaming me vendet e Bashkimit Europian;
- Përshpejtim të procedurave për fillimin e operimit të skemës së Shërbimit Universal;
- Mbrojtje të kujdeshme për përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta;
- Përqendrim të përpjekjeve për arritjen e objektivave broadband (30mbit/sec për 100% të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50% të popullsisë).
- Integritet të të dhënave të pajtimtarit; rishikim të situatës ekzistuese dhe sigurim të saktësisë së plotë të të dhënave të pajtimtarëve;
- Mbulim me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritje të cilësisë së shërbimeve.

Nga sa më sipër, nëse bëjmë një krahasim të asaj çka AKEP kishte planifikuar të arrinte dhe asaj çka ka arritur, vëme re se AKEP ka realizuar vetëm hartimin e rregullores për portabilitetin e numrit ku përcaktohet afati kohor prej 24 orësh si dhe mbështetjen e qeverisë në lidhje me uljen e tarifave të roamingut me vendet fqinje. AKEP nuk ka vepruar me efektivitet në përmbushjen e objektivave të vendosura për mbrojtur dhe rritur përfitimet e konsumatorëve.

## **GJETJE:**

- AKEP, deri në vitin 2018 nuk ka kryer asnjë inspektim në distancë të sipërmarrësit e telefonisë celulare, edhe pse ky lloj inspektimi parashikohet në Rregulloren nr. 46/2016 mbi Metodikën e Inspektimit të miratuar nga Këshilli i AKEP në vitin 2016, si dhe është metodë monitorimi efektive për identifikimin e problematikave në këtë treg.
- AKEP, për vitin 2017 dhe 2018 ka kryer vetëm një inspektim në vit pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare, edhe pse tregu i telefonisë celulare është një treg dinamik me shumë risqe dhe probleme, është tregu më i rëndësishëm që AKEP mbikëqyr dhe rregullon, si dhe prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e 2.7 milionë pajtimtarëve.

---

<sup>72</sup> AKEP "Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2018" Tiranë, 2019.

<sup>73</sup> AKEP. "Strategjia Institucionale dhe Plani i Veprimit për vitin 2018" miratuar me VKD nr. 29, datë 29.12.2017.

- AKEP nuk ka marrë në konsideratë risqet reale të sipërmarrësve në planin vjetor të inspektimit, ku për sipërmarrësit të cilët i ka klasifikuar me risk të lartë, ka planifikuar vetëm një inspektim në vit.
- AKEP, në planifikimin e inspektimeve nuk ka marrë në konsideratë të gjitha problematikat e sipërmarrësve të telefonisë celulare ku në të dy inspektimet e kryera pranë këtyre sipërmarrësve për vitin 2017 dhe 2018 ka inspektuar vetëm zbatimin e rregullores Nr.43 mbi portabilitetin e numrit.
- AKEP, në inspektimin e kryer në vitin 2017 pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare në lidhje me zbatimin e rregullores së portabilitetit të numrit nuk ka arritur ta konstatojë ndonjë problematikë duke u shprehur se këto sipërmarrës kanë zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rregullorja, ndërkohë që në raportet vjetore të veprimtarisë institucionale AKEP shprehet se ndër problematikat kryesore të ankesave të pajtimtarëve është shërbimi i portabilitetit të numrit. Edhe pse problematika me portabilitetin e numrit ka qenë e madhe dhe e vazhdueshme, AKEP në inspektimin e kryer në vitin 2017 nuk ka arritur ta konstatojë një gjë të tillë, duke treguar mungesë efektiviteti dhe efience të inspektimit të kryer.
- Për periudhën 2017-2018 AKEP nuk ka kryer asnjë inspektim pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare për të vlerësuar se sa zbatohen detyrimet e përcaktuara në Kreun XI, XIV dhe XV të ligjit “Për Komunikimet Elektronike” në lidhje me: kontratat e pajtimtarëve; regjistrimin e pajtimtarëve; mbrojtjen e të dhënave personale; cilësinë e shërbimeve; faturimin; zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator; dhe mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Kjo tregon një qasje jo pozitive karshi mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve.
- DKMI për periudhën 2017 – 2018 ka paraqitur në Këshillin Drejtues të AKEP vetëm një vendim inspektimi për marrje masash dhe në të gjitha rastet e tjera ku janë vendosur 90 masa administrative “gjobë” dhe 3 masa administrative “paralajmërim”, kanë qenë vetë inspektorët të cilët kanë përcaktuar dhe vendosur masat administrative.
- AKEP nuk ka përgatitur raportet periodike dhe raportin vjetor të inspektimit, sikurse përcaktohet në pikën 4.3 të Rregullores Nr.46/2016 për metodikën e inspektimit. Raportet mujore shërbejnë për të pasqyruar punën e bërë dhe pritshmëritë, ndërsa raportet gjashtë mujore dhe raporti vjetor pasqyrojnë në mënyrë analitike edhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve.
- AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të mbrojtur përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta duke ju mundësuar tarifa opsionale, paketa tarifore të veçanta dhe mënyra pagese të veçanta, sikurse përcaktohet në nenin 27 të ligjit “Për Komunikimet Elektronike” dhe sikurse AKEP kishte përcaktuar në planin e veprimit institucional të vitit 2018.
- AKEP nuk ka ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme ndaj sipërmarrësve të telefonisë celulare për të mundësuar mbulim me shërbim në zonat me dendësi të ulët, në zbatim të vendimit Nr. 300, datë 08.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për planin kombëtar të zhvillimit të broadband-it”. Nga gjashtë zonat e planifikuara për tu mbuluar me shërbim brenda vitit 2016, aktualisht mbulohen me shërbim vetëm dy prej tyre.
- AKEP nuk ka vepruar me efektivitet në përmbushjen e objektivave të vendosura për mbrojtjen dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve, pasi nga 7 objektiva të



përcaktuara në planin e veprimit për vitin 2018, ka përmbushur vetëm 2 prej tyre. AKEP gjatë vitit 2018 nuk ka arritur të përmbushë:

- ✘ Përshpejtim të procedurave për fillimin e operimit të skemës së Shërbimit Universal;
- ✘ Mbrojtje të kujdeshme për përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta;
- ✘ Përqendrim të përpjekjeve për arritjen e objektivave broadband (30mbit/sec për 100% të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50% të popullsisë).
- ✘ Integritet të të dhënave të pajtimtarit; rishikim të situatës ekzistuese dhe sigurim të saktësisë së plotë të të dhënave të pajtimtarëve;
- ✘ Mbulim me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritje të cilësisë së shërbimeve.

#### **KONKLUZIONE:**

- ✓ Mos kryerja e inspektimeve pranë pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve ndaj pajtimtarëve, së pari tregon mungesë efektiviteti të AKEP në veprimtarinë e tij si mbikëqyrës i tregut të telefonisë celulare dhe së dyti tregon një qasje jo pozitive karshi mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve.
- ✓ Mos paraqitja e vendimeve të inspektimeve në Këshillin Drejtues, së pari tregon një mungesë të filtrit të cilësisë, së dyti KD nuk informohet lidhur me veprimtarinë më të rëndësishme të institucionit dhe së treti, tregohet mungesë transparence në këtë proces pasi këto vendime të marra nga vetë inspektorët nuk publikohen asgjëkundi në faqen zyrtare të AKEP.
- ✓ Mos marrja e veprimeve nga AKEP të mbrojtur përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe me të ardhura shumë të ulëta, ka ndikuar që një pjesë e këtyre përdoruesve të jenë të përjashtuar nga aksesimi në rrjetet dhe përdorimi i shërbimeve telefonike, për shkak të mospërbalueshmërisë së çmimeve, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e përfitimeve dhe mirëqenies së tyre.
- ✓ Mos përmbushja nga AKEP e objektivave institucionale për mbrojtjen dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve, tregon se AKEP i ka kushtuar më pak fokus dhe rëndësi çështjes së rritjes së përfitimeve të konsumatorëve, duke ndikuar kështu që konsumatorët të marrin shërbime me kosto më të lartë dhe cilësi më të ulët.

#### **REKOMANDIME:**

- DKMI pranë AKEP të hartojë plane strategjike dhe vjetore inspektimi efektive, duke marrë në konsideratë risqet dhe problematikat reale të sipërmarrësve si dhe të kryejë inspektime në bazë të risqeve që mbart çdo sipërmarrës.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- DKMI pranë AKEP të rrisë numrin e inspektimeve dhe monitorimeve në distancë dhe në terren pranë sipërmarrësve të kompanive celulare, duke u fokusuar në ato çështje që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e konsumatorëve. Pas kryerjes së inspektimeve, të ndiqet me rigorozitet zbatimi i rekomandimeve të lëna.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- DKMI pranë AKEP të kryejë inspektime pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare për të vlerësuar se sa zbatohen detyrimet e përcaktuara në Kreun XI, XIV dhe XV të

ligjit “Për Komunikimet Elektronike” në lidhje me: kontratat e pajtimtarëve; regjistrimin e pajtimtarëve; mbrojtjen e të dhënave personale; cilësinë e shërbimeve; faturimin; zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator; dhe mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- DKMI pranë AKEP të përgatisë raportet periodike dhe raportin vjetor të inspektimit, sikurse përcaktohet në pikën 4.3 të Rregullores Nr.46/2016 për metodikën e inspektimit, në të cilat të pasqyrojë punën e bërë dhe pritshmëritë, si dhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve. Këto raporte të miratohen nga KD dhe të publikohen në faqen zyrtare të AKEP.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- AKEP të marrë të gjitha masat për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore ku të përcaktohet se çdo vendim inspektimi, pavarësisht llojit të masës së përcaktuar nga inspektorët, të miratohet nga Këshilli Drejtues. Në këtë mënyrë, të gjitha vendimet e inspektimeve bëhen publike duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucionit.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- AKEP të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse në mënyrë që t’ju ofrojë përdoruesve me aftësi të kufizuar përfitime maksimale nga aksesimi në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë, sipas përcaktimeve të ligjit “Për Komunikimet Elektronike”.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- AKEP të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta nëpërmjet ofrimit të çmimeve të përbalueshme, duke e vënë në zbatim objektivin e përcaktuar për vitin 2018.

***Mars 2020***

- AKEP të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme ndaj sipërmarrësve të telefonisë celulare që brenda vitit 2020 të jenë mbuluar me shërbim të gjitha zonat me dendësi të ulët, si dhe të kryerjeh monitorime të vazhdueshme për të identifikuar zonat që kanë nevojë për përmirësim të cilësisë së shërbimit.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

- AKEP në planet vjetore të punës të përcaktojë objektiva SMART si dhe të hartojë plane pune të detajura për përmbushjen e secilit objektiv institucional të planifikuar.

***Menjëherë dhe në vazhdim***

### **3.1.2.2 A janë shërbimet e ofruara nga kompanitë e telefonisë celulare në përputhje me pritshmëritë e konsumatorëve?**

Pritshmëritë, i referohen tërësisë së përfitimeve të perceptuara që një konsumator pret nga një produkt apo shërbim. Pritshmëritë janë të lidhura ngushtë me kënaqësinë, pasi kënaqësia është diferenca midis asaj që konsumatorët presin të marrin dhe asaj çka ata

marrin realisht. Sa më e madhe të jetë kjo diferencë, aq më e madhe është pakënaqësia, dhe e kundërta. Kompanitë dhe institucionet, me qëllim rritjen e kënaqësisë së klientëve, që është një nga elementet themelore për suksesin e tyre, duhet që të fokusohen në ngushtimin e kësaj diference.

Në rastin e shërbimeve telefonike, konsumatorët presin të marrin një shërbim cilësor dhe në përputhje me çmimin që paguajnë. Për të vlerësuar pritshmëritë e tyre dhe kënaqësinë lidhur me tregun e telefonisë celulare, grupi i auditimit ka konceptuar një pyetësor për publikun të cilin e ka shpërndarë online në media të ndryshme sociale për të përfituar një kampion të anketuarishtë sa më të lartë dhe përfaqësues. Përgjigjet e këtij pyetësoi do t'i shërbejnë kompanive të telefonisë celulare si dhe AKEP-it, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e këtij tregu, në mënyrë që të marrë masat e duhura rregulluese.

Por si e rregullon AKEP këtë treg në lidhje me cilësinë e shërbimit dhe tarifat? Dokumenti bazë mbi të cilin AKEP e kryen veprimtarinë e tij është ligji "Për Komunikimet Elektronike". Në nenin 8/v të këtij ligji përcaktohet se "*AKEP përcakton masa për rregullimin e tarifave, si dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar, premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve*". Në nenin 53 përcaktohet se qëllimi i rregullimit të tarifave është parandalimi i sjelljeve antikonkurruese dhe i diskriminimit të përdoruesve fundorë dhe konkurruesve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tarifat.

Sipas nenit 57/1, AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:

- a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;
- b) korigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:
  - i. kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;
  - ii. raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;
  - iii. procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove eficientë, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;

Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

- a. praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
- b. tarifat mesatare të vendeve të BE-së;
- c. tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;
- ç. raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
- d. normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

AKEP që nga viti 2006 ka bërë rregullimin ex-ante të tarifave të terminimit në rrjetet celulare duke përdorur një sërë metodash. Rregullimi i tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE; nga viti 2010 – mars 2014 ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e

përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC<sup>74</sup> i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare; ndërsa nga viti 2015 e në vazhdim AKEP përdor një model benchmark duke u bazuar në nivelin mesatar të tarifave të terminimit të vendeve europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BU-LRIC<sup>75</sup>.

Komisioni Europian dhe BEREC, në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, kanë rekomanduar orientimin e tarifave drejt koston si dhe përdorimin e modelit Pure LRIC. Gjithashtu, edhe në ligjin "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", në nenet 45, 49 dhe 57 parashikohet qartësisht kërkesa për zbatimin e parimit të orientimit të tarifave drejt koston, pasi orientimi në koston Pure LRIC gjykohet si një nga masat me efektin më të madh në rritjen e konkurrencës në treg dhe aftësisë konkurruese të operatorëve më të vegjël nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve të tyre për thirrjet off-net.

Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009, në pikën 22 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit Pure LRIC, duke rekomanduar që *"këto vende mund të aplikojnë metoda alternative (si benchmark)<sup>76</sup>, deri në Korrik të vitit 2014. Në rastet kur Autoritetet Rregullatore kanë ende burime të kufizuara për ta aplikuar këtë model kostoje edhe pas kësaj date, mund të vazhdojnë të aplikojnë metodën alternative benchmark deri në një përditësim të këtij Rekomandimi, dhe BEREC-u, Komisioni së bashku me grupet e punës, do të ofrojnë mbështetje dhe udhëzime praktike për të kapërcyer këto kufizime të burimeve dhe për të implementuar modelin e rekomanduar të kostove".<sup>77</sup>*

Edhe pse orientimi i tarifave drejt koston rekomandohet nga KE që në vitin 2009, nga BEREC dhe nga ligji i vet AKEP, AKEP vazhdon të përdorë metodën benchmark. Lidhur me mos aplikimin e modelit Pure LRIC, AKEP është shprehur se modeli kërkon kohë të gjatë për tu zhvilluar dhe se ka mungesë burimesh dhe ekspertize, kur ndërkohë e ka kryer një praktikë të tillë më parë (në vitin 2010 për ndërtimin e modelit BULRAIC në përcaktimin e tarifave të terminimit), çdo vit ka tepriçë buxheti të cilën e derdh në buxhetin e shtetit, si dhe i është ofruar mbështetje dhe udhëzime nga KE dhe BEREC.

Nga sa më sipër, shohim se modeli Pure LRIC shërben për rregullimin e tarifave të terminimit, por lind pyetja se çfarë është terminimi dhe çfarë janë tarifat e terminimit? Gjatë kryerjes së një bisede telefonike, një konsumator paguan për:

1. Origjinimin e thirrjes – fillimi i thirrjes nga telefonuesi;
2. Transportimin e sinjalit (the call) – dërgimi i sinjalit;
3. Terminimin – përfundimin e thirrjes te marrësi i telefonatës;

---


<sup>74</sup> Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)

<sup>75</sup> Bottom Up Long-Run Incremental Cost është një model i bazuar në kostot aktuale që reflekton kostot e një operatori eficient

<sup>76</sup> Niveli mesatar i tarifave të terminimit të vendeve europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BURIC

<sup>77</sup> Commission Recommendation of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC). Official Journal of the European Union

**Figura 5:** Marrëdhëniet dhe rrjedha e pagesës



Burimi: WIK-Consult, përpunuar nga GA


Për shembull, nëse një konsumator i operatorit A, do të telefonojë një mik të tij që është konsumator i operatorit B, operatori A do të tarifojë konsumatorin me një tarifë të caktuar lek/minutë (tarifa e pakicës), ndërsa operatori B, do të tarifojë operatorin A me një tarifë lek/minutë për terminimin e thirrjes në rrjetin e tij (tarifa e shumicës). Pra tarifa e terminimit (MTR), për një operator telefonik shërben si burim i të ardhurave nga shumica për thirrjet hyrëse në rrjetin e tij dhe si burim i kostove nga shumica për thirrjet dalëse jashtë rrjetit të tij. Nga kjo nënkuptohet se nëse një operator ka pjesë të madhe tregu dhe ka më shumë thirrje hyrëse në rrjetin e tij sesa dalëse jashtë rrjetit të tij, atëherë ka më shumë të ardhura sesa kosto nga MTR.

Edhe pse tarifat e terminimit (MTR) nuk lidhen drejtpërdrejtë me pagesën që bëjnë konsumatorët, ato ndikojnë në mënyrë indirekte në uljen e çmimit të tarifave të pakicës. Reduktimet e MTR mund të çojnë në rënie të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare, por ato çojnë njëkohësisht në reduktim të kostove të thirrjeve off-net të operatorve dhe mundësinë për tarifa më të lira të përdoruesve fundore, pra dhe në rritje të trafikut që mund të kompensojë për rënien e tarifës. Gjithashtu reduktimi i MTR jep një impuls shtesë pozitiv në rritjen e mëtejshme të konkurrencës në tregun celular me pakicë në Shqipëri dhe përfitimeve të përdoruesve të shërbimeve celulare.

Lidhur me rregullimin e tarifave të terminimit, në dokumentin e analizës së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP miratoi orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër.

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom u reduktuan dhe më 1.09.2013 arritën nivelin e koston 4.57 lek/minutë. AKEP me vendimet nr.2431-2435, date 13.03.2014, vendosi që tarifat e terminimit të katër operatorëve të reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 të arrinin në vlerën 2.66 lek/minutë; me datë 1.04.2015 të arrinin në 2.04 lek/minutë; dhe me datë 01.01.2016 të arrinin 1.48 lek/minutë, e cila ishte sa vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Europiane që kanë aplikuar Pure LRIC në vitin 2013.

**Figura 6: Procesi i uljes së tarifave të terminimit**



Burimi: AKEP, përpunuar nga GA

Ajo çka vihet re nga sa më sipër, është fakti se në vitin 2016 në Shqipëri janë aplikuar tarifa terminimi të cilat në vendet europiane janë aplikuar që në vitin 2013. Gjithashtu, tarifa prej 1.48 lek/minutë që ka filluar të aplikohet që në fillim të vitit 2016, është aplikuar për 3 vite me rradhë, deri në dhjetor 2018. Pra, në Shqipëri në vitin 2018 është aplikuar e njëjta tarifë terminimi që vendet e BE-së e kanë aplikuar në vitin 2013.

Por pse tarifa prej 1.48 lek/minutë nuk ka ndryshuar për tre vite? AKEP kaloi në një kalvar të gjatë për marrjen e vendimit për uljen e tarifave të terminimit të cilat duhet të ishin miratuar që në vitin 2016 kur AKEP miratoi nxjerrjen për këshillim publik<sup>78</sup> të analizës së tregut të shërbimeve celulare<sup>79</sup> dhe më pas të rregullimit të tarifave<sup>80</sup>. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik duhet të kryhej në periudhën 22.12.2016-7.02.2017, siç përcaktohet në nenin 110 të ligjit “Për Komunikimet Elektronike”. AKEP nuk konkludoi me një vendim në përfundim të periudhës së këshillimit publik, por bazuar në kërkesën e Vodafone Albania, Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, vendosi për shtyrjen e periudhës së këshillimit publik të këtyre dokumenteve për një afat maksimal jo më shumë se 60 ditë nga data 16.02.2017, që i bie deri me datë 16.04.2017. Pas përfundimit të këtij afati, AKEP nuk del me një vendim por iu kërkon kompanive përsëri që ata të depozitojnë komentet e tyre.<sup>81</sup> Edhe pse kompanitë telefonike depozituan komentet, AKEP nuk

<sup>78</sup> AKEP-i, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike ose që kanë lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë, në veçanti përdoruesit me aftësi të kufizuara, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.

<sup>79</sup> Vendimi Nr.2699, datë 01.12.2016, “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik

<sup>80</sup> Vendimi nr. 2700, datë 22.12.2016, “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”

<sup>81</sup> AKEP me shkresën Nr.1907/9 Prot., datë 8.05.2017, kërkoi që operatorët deri më 15.05.2017 të depozitonin pozicionin final të tyre për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016 për analizën e tregut celular..

konkludoi me një vendim. Më vonë, në dhjetor 2017, nëpërmjet një shkresë tjetër<sup>82</sup> iu kërkon subjekteve për herë të tretë që të depozitojnë komente mbi dy dokumentet e vitit 2016. Pas dërgimit të kësaj shkresë, kompanitë celulare depozituan komentet e tyre dhe më pas AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 miratoi dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”. Bordi i AKEP me Vendimet nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018 vendosi përcaktimin e sipërmarrësve Vodafone Albania Sh.a., Telekom dhe Altelecom me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese. Pas miratimit të analizës dhe përcaktimit të sipërmarrësve me FNT, u ri nxorr edhe njëherë për këshillim publik dokumenti mbi rregullimin e tarifave<sup>83</sup> i cili u miratua më pas në Tetor 2018.<sup>84</sup> Në këtë vendim u përcaktua se për të tre kompanitë telefonike me FNT, tarifa e terminimit do të reduktohet në 1.22 lek/minutë në Fazën I që fillon me 01.12.2018 dhe një vit më pas në Fazën II që fillon me 01.12.2019 të reduktohet në 1.11 lek/minutë. Pra rregullimi i tarifave të terminimit i cili duhet të kryhej pas analizës së vitit 2016, për shkak të shtyrjes së miratimit të këtij dokumenti nga AKEP, u miratua në fund të vitit 2018, dhe kjo është arsyeja e mungesës së rregullimit të tarifave të terminimit për periudhën 2016-2018.

Por çfarë efektesh ka sjellë shtyrja në kohë kaq të gjatë e miratimit të dokumentave të analizës së tregut dhe rregullimit të tarifave? Nëse shohim në tabelën e mësipërme ku janë paraqitur vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (MTR) për: 28 vendet e BE, 37 vendet BEREC, vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure LRIC, dhe tre operatorëve telefonik celular në Shqipëri, ajo që vihet re është se gjatë periudhës 2017-2019 Shqipëria ka vlerat mesatare MTR më të larta.

- Në vitin 2015 Shqipëria ka tarifën MTR 2.04 lek/minutë; më e lartë sesa të gjitha mesataret e tjera përveç mesatares së thjeshtë të vendeve të BEREC 2.12 lek/minutë;
- Në vitin 2016 Shqipëria ka tarifën MTR 1.48 lek/minutë; më e lartë sesa mesatarja e thjeshtë e vendeve të BE 1.44 lek për minutë dhe se mesatarja e BEREC Pure LRIC 1.22 lek/minutë;
- Në vitin 2017 Shqipëria ka tarifën MTR 1.48 lek/minutë; më e lartë se të gjitha mesataret e BE, BEREC, BEREC Pure LRIC;<sup>85</sup>
- Në vitin 2018 Shqipëria ka tarifën MTR 1.48 lek/minutë; më e lartë se të gjitha mesataret e BE, BEREC, BEREC Pure LRIC;
- Në vitin 2019 Shqipëria ka tarifën MTR 1.22 lek/minutë; më e lartë se të gjitha mesataret e BE, BEREC, BEREC Pure LRIC;

**Tabela 8:** Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (MTR) në vendet e BE, BEREC dhe Shqipëri (në eurocent dhe lekë)

Korrik 2015 <sup>86</sup>	Korrik 2016 <sup>87</sup>	Korrik 2017 <sup>88</sup>	Korrik 2018 <sup>89</sup>	Janar 2019 <sup>90</sup>
---------------------------	---------------------------	---------------------------	---------------------------	--------------------------

<sup>86</sup> BEREC. “Termination rates at European level July 2015” BoR (15) 211. 7 December 2015

<sup>87</sup> BEREC. “Termination rates at European level July 2016” BoR (16) 218. December 2016

<sup>88</sup> BEREC. “Termination rates at European level July 2017” BoR (17) 227. 7 December 2017


<sup>89</sup> BEREC. “Termination rates at European level July 2018” BoR (18) 218. 6 December 2018

<sup>90</sup> BEREC. “Termination rates at the European level January 2019” BoR (19) 91. 13 June 2019

	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë
<b>Average BEREC 37(S)</b>	1.5161	2.12	1.2743	1.76	1.0565	1.42	0.9402	1.20	0.8847	1.10
<b>Average BEREC 37(W)</b>	1.2176	1.70	1.1358	1.57	0.9262	1.24	0.8467	1.08	0.7837	0.98
<b>Average EU28(S)</b>	1.1347	1.59	1.0435	1.44	0.8795	1.18	0.8342	1.06	0.7794	0.97
<b>Average EU28 (W)</b>	1.1408	1.60	1.0836	1.50	0.9079	1.22	0.8541	1.09	0.7956	0.99
<b>Average BEREC (Pure LRIC)</b>	1.0112	<b>1.41</b>	0.8800	<b>1.22</b>	0.8189	<b>1.11</b>	0.7778	<b>0.99</b>	0.7363	<b>0.92</b>
<b>Albania (AVG 3 MNO)</b>	1.4587	<b>2.04</b>	1.0699	<b>1.48</b>	1.1000	<b>1.48</b>	1.1620	<b>1.48</b>	0.9810	<b>1.22</b>
<b>Ndryshimi BEREC (Pure LRIC)/Albania</b>	<b>30%</b>		<b>18%</b>		<b>25%</b>		<b>33%</b>		<b>25%</b>	

Burimi: Të dhënat marrë nga raportet e BEREC, analizuar nga GA

**Grafiku 3:** Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (MTR) në vendet e BE, BEREC dhe Shqipëri (lekë/minutë)



Burimi: Të dhënat marrë nga raportet e BEREC, analizuar nga GA

<sup>87</sup> BEREC. "Termination rates at European level July 2016" BoR (16) 218. December 2016

<sup>88</sup> BEREC. "Termination rates at European level July 2017" BoR (17) 227. 7 December 2017

<sup>89</sup> BEREC. "Termination rates at European level July 2018" BoR (18) 218. 6 December 2018

<sup>90</sup> BEREC. "Termination rates at the European level January 2019" BoR (19) 91. 13 June 2019



Në Rekomandimin e KE maj/2009 për vendet të cilat nuk kanë kapacitete për të ndërtuar modelin Pure LRIC, rekomandohet përdorimi i metodave alternative benchmark<sup>91</sup>, dhe përcaktohet se *rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të larta se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e Pure LRIC*. Pra tarifat në Shqipëri (Albania AVG 3 MNO) nuk duhet të jenë më të larta vlera mesatare e tarifave të vendeve që kanë përdorur modelin Pure LRIC (Average BEREC Pure LRIC). Nga tabela dhe figura të cilat paraqesin një krahasim të MTR-ve, vihet re se MTR-të në Shqipëri gjatë periudhës 2015-2019 kanë qenë 18%-33% më të larta sesa MTR mesatare e vendeve që përdorin Pure LRIC. Konkretisht, në vitin 2015 ishin 30% më të larta; në vitin 2016 ishin 18% më të larta; në vitin 2017 ishin 25% më të larta; në vitin 2018 ishin 33% më të larta dhe në vitin 2019 ishin 25% më të larta. Nga sa më sipër, vihet re se nuk zbatohet Rekomandimi i KE-së për të mos aplikuar tarifa më të larta se MTR e vendeve që përdorin Pure LRIC.

**Tabela 9:** Krahasimi i MTR-ve mes Shqipërisë dhe në vendeve të rajonit (në eurocent dhe lekë<sup>92</sup>)

	Korrik 2015		Korrik 2016		Korrik 2017		Korrik 2018		Janar 2019	
	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë	Eurocent	Lekë
<b>Shqipëria</b>	1.459	<b>2.04</b>	1.070	<b>1.48</b>	1.100	<b>1.48</b>	1.162	<b>1.48</b>	0.981	<b>1.22</b>
<b>Greqia</b>	1.103	1.54	1.081	1.49	1.072	1.44	0.958	1.22	0.946	1.18
<b>Kroacia</b>	0.832	1.16	0.840	1.16	0.848	1.14	0.635	0.81	0.633	0.79
<b>Mali i Zi</b>	1.900	2.66	1.180	1.63	1.060	1.42	0.850	1.08	0.850	1.06
<b>Maqedonia e Veriut</b>	1.464	2.05	1.459	2.02	1.022	1.37	1.025	1.30	1.024	1.27
<b>Serbia</b>	2.848	3.98	2.236	3.09	1.684	2.26	1.210	1.54	1.210	1.51
<b>Turqia</b>	0.878	1.23	0.806	1.11	0.669	0.90	0.506	0.64	0.421	0.52
<b>Mesatarja e vendeve të rajonit</b>	1.504	<b>2.10</b>	1.267	<b>1.75</b>	1.059	<b>1.42</b>	0.864	<b>1.11</b>	0.847	<b>1.05</b>

Burimi: Të dhënat marrë nga raportet e BEREC, analizuar nga GA

Në tabelën e mësipërme, janë paraqitur MTR-të e vendeve të rajonit për të bërë një krahasim me MTR-të në Shqipëri. Ajo që vihet re është se MTR-të më të larta nga vendet e rajonit i ka Serbia dhe më të ulëta i ka Turqia. Shqipëria renditet e katërta për tarifat

<sup>91</sup> Duke u bazuar në nivelin mesatar të tarifave të terminimit të vendeve europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure LRIC

<sup>92</sup> Për të kryer llogaritjet e tarifave nga eurocent në lekë, për vitet 2016-2019 është përdorur kursi i këmbimit që ka përdorur BEREC në raportet e tij, ndërsa për vitin 2015 është përdorur kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë.


- Për vitin 2015 është përdorur kursi 139.85 lek/euro;
- për vitin 2016 është përdorur kursi 138.33 lek/euro;
- për vitin 2017 është përdorur kursi 134.38 lek/euro;
- për vitin 2018 është përdorur kursi 127.35 lek/euro; dhe
- për vitin 2019 është përdorur kursi 124.48 lek/euro.

më të larta në vitin 2015 dhe 2016; dhe e dyta në vitet 2017-2019. Nëse bëjmë një krahasim të MTR-ve në Shqipëri me vlerën mesatare të MTR-ve të gjashtë vendeve të rajonit, rezulton se MTR-të në Shqipëri janë më të larta për periudhën 2017-2019.

Nga krahasimi i tarifave të terminimit të thirrjeve celulare MTR të Shqipërisë me mesataren e vendeve të rajonit, BE dhe BEREC, rezulton se për periudhën 2017-2019 Shqipëria ka MTR-të më të larta.

Për të vlerësuar perceptimin dhe pritshmëritë e konsumatorëve në lidhje me shërbimet e ofruara nga kompanitë telefonike, siç është përmendur edhe më sipër, të dhënat janë mbledhur nga një pyetësor me publikun. Nëpërmjet këtij pyetësi konsumatorët u pyetën nëse e kanë ndërruar ndonjëherë kompaninë telefonike dhe nëse po cila ka qenë arsyeja; nëse mendojnë ta ndërrojnë kompaninë telefonike dhe nëse po cila është arsyeja; nëse tarifat janë të përballeshme; sa të kënaqur janë ata me tarifën, shërbimin, internetin dhe shërbime të tjera që ofrojnë kompanitë telefonike; dhe në pyetjen e fundit janë pyetur se çfarë ata duan që kompanitë telefonike të përmirësojnë.


**Grafiku 4:** A e keni ndërruar ndonjëherë kompaninë telefonike?



Burimi: Të dhënat e mbledhura nga pyetësi, analizuar nga GA

Kur një konsumator është i kënaqur, ai gjithashtu është besnik ndaj markës apo kompanisë dhe nuk e ndërron atë. Për të vlerësuar se sa të kënaqur kanë qenë konsumatorët me kompanitë celulare, janë pyetur se a e kanë ndërruar ndonjëherë kompaninë telefonike dhe nga përgjigjet e tyre rezultoi se 58.9% e tyre e kanë ndërruar të paktën një herë. Lidhur me pyetjen tjetër që e shoqëronte këtë pyetje, se cila ka qenë arsyeja e ndërrimit të kompanisë telefonike, 71% e të anketuarve janë shprehur se kanë qenë tarifën e larta dhe 29% janë shprehur se kanë pasur arsye të tjera të ndryshme.


### Grafiku 5: A mendoni ta ndërroni kompaninë telefonike?



Burimi: Të dhënat e mbledhura nga pyetësi, analizuar nga GA

Pas kësaj, të anketuarit gjithashtu janë pyetur se a mendojnë ta ndërrojnë kompaninë telefonike dhe nga përgjigjet e tyre ka rezultuar se 45% duan ta ndërrojnë. Të pyetur mbi arsyet se pse duan ta ndërrojnë, 85% janë shprehur për shkak të tarifave të larta.


### Grafiku 6: A mendoni se paketat e ofruara janë të përballueshme për ju?



Burimi: Të dhënat e mbledhura nga pyetësi, analizuar nga GA

Pyetja tjetër që iu drejtua të anketuarve ishte se a mendoni se paketat e ofruara nga kompanitë telefonike janë të përballueshme për ju. Lidhur me këtë pyetje, 68.8% e tyre janë shprehur jo dhe vetëm 31.2% janë shprehur se po.

**Grafiku 7:** Sa i kënaqur jeni me kompaninë aktuale në lidhje me:



Nga të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, të anketuarit, më të pakënaqur janë me tarifaf, më pas me internetin, me larmishmërinë e paketave, me mbulimin me rrjet dhe së fundmi me shërbimin. Konkretisht:

- **63%** e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me **tarifaf**;
- **53%** e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me **internetin**;
- **47%** e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me **larmishmërinë e paketave**;
- **34%** e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me **mbulimin me rrjet**;
- **28%** e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me **shërbimin**.

Pyetja e fundit që u është drejtuar të anketuarve është se çfarë do të donit që të përmirësojnë kompanitë celulare. Pjesa më e madhe e tyre janë shprehur se duan ulje të tarifave pasi i konsiderojnë shumë të larta, një pjesë e konsiderueshme kërkojnë konsumim më të ngadaltë të internetit si dhe një pjesë më e vogël kërkojnë mbulim më të madh të territorit me valë.

#### **GJETJE:**

- AKEP nuk përdor metoda të orientuara në kosto për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare (MTR), ashtu siç rekomandon Komisioni European, BEREC dhe siç përcakton ligji "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", në nenet 45, 49 dhe 57.
- Këshilli Drejtues i AKEP nuk ka vepruar me efikasitet dhe efektivitet në marrjen e vendimeve të tij, pasi për të miratuar një dokument të rregullimit të tarifave i është

dashur 2 vite kohë (nxjerrë për këshillim publik në Dhjetor 2016 dhe miratuar në Tetor 2018), duke e lënë kështu tregun e shumicës me të njëjtat tarifa terminimi për 3 vite. Si rrjedhojë e kësaj, në Shqipëri në vitin 2018 është aplikuar e njëjta tarifë terminimi që vendet e BE-së e kanë aplikuar në vitin 2013.

- AKEP nuk ka zbatuar Rekomandimin e KE maj/2009 në të cilin përcaktohet se vendet që aplikojnë metodën benchmark të rregullimit të tarifave, nuk duhet të kenë rezultate më të larta se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e Pure LRIC. Nga krahasimi i MTR-ve në Shqipëri me MTR-të mesatare të vendeve që kanë aplikuar metodologjinë Pure LRIC, konstatohet se MTR-të në Shqipëri gjatë periudhës 2017-2019 kanë qenë 25%-33% më të larta.
- Shqipëria ka tarifën e terminimit të thirrjeve celulare MTR më të larta sesa MTR -të mesatare të 28 vendeve të BE; MTR -të mesatare të 37 vendeve të BEREC; MTR -të mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure LRIC; dhe se MTR -të mesatare të gjashtë vendeve të rajonit, për periudhën 2017-2019.
- Shërbimet e ofruara nga kompanitë telefonike në Shqipëri nuk janë në përputhje me pritshmëritë e konsumatorëve, ku nga përgjigjet e pyetësorit ka rezultuar se 69% e të anketuarve janë shprehur se paketat e ofruara janë të papërbalueshme për ta; 63% e të anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me tarifën; dhe 53% e tyre janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me shpejtësinë dhe konsumimin e internetit.

#### **KONKLUZIONE:**

- ✓ Niveli i lartë i tarifave të terminimit në Shqipëri ka sjellë konkurrencë jo efektive në treg për shkak se operatori me pjesë të vogël tregu ka kosto të larta të thirrjeve off-net, si dhe niveli i tarifës së shumicës (MTR) ndikon në nivelin e tarifës së pakicës, që është tarifa që paguajnë përdoruesit fundorë. Një nivel i lartë i MTR ka sjellë tarifa më të larta për konsumatorët.
- ✓ Mungesa e efektivitetit të Këshillit Drejtues në lidhje me mos miratimin e dokumentit të rregullimit të tarifave për 2 vite, ka sjellë si rrjedhojë tarifa terminimi më të larta, ku në Shqipëri në vitin 2018 është aplikuar e njëjta tarifë terminimi që vendet e BE-së e kanë aplikuar në vitin 2013.

#### **REKOMANDIME:**

- AKEP të marrë të gjithë masat e nevojshme për të zhvilluar modelin Pure LRIC për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve celulare, ashtu siç e rekomandon BE dhe BEREC. Përdorimi i këtij modeli do të mundësojë reduktim të kostove të thirrjeve off-net të operatorëve, do të rrisë konkurrencën në treg si dhe do të mundësojë tarifa më të lira për përdoruesit fundorë.

***Brenda vitit 2020***

- Tarifën e terminimit për rrjetet celulare MTR në Shqipëri të përcaktuara nga AKEP, të mos jenë më të larta se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e Pure LRIC, derisa AKEP të zhvillojë modelin Pure LRIC.

***Menjëherë dhe deri në zhvillimin e modelit Pure LRIC***

#### **4. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE**

1. Silvana RAMADANI, Audituese e Parë, përgjegjëse e grupit të auditimit
2. Miranda MISINI, Audituese e Parë, anëtare.
3. Reinis XHELILI, Auditues i Dytë, anëtar.

## ANEKS: RRJETI I GJENERATËS SË PESTË (5G)

Teknologjia e komunikimit dhe transmetimit të sinjaleve të çfarëdo lloji qofshin ato ka evoluar së tepërmi, duke nisur me teknologjinë e gjeneratës së parë 1G, të zhvilluar rreth viteve 1980, teknologji në të cilën sinjali radio, i formës analoge, ishte i vetmi sinjal që transmetohej, deri në ditët e sotme. Aktualisht teknologjia që po përdoret gjerësisht për transmetimin e sinjaleve është ajo e gjeneratës së katërt ose 4G e zhvilluar rreth viteve 2009-2010, ndërkohë që në vitin 2018 ka nisur të zhvillohet teknologjia e gjeneratës së pestë të transmetimit të sinjalit ose 5G, dhe pritet që startimin e implementimit të gjerë në rang global kjo lloj teknologjie ta ketë në vitin 2020, me një parashikim të përlogaritur nga ekspertë të fushës, që ky rrjet të jetë mbizotërues në përdorim në krahasim me rrjetet 3G dhe 4G në vitin 2025.

Rrjetet 5G janë një grupim elementesh infrastrukurore të komunikimit mobile dhe wireless, që shërbejnë për ndërlidhjen dhe komunikimin midis pajisjeve duke ofruar performancë të lartë, kapacitet të lartë, pa ndërprerje dhe që suportojnë komunikimin ndërmjet një numri të madh pajisjesh mobile. Në rrjetet 5G mund të përfshihen edhe elementë teknologjikë të përdorur në gjenerata të mëparshme si 3G apo 4G, madje, mund të themi se teknologjia 5G në fazat e para të implementimit të saj e ka të domosdoshme mbështetjen në teknologjinë aktuale të gjeneratës së katërt.

Teknologjia 5G mundëson komunikimin në band-a komunikimi që mundësojnë transferimin e sasive të mëdha të të dhënave më shpejtësi shumë më të lartë se ajo që mundësojnë teknologjitë 3G apo 4G. Teknologjia e gjeneratës së pestë, ose 5G, ripërcakton ose paraqet një koncept të ri të infrastrukturës së rrjeteve, duke 'prezantuar' të ashtuquajturin "network slicing". "Network slicing" nënkupton aftësinë e kësaj teknologjie për t'i ofruar përdoruesit mundësinë e shfrytëzimit të rrjetit sipas nevojave të tij. Kjo metodë bëhet e mundur si pasojë e aftësisë që ofron kjo teknologji për të ndarë infrastrukturën fizike në platforma virtuale duke përdorur teknikat e ashtuquajtura NFV ose Network Functions Virtualizations.

Si funksionon 5G?

Infrastruktura e rrjeteve 5G përbëhet në thelb nga dy komponentë kryesore 'Radio Access Network' dhe 'Core Network'.

'**Radio Access Network**' nënkupton një sërë elementesh, duke filluar që nga të ashtuquajturat 'qeliza' deri tek antenat e mëdha në formë kullash të cilat shërbejnë për të lidhur pajisjet mobile apo ato wireless, me qëllim kryesor aksesimin e rrjetit qendror.. 'Qelizat' si një element i rrjeteve të gjeneratës së pestë luajnë rol të rëndësishëm në rastet kur distanca e pajisjeve që do të komunikojnë është e vogël. Këto 'qeliza' shërbejnë që lidhja midis pajisjeve dhe komunikimi i tyre të jenë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje, pasi pajisjet i përdorin këto 'qeliza' sipas vendndodhjes së tyre. Bashkimi apo bashkësia e të gjithë këtyre 'qelizave' përbëjnë apo ndërtojnë hapësirën e mbulimit të rrjetit të gjerë në terma macro.

Ndërkohë që, antenat e mëdha, apo ato që quhen 'Qeliza Macro' janë elementi kyç që ndikojnë në shpejtësinë e lartë të transmetimit të të dhënave apo sinjaleve që ofron rrjeti i gjeneratës së pestë. Këto antena janë të tipit MIMO (Multiple input, multiple output) të cilat bëjnë të mundur shkëmbimin e më shumë të dhënave njëkohësisht. Fuqia transmetuese e këtyre antenave është tepër e lartë ndërkohë që madhësia e tyre fizike është pothuajse e njëjtë me ato që përdorin rrjetet 3G dhe 4G.

**'Core Network'** nënkupton rrjetin e shkëmbimit të informacionit i cili menaxhon sinjalet zanorë, të dhënat elektronike dhe lidhjen në internet të pajisjeve mobile. Shumë karakteristika të rrjetit të gjeneratës së pestë, siç janë NFV (Network Function Virtualization), 'Network Slicing', dhe shërbimet e bazuar në cloud të cilat janë përmendur dhe më sipër i atribuohen dhe menaxhohen nga rrjeti bazë, i quajtur 'core network'.

Të dyja këto komponente të përmendura më sipër dhe mënyra sesi ato funksionojnë dhe ndërliken me njëra-tjetrën pasqyrohet në një ilustrim të thjeshtë si më poshtë:



Arkitektura e rrjetit të gjeneratës së pestë.

### Implementimi i 5G në Shqipëri

Shqipëria është një vend në zhvillim i cili në 10-15 vitet e fundit ka tentuar të ndjekë ritmin e vendeve të zhvilluara përsa i përket trendeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Përsa i përket komunikimeve elektronike dhe postare mobile, licenca e parë e lëshuar në vendin tonë, në vitin 1993, ka qenë licencë për rrjetin 2G, të quajtur ndryshe GSM. Kapërcimi në teknologjinë e gjeneratës së tretë, 3G është kryer në fund të vitit 2010 me licencën e parë të dhënë për implementimin e kësaj teknologjie. Shpejtësia e transmetimit të të dhënave në këtë teknologji arrin deri në 2Mbps.

Ndërkohe, katër vite më vonë, në vitin 2015, në tregun Shqiptar është implementuar teknologjia 4G, teknologji e cila përdoret aktualisht së bashku me teknologjinë 3G nga shumica e përdoruesve në raport me numrin total të përdoruesve të pajisjeve mobile. Në teknologjinë 4G, shpejtësia e transmetimit të të dhënave arrin në vlerat nga 100MBps deri në 1Gbps.

Nga raportet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, mbi treguesit statistikorë të tregut të komunikimeve elektronike për 3-mujorin e II të vitit 2019, të botuara edhe në faqen zyrtare të AKEP, vihet re se numri i përdoruesve me akses broadband në rrjetet 3G dhe 4G arrin në 1,742,553 përdorues. Në këtë raport vihet re gjithashtu se në vitin 2015, vit kur ka nisur të implementohet në vendin tonë teknologjia 4G, numri i përdoruesve ka qenë 1,297,281 të tillë. Pra, nga viti 2015 në vitin 2019, vihet re një rritje me 445,272 përdorues ose me 34% të numrit total të përdoruesve në vitin 2015.

Kjo statistikë paraqet qartë, trendin rritës dhe qasjen që Shqipëria ka drejt implementimit dhe adaptimit të teknologjive të reja.

Ndërkohë në vitin 2019 vendi ynë i është qasur paralelisht trendeve globale, që udhëhiqen nga vende me kapacitete teknologjike dhe njerëzore më të specializuara se



Shqipëria, për të adaptuar teknologjinë e gjeneratës së pestë, ndryshe nga sa ka ndodhur me teknologjitë e mëparshme 2G, 3G dhe 4G.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me Vendimin nr.34 datë 14.10.2019, të Këshillit Drejtues, ka pajisur me Autorizim Individual një prej operatorëve telefonik që operojnë në vendin tonë, për përdorimin e frekuencave të brezit 3600-3700 MHz, sasi spektri 100 MHz i paçiftuar, për kërkim, matje dhe provë. Këto frekuenca që bëjnë pjesë në brezin 3400-3600/3600-3800 MHz, që përdoren për ndërtim dhe operim të rrjeteve celulare të gjeneratës së pestë (5G).

Sipas AKEP, ky autorizim lëshohet për këtë operator për:

- Testim të teknologjisë 5G New Radio.
- Testim të konceptit Massive MIMO.
- Testim të Shpejtësive Maksimale me Carrier Aggregation LTE + 5G New Radio.
- Testim të latency (performancës së rrjetit në transferimin e të dhënave).

Synimi i operatorëve të telefonisë është i tillë që në vitin 2020, kjo teknologji të implementohet në vendin tonë.

Implementimi i kësaj teknologjie në vendin tonë mund të sjellë përfitime të mëdha në aspektin e fuqizimit ekonomik dhe ofrimit të faciliteteve për organizatat dhe bizneset. Ndërkohë po aq të mëdha sa mund të jenë përfitimet, mund të jenë edhe dëmet që mund të shkaktohen në rast të dështimit që mund të vijë si pasojë e implementimit pa një studim të thelluar lidhur me mënyrën e implementimit, raportin përfitim/kosto dhe pa një strategji gjithëpërfshirëse me fokus kryesor mbrojtjen e konsumatorit shqiptar.

Risqet që lidhen me sigurinë kibernetike të implementimit të 5G në Shqipëri

Në Shtator të vitit 2016, Komisioni European ka publikuar një plan veprimi lidhur me implementimin e teknologjisë 5G në vendet e Bashkimit European. Ky plan veprimi është i vlefshëm për të gjithë vendet anëtare të Bashkimit European. Në këtë plan veprimi është parashikuar që vendet e BE, deri në fund të vitit 2020, të kenë implementuar teknologjinë 5G, të paktën në një prej qyteteve kryesore të vendit. Ndërkohë në zbatim të rekomandimeve të Komisionit European, të adoptuara në Mars të vitit 2019 për të mundësuar një nivel të lartë të sigurisë kibernetike, BE ka hartuar edhe një raport të koordinuar për vlerësimin e riskut të sigurisë kibernetike në rrjetet e gjeneratës së 5-të (5G).

Në këtë raport janë vlerësuar aspektet kryesore dhe më të rëndësishëm që lidhen me sigurinë kibernetike, siç mund të përmenden:

- Llojet kryesore të kërcënimeve kibernetike,
- Aktorët kryesorë të kërcënimeve kibernetike,
- Asetet kryesore dhe kushtet e tyre,
- Dobësitë kryesore,
- Skenarët e mundshëm sipas risqeve.

Pavarësisht se ky raport është hartuar dhe është i vlefshëm për vendet anëtare të Bashkimit European, duke qenë se në ditët e sotme teknologjia e informacionit dhe komunikimit i ka thyer kufinj të fizikë ndërmjet vendeve dhe grupimeve të ndryshme, informacioni që ai paraqet është i vlefshëm dhe kuptimplotë edhe për vendin tonë.

Mund të themi madje, se ky raport, merr vlerë edhe më të madhe në rastet e vendeve si Shqipëria, që nuk janë ende pjesë e BE, duke pasur parasysh se plani i veprimit për implementimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë, në të gjitha çështjet dhe veprimet që

parashikon, e ka të përcaktuar qartë se do të kryhen në bashkëpunim me Komisionin European.

Nisur nga sa më sipër risku që siguria e informacionit të çënohet, në vendin tonë është tepër i lartë, ashtu sikurse është edhe dëmi që një skenar i tillë mund të shkaktojë për vendin tonë, si në aspektin ekonomik, në aspektin social por edhe në dëmtimin e imazhit të vendit. Çdo sistem teknologjik mbart me vete riskun e dobësive lidhur me pajisjet fizike të infrastrukturës teknologjike (hardware), software-t, proceset apo politikat që ndiqen. Risqet kibernetike që lidhen me rrjetet 5G, në thelb të konceptit të tyre janë të njëjta me ato të rrjeteve 3G apo 4G, ku mund të përmenden risku për thyerjen e konfidencialiteti, disponueshmërisë dhe integritetit (saktësisë apo vërtetësisë) së të dhënave. Duke qenë se rrjetet e gjeneratës së 5-të operojnë në një infrastrukturë komplekse teknologjike, rrjedhimisht janë të ekspozuara ndaj një risku më të lartë kibernetik, krahasuar me rrjetet 3G dhe 4G. Ashtu siç edhe në raportin e BE theksohet, një ndryshim i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje është fakti se impakti potencial dhe intensiteti në rrjetet 5G do të jetë më i lartë, përpjesëshmërisht i drejtë me funksionet ekonomiko-sociale të rrjeteve 5G.

Risqet kibernetike të implementimit të rrjeteve të gjeneratës së 5-të në Shqipëri paraqiten edhe më të lartë duke marrë parasysh mundësinë për mangësi apo dobësi siç parashtrihen edhe në raportin e publikuar nga BE, ndër të cilat mund të theksohen :

- Mangësi në burimet njerëzore që kanë detyrë sigurinë, monitorimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve 5G.
- Mangësi në kontrollet e brendshme, praktikat monitoruese dhe praktikat e menaxhimit të riskut.
- Mangësi në procedurat e sigurisë apo mirëmbajtjes siç mund të jenë përditësime të software-ve.
- Mos-përputhshmëri apo implementim i gabuar i standardeve.

Duke qenë një teknologji komplekse që do të bazohet në software, të gjithë risqet e sipërpërmendur marrin vlerë edhe më të madhe.

Spektri i gjerë që teknologjia e gjeneratës së 5-të mund të mbulojë, dedukton në përfundimin se impakti i thyerjeve të mundshme të sigurisë së informacionit në këto rrjete mund të jetë tepër i lartë, me kosto financiare, kohore dhe sociale për konsumatorin shqiptar. Ashtu sikurse cilësohet dhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare "Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet dhe informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Rritja e komunikimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por, në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe joshetërorë. Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike".

Përfitimet ekonomiko-sociale, nuk mund të prevalojnë kurrësesi mbi ato të Sigurisë Kombëtare.

Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri mbart me vete një risk të lartë të thyerjes së sigurisë së informacionit *dhe kërkon domosdoshmërisht të kryhet duke u bazuar në një plan-veprimi kombëtar, të detajuar qartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim mbrojtjen e padiskutueshme nga akseset e paautorizuara, tjetërsimi, keqpërdorimi apo mos-disponueshmëria, e një asemi të çmuar për konsumatorin shqiptar, siç është informacioni.*